

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 81-të i botimit
Nr.11



HISTORIKE

Shqipëria integrohet plotësisht në NATO

Përmbajtja

numri 11

KRONIKË

- 12** Kremtohet 15 vjetori i krijimit të Forcave Speciale

INTERVISTA

- 24** Gjeneral Ahmetaj: Kosova dhe Shqipëria sistem të përbashkët Mbrojtje

STUDIMI

- 42** PPBES, një "Deus ex machina" për menaxhimin e burimeve të Mbrojtjes

BOTIMI

- 50** Jeta është e bukur...

STAFI

Drejtor i Publikimeve:
Lavdrim LITA

Kryeredaktor:
Albert HITOALIAJ

Gazetarë:
Alba MUSARAJ
Leonard QUKU

Redaktore korrektore:
Elona Shimaj Mako

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Shtypur në shtypshkronjën:
"Kristalina KH"



4 INTEGRIMI

Historike, Shqipëria integrohet plotësisht në NATO

Zhvilloi me sukses punimet Konferenca Finale e Integritit të FARSH në NATO, me pjesëmarrjen e delegacionit të lartë...



6 INTEGRIMI

Gjeneral Palomeros: Është një ditë e madhe për FASH

Flet komandanti i Komandës Aleate për Transformim (ACT), gjeneral Jean-Paul Palomeros



10 MINISTERIALI

Shqipëria do të vazhdojë të jetë në Afganistan edhe pas vitit 2014

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Kodheli, merr pjesë në Ministerialin e ministrave të Mbrojtjes në Bruksel



30 SPECIALE

Dinamika e NATO-s, rajoni dhe transformimet në ardhje

Një panoramë informacioni në lidhje me ato sfida sigurie me të cilat duhet të përballë edhe vendi e rajoni ynë

Integrimi i plotë në NATO, përgjegjësi kombëtare

Integrimi i plotë në NATO është përgjegjësi kombëtare për çdo vend të ri anëtar të Aleancës së Atlantikut të Veriut. Në fakt kjo përgjegjësi kombëtare vërehej në çdo paragraf të “Direktivës së Mbrojtjes” për vitin 2013 dhe thelbi i asaj ishin “Udhëzimet e SHSHPFA” për këtë vit. Sigurisht kur flasim për një proces integrimi, ne kemi parasysh që strukturalisht kjo forcë të jetë një forcë e ngjashme me forcat e tjera të NATO-s, që trajnimi, stërvitja të bëhet mbi bazën e kriteve standarde të NATO-s. Dhe ne ia kemi arritur të jemi të sinkronizuar me ushtritë e tjera të aleancës në aspektet e mundshme.

Megjithatë procesi i integritit ka qenë mjaft dinamik që nga momenti i anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Që nga anëtarësimi zyrtar i Shqipërisë në NATO ka nisur të zbatohet plani i integritit që nënkupton reformimin e thellë të sektorit të sigurisë e mbrojtjes me qëllim ndërveprimin e plotë me NATO. Pjesë e këtij plani ishte paketa me 49 objektiva force të cilat u morën përsipër nga FARSH si kapacitete operacionale të cilat vihen në dispozicion të NATO për misionet aktuale dhe të ardhshme. Të tjera prioritete u përcaktuan në vitin 2009, të tjera prioritete ose të tjera sfida më mirë themi, janë sot para FARSH. Duhet thënë se nga viti 2009, FA është vlerësuar pozitivisht për shkëmbim të informacionit të klasifikuar me NATO-n dhe kemi ecur në përputhje me standardet e Aleancës në këtë drejtim. Raportet më të fundit të NOS (NATO Office Security) vlerëson maksimalisht punën e bërë nga strukturat tona në këtë drejtim. FA ka përmbushur detyrimet për emërimin e personelit tonë në strukturat e NATO-s që janë integruar plotësisht në procedurat e punës së Aleancës, por i kanë shërbyer edhe FARSH për prioritarizim të procesit të integritit. FA iu është përgjigjur me korrektësi detyrimeve të Ciklit NDPP të NATO-s dhe kemi patur arritje në fushën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të integritit në NATINAMDS, të përmirësimit të infrastrukturës stërvitore (Qendra e Simulimit në KDS) dhe të shtrirjes së rrjetit C3 të NATO-s në MM/SHP dhe në Komandat kryesore të FASH. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë miratoi në javën e parë të prillit dokumentin e Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij dokumenti e përsheptuan duke e çuar drejt përmbylljes



Lavdrim Lita
Drejtor

procesin e integritit të Shqipërisë në NATO, pasi implementimi i këtyre rekomandimeve do të formësojë në një Forcë të Armatosur efikase, të ndërveprueshme dhe mbi të gjitha një Forcë të Armatosur të Aleancës, ku mbrojtja kolektive shkon krah mbrojtjes konvencionale, njëra duke plotësuar tjetrën. Miratimi i Librit Blu (Blue book) ku çdo vend deklaroi dhe miratohet së bashku kapacitetet që çdo vend ka në dispozicion të NATO-s është një arritje e madhe. Po ashtu ministria e Mbrojtjes dhe FARSH është duke zhvilluar 9 projekte në kuadrin e “smart defence”, ku mund të përmendim ato në fushën e logjistikës, standardizimi, trajnimeve, CIS, etj. Padyshim zhvillimi i mëtejshëm i këtyre projekteve do t’i shërbejnë rritjes së mëtejshme të kapaciteteve dhe shtimit të efikasitetit të forcave të NATO-s dhe vendeve që marrin pjesë në këto iniciativa. Së fundmi finalizimi i përpjekjeve për integrim të plotë në NATO është një ditë e shënuar për Forcat e Armatosura. Shqipëria është zyrtarisht anëtare më të drejta të plota në Aleancën e Atlantikut të Veriut, falë përpjekjeve të mëdha të burrave dhe grave nën uniformën e blertë, të cilët bashkuan fuqitë dhe aftësitë më të mira për t’u ngjitur në nivelin standardeve të dëshiruara.

Historike, Shqipëria integrohet plotësisht në NATO

Zhvilloi me sukses punimet Konferenca Finale e Integrimit të FARSH në NATO, me pjesëmarrjen e delegacionit të lartë të Komandës Aleancës për Transformim, si dhe drejtuesve të MM dhe ShP

Shqipëria mirëpriti konferencën finale të integrimit në NATO, e cila u zhvillua në datën 25 tetor 2013. Me rastin e zhvillimit të këtij aktiviteti, ka mbërritur në Tiranë, në datën 24 tetor 2013, komandanti i Komandës së Aleancës për Transformim (ACT), gjeneral Jean-Paul Palomeros. Kjo konferencë kishte për qëllim identifikimin e mësimëve të nxjerra dhe arritjeve të deritanishme të Forcave të Armatosura të RSH, në procesin e integrimit të plotë të vendit tonë në NATO. Integrimi i plotë i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë nënkupton një proces të vazhdueshëm dhe dinamik të zhvillimit të burimeve njerëzore, strukturave, doktrinae dhe kapaciteteve me qëllim përmirësimin e efektshmërisë dhe ndërveprueshmërisë me NATO në mënyrën më të përshtatshme. Komandanti i Komandës së Aleancës për Transformim (ACT), gjeneral Jean-Paul Palomeros, është pritur nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Xhemal Gjunksi. Gjeneral

Gjunksi në këtë takim ka vlerësuar me nota maksimale ndihmën që Komanda e Aleancës për Transformim ka dhënë për Forcat e Armatosura shqiptare në procesin e integrimit, që për Forcat e Armatosura shqiptare ka qenë prioritet kryesor. Gjeneral Jean-Paul Palomeros pasi falënderoi për pritjen e veçantë, vlerësoi progresin e shënuar nga Forcat e Armatosura shqiptare prej anëtarësimit në NATO në vitin 2009, duke nënvizuar se Shqipëria dhe Forcat e saj të Armatosura kanë bërë një punë të shkëlqyer në drejtim të integrimit të plotë në NATO. Vizita e komandantit të Komandës së Aleancës për Transformim ka vazhduar me një pritje të veçantë nga ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli, e cila ka falënderuar për mbështetjen e madhe dhe të shumanshme që strukturat e NATO dhe veçanërisht ACT kanë dhënë për FA në rrugën e tyre të integrimit të plotë në NATO. Gjithashtu më herët, komandanti i Komandës së Aleancës për Transformim është pritur nga kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama,





i cili ka rikonfirmuar angazhimin e palëkundur të Shqipërisë, tashmë vend anëtar me të drejta të plota në NATO, për t'u rreshtuar përkrah aleatëve kudo dhe kurdoherë që të kërkohet.

Finalizimi i integritimit

Ditën e premte, në datë 25 tetor 2013, në ambientet e Komandës së Doktrinave dhe Stërvitjes, zhvilloi me sukses punimet Konferenca Finale e Integritimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në NATO, me pjesëmarrjen e delegacionit të lartë të Komandës Aleancës për Transformim, si dhe drejtuesve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm. Në konferencë morën pjesë ministrija e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Xhemal Gjunksi, komandanti i Komandës së Aleancës për Transformim, gjeneral Jean-Paul Palomeros, zëvendës shefat e Shtabit të Përgjithshëm të FA, komandantët e Forcave, etj. Punimet e Konferencës i përshëndeti ministrija e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, e cila pasi falënderoi ekipin e ACT për mbështetjen e madhe ndër vite, vlerësoi faktin se integrimi i Shqipërisë në NATO shënon një moment të rëndësishëm në memorien historike të vendi tonë. "Dëshiroj të theksoj se vendi ynë është plotësisht i angazhuar që të thellojë bashkëpunimin në funksion të integritimit dhe transformimit të pandërprerë brenda gjirit të Aleancës Euro-Atlantike. Ne do të mbështesim të gjitha iniciativat që do t'i shërbejnë rritjes së nivelit të bashkëpunimit dhe përmirësimit të situatës së sigurisë së vendeve tona, por edhe më gjerë", - ka theksuar ndër të tjera në fjalën e saj ministrija Kodheli. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Xhemal Gjunksi dhe komandanti i Komandës së ACT, gjeneral Jean-Paul Palomeros nënshkruan deklaratën e përbashkët, në të cilën konfirmohet integrimi i plotë i FARSH në NATO. Më tej të dy ushtarakët e lartë dhanë një deklaratë për shtyp, në të cilën vlerësuan arritjet, reformat e ndërmarra, seriozitetin dhe profesionalizmin e lartë në çështjet e integritimit. Gjeneral Gjunksi në fjalën e tij, pas vlerësimeve më të mira për ekipin e ACT, shprehu bindjen se

Forcat tona të Armatosura do të dinë të rreshtohen denjësisht përkrah NATO, duke rikonfirmuar se vendi ynë është pjesë e pandashme e iniciativave dhe koalicioneve ndërkombëtare që luftojnë për paqe dhe siguri në botën mbarë. Gjeneral Gjunksi konfirmoi edhe njëherë angazhimin e FA në përmbushjen e sfidave të proceseve të vazhdueshme transformuese që përjeton Aleanca Euro-Atlantike. "Procesi i integritimit ka qenë dhe do të vijojë të mbetet një sfidë për të gjithë ne, për arsye se ai është një proces i pandërprerë që kërkon në mënyrë të vazhdueshme përmirësimin e kapaciteteve ushtarake për realizimin me sukses të përgjegjësisve brenda zinxhirit hierarkik të NATO", është shprehur gjeneral Gjunksi. Komandanti i Komandës së ACT, gjeneral Jean-Paul Palomeros në fjalën e tij vlerësoi konferencën finale të integritimit si një moment shumë të rëndësishëm në memorien historike të Forcave të Armatosura shqiptare. "Tashmë si një vend i integruar plotësisht në NATO, Shqipëria mund të mbështetet gjithnjë e më shumë në ekspertizën dhe solidaritetin e Aleancës, si dhe do të jetë e aftë për të realizuar një spektër të gjerë misionesh dhe detyrash", ka deklaruar gjeneral Palomeros. Punimet e konferencës vijuan në formatin "Tavolinë e Përbashkët", me pjesëmarrjen e drejtuesve më të lartë të FA, komandantit të ACT, si dhe komandantët e komandave dhe të njësisve kryesore të FARSH. Menjëherë pas anëtarësimit në NATO, Forcat e Armatosura të Shqipërisë zhvilluan një Plan Integrimi që u mbështet me një Program Pune të Integruar nga NATO, i cili u hartua në emër të Aleancës nga Komanda e Forcës së Bashkuar në Napoli në fazën e parë dhe nga Komanda e Aleancës për Transformim në fazën finale. Qëllimi i të dy programeve ishte të mundësonte ndërveprimin e plotë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë me NATO. Tashmë, arritja e kapaciteteve të deklaruara do të vazhdojë pa një program mbështetës nga NATO dhe do të jetë pjesë e procesit të rregullt të punës, në përputhje me planin e Forcave të Armatosura, në mbështetje të synimeve të përcaktuara të Aleancës dhe Shqipërisë.

Gjeneral Palomeros: Është një ditë e madhe për FASH

Flet komandanti i Komandës Aleate për Transformim (ACT), gjeneral Jean-Paul Palomeros



“Për mua është shumë mbresëlënëse mënyra se si Forcat e Armatosura Shqiptare mundën të përmbushin të gjitha kriteret e kërkuara në një periudhë të shkurtër katër vjeçare, nëse do të marrim parasysh larminë e standardeve të kërkuara”

Intervista e mëposhtme, me komandantin e Komandës Aleate për Transformim (ACT), gjeneral Jean-Paul Palomeros, jep një vlerësim në mënyrë të shkurtër në lidhje me finalizimin e procesit të integritimit final të FA shqiptare në NATO. Kjo është një ditë e rëndësishme për FARSH dhe për vendin tonë, pasi i hedhur është në të vërtetë një konfirmim i seriozitetit të punës së kryer.

Gjeneral Palomeros, Konferenca Finale e Integritimit është një moment i rëndësishëm për Forcat e Armatosura. Ky moment vjen pas katër vitesh përpjekje të mëdha, reforma dhe standarde të reja. Cilat janë komentet dhe vlerësimet tuaja?

Finalizimi i përpjekjeve për integrim është një ditë e madhe për Forcat e Armatosura Shqiptare. Shqipëria është zyrtarisht anëtare më të drejta të plota në NATO, falë përpjekjeve të mëdha të burrave dhe grave nën uniformë, të cilët bashkuan fuqitë dhe aftësitë më të mira për të arritur nivelin e dëshiruar të standardeve, për të qenë anëtar të NATO-s. Kjo është padyshim një ditë e shënuar që duhet festuar, është fillimi i një ere të re për Forcat e Armatosura Shqiptare, të cilat rreshtohen denjësisht në strukturat e aleancës për të marrë përgjegjësitë që u takojnë. Unë ndihem shumë i lumtur që ndodhem në Shqipëri për të firmosur deklaratën zyrtare të integritimit të plotë të FARSH në NATO. Me këtë rast dëshiroj që të shpreh vlerësimin tim për mbështetjen e vazhdueshme nga të gjitha strukturat e NATO-s, si Komanda Aleate për Operacionet (ACO), Komanda Aleate për Transformim (ACT) si strukturë drejtuese e procesit të integritimit, Komanda e Forcës së Bashkuar në Napoli (JFC Naples), si dhe të gjitha ekspertët ata që kanë dhënë kontributin e tyre në këtë proces. Aleanca Euro-Atlantike punon dhe vepron si një



ekip i vetëm, me qëllim arritjen e standardeve më të larta, të cilat bazohen në nivelin e ambicieve, me qëllim mbrojtjen e vlerave tona më të mira. Për mua personalisht është një kënaqësi e madhe teksa shoh edhe Shqipërinë që të rreshtohet dhe integrohet plotësisht përkrah aleancës së vlerave.

Komanda Aleate për Transformim ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me SHPFA, përmendim këtu pesë konferenca, shumë takime në nivel ekspertësh. Si do ta gjykonit procesin e integritit të FARSH në NATO?

Për mua është shumë mbresëlënëse mënyra se si Forcat e Armatosura Shqiptare mundën të përmbushin të gjitha kriteret e kërkuara në një periudhë të shkurtër katër vjeçare, nëse do të marrim parasysh larminë e standardeve të kërkuara. Planifikimi i suksesshëm i realizuar në këtë periudhë të shkurtër kohore, ka mundësuar që të planëzohen dhe të ndërtohen me sukses të gjitha planet kombëtare në akordancë me kërkesat dhe standardet e proceseve planifikuese të mbrojtjes së NATO-s. Është shumë e rëndësishme që një vend të zhvillojë kapacitetet e nevojshme mbrojtëse në dispozicion të së nesërme, në mënyrë që t'u përgjigjet sa më mire sfidave të kohës. Sa i takon zhvillimit të kapaciteteve të "smart defence" (mbrojtjes së mençur), Shqipëria është duke zhvilluar nëntë projekte "smart" të rëndësishme, ku mund të përmendim ato në fushën e logjistikës, trajnimeve, CIS, etj. Zhvillimi i këtyre projekteve do t'i shërbejnë rritjes së mëtejshme të kapaciteteve dhe shtimit të efikasitetit të forcave të NATO-s dhe vendeve që marrin pjesë në këto iniciativa. Së bashku ne kemi mundur të rrisim nivelin e aftësive të personelit, duke njohur dhe kuptuar më mirë atë që përfaqëson NATO, duke bërë gjithashtu të mundur integrimin më të plotë të standardeve të ndërveprueshmërisë së forcave,

nëpërmjet aplikimit të standardeve dhe STANAG-ëve në TRADOK dhe në Qendrën e Simulimit të FA. Këto janë arritje të shënuara në një periudhë të shkurtër kohore dhe tashmë është e nevojshme për t'i theksuar më mirë ato, është koha për të trajnuar më shumë njerëz, të aftë për t'u përfshirë në strukturat dhe fazat planifikuese të NATO-s, si dhe në stërvitjet më të rëndësishme që realizojnë strukturat e saj operacionale. Pra, sikundër e përmenda, FARSH kanë shënuar arritje të mëdha dhe ky fillim i ri do të thotë që Shqipëria të luajnë një rol edhe më të madh në çështje të sigurisë dhe të së ardhmes së Aleancës.

Si e vlerësoni rrugën përpara dhe cilat mund të jenë sfidat me të cilat do të duhet të përballen Forcat e Armatosura Shqiptare?

Çdo Forcë e Armatosur, kur arrin një nivel të tillë, është e gatshme që jo vetëm të ruajë standardet e shënuara, por edhe t'i çojë përpara dhe t'i përminësojë ato. Kjo është edhe pritshmëria ime karshi Forcave të Armatosura Shqiptare. Kam mbetur i surprizuar nga vendi i juaj i mrekullueshëm dhe nga mikpritja e njerëzve. Ju padyshim që keni potenciale shumë të mëdha që duhet t'i vini në përdorim, keni një brez të ri shumë vital dhe të talentuar, i cili duhet arsimuar dhe trajnuar sa më mirë. Jam i sigurt që Forcat e Armatosura Shqiptare do të ofrojnë më të mirën e ekspertizës së tyre dhe mësimëve të nxjerra, sidomos në fushën e operacioneve, ku duhet theksuar se ju keni kontribut të rëndësishëm në kuadër të NATO-s. Ju mund të servini përpara aleatëve vizion tuaj jo vetëm kombëtar, por edhe rajonal, i cili është shumë i rëndësishëm për NATO-n. Pritshmëritë tona janë të mëdha dhe unë jam shumë i bindur se të gjitha angazhimet e Forcave të Armatosura Shqiptare do të realizohen në mënyrën më të mirë.

Intervistoi: Nënkolonel Arian Osmani

“Procesi final i integrimit në NATO, ngjarje e shënuar historike për FA”

Flet SHSHPFA, gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi

Intervista e mëposhtme, me SHSHPFA, gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi, jep një panoramë të përmblodhur të asaj që u arrit dhe të rëndësisë që ka finalizimi i procesit të integrimit final të FA shqiptare në NATO. Është dashur një punë intensive që të arrihen rezultatet e deritanishme dhe falënderimi e vlerësimi i takon gjithë efektivave të FA.

I nderuar shef i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi konferenca Finale e Integrimit të FA Shqiptare me NATO-n dhe firmosja e deklaratës së përbashkët me komandantin e Komandës së Aleancës për Transformim (ACT), gjeneral Jean-Paul Palomeros ishte një gur kilometrik që do të kujtohet me krenari në të ardhmen jo vetëm të FARSH. Komenti Juaj...
Konferenca Finale e Integrimit me Komandën Aleate

për Transformim (ACT), shënoi një moment shumë të rëndësishëm dhe domethënës për Forcat tona të Armatosura, atë të integrimit të plotë në NATO. Kjo ngjarje padyshim që vlen të shënohet në memorien historike kombëtare dhe në vazhden e sukseseve të mëdha të Forcave tona të Armatosura, pasi është finalizimi i përpjekjeve disa vjeçare, të cilat janë arritur me mund dhe sakrificë, por edhe me kosto njerëzore dhe financiare.

Dëshiroj të theksoj faktin se anëtarësimi i vendit tonë në NATO në vitin 2009 ishte vetëm fillimi i një bashkëpunimi të ngushtë dhe intensiv ndërmjet FARSH dhe strukturave të Aleancës Euro-Atlantike, i cili u finalizua suksesshëm dhe që padyshim i hap rrugën një periudhe të re në marrëdhëniet e vendit tonë me NATO-n. Programet dhe planet e detajuara gjatë periudhës katër vjeçare të procesit të integrimit bënë



**Mesazh urimi nga gjeneralmajor Jon B. Lilland,
ndihmës-shef i Shtabit të ACT-së**

Gjeneral Lilland mesazh urimi SHSHPFA

Dear General Gjunkshi,

Congratulations to you and your Armed Forces for completing the Integration Process!

I have enjoyed very much to work with you and your officers during the last two years.

Your personal engagement has provided a great example for your personnel and have made a significant difference!

I will always have fond memories from our common work. I wish you personally and your personnel all the best for the future,

Respectfully,

Jon

Jon B. Lilland

Major General

Norwegian Army

DACOS C2DS / NATO Capability Monitor for C-IED



të mundur realizimin e të gjitha detyrimeve dhe obligimeve në funksion të transformimit të plotë të Forcave të Armatosura. Kjo gjë u arrit falë modernizimit të pajisjeve, të infrastrukturës ushtarake e sistemeve, si dhe angazhimeve gjithnjë e në rritje në operacionet paqeruajtëse në kuadër të Aleancës, duke treguar bindshëm angazhimin tonë të palëkundur për të kontribuar në interes të paqes dhe të sigurisë në rajonin tonë dhe më gjerë. Ne mbetemi të angazhuar për të kontribuar në rritjen e nivelit të bashkëpunimit me Aleancën, me qëllim vijimësinë e suksesshme të proceseve integruese dhe transformuese brenda saj.

Si e vlerësoni periudhën e pas anëtarësimit në NATO dhe cilat janë disa nga përfitimet konkrete që kanë shënuar FA?

Rruga e përqasjes dhe krijimit të kapaciteteve tona ushtarake sipas standardeve dhe principeve të NATO-s gjatë gjithë procesit të integritimit nuk ka qenë e lehtë. Ajo është realizuar me sukses si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë dhe i një pune intensive të strukturave përgjegjëse të FA dhe atyre të NATO-s, e veçanërisht ACT. Në këtë kuadër, do të dëshiroja që të theksoja progresin e shënuar në fushat kryesore të integritimit, të identifikuar gjatë këtij procesi, të tilla si: Dokumentet Strategjik Kombëtar, Plani Afatgjatë i Zhvillimit, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, etj., të cilave iu kushtua një vend i veçantë në Planin e Veprimit për periudhën 2012-2013.

Përfitimet e marra gjatë procesit të integritimit të FA kanë qenë të një vlere shumë të madhe dhe me impakt në të gjitha aspektet e veprimtarisë së FA. Mësimet e nxjerra gjatë kësaj periudhe i kanë shërbyer më së miri procesit të vlerësimit të mbrojtjes dhe transformimit të Forcave të Armatosura. Gjithashtu, një numër i madh oficerësh, nënoficerësh dhe ushtarësh profesionistë kanë fituar eksperiencë të vyer në fushë-betejë dhe në çështje administrative falë angazhimeve në misionet paqeruajtëse. Këtë eksperiencë ata e kanë venë në përdorim edhe në strukturat kua veprojnë, duke implementuar realisht procedurat dhe standardet e NATO-s. Gjithashtu, pjesëmarrja në misionet ndërkombëtare ka qenë dhe mbetet pa dyshim

një tregues i matshëm i imazhit të Forcave të Armatosura përballë opinionit publik.

Transformimi është një sfidë e vazhdueshme. Çfarë duhet bërë për të siguruar që kapacitetet dhe forcat tona t'ju përgjigjen kërkesave të Aleancës?

Procesi i integritimit padyshim që do të mbetet një sfidë jo vetëm për Forcat tona të Armatosura, por edhe për të gjitha ushtritë e vendeve anëtare të NATO-s, për arsyen e thjeshtë se natyra e kërcënimeve dhe rreziqeve të së ardhmes është në ndryshim të vazhdueshëm. Integritimi është një proces ciklik dhe i vazhdueshëm dhe si i tillë do të mbetet një nga bazat për përmirësimin e kapaciteteve ushtarake të FA, me qëllim që të përmbushen me sukses të gjitha përgjegjësitë brenda NATO-s. Zhvillimi i kapaciteteve "smart" dhe i strukturave dhe kapaciteteve të deklaruar në NATO do të jenë shtyllat mbi të cilat do të bazohet jo vetëm mbrojtja kombëtare, por edhe angazhimi në kuadër të Artikullit 5 të NATO-s. Shpreh bindjen se Forcat tona të Armatosura ashtu si dhe deri më tani, do të dinë të rreshtohen denjësisht përkrah NATO, duke rikonfirmuar faktin se vendi ynë është pjesë e pandashme e iniciativave dhe koalicioneve ndërkombëtare që luftojnë për paqe dhe siguri.

I nderuar gjeneralmajor Gjunkshi, një mesazh publik për strukturat e FARSH në këtë ditë të veçantë.

Si shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dëshiroj të falënderoj të gjithë personelin e Forcave të Armatosura për përmbushjen me sukses të këtij angazhimi madhor kombëtar. Një falënderim të veçantë dua të adresoj për strukturat e angazhuara drejtpërsëdrejti në procesin e rëndësishëm të integritimit, si në MM ashtu edhe në SHPFA, të cilët ditën të realizojnë me sukses një nga angazhimet më të rëndësishme të ndërmarra ndonjëherë. Integritimi i plotë në familjen e madhe Euro-Atlantike përbën fillimin e një faqeje të re në historinë e FARSH, ndaj do të kërkoja nga të gjithë sa më shumë përkushtim, përgjegjësi dhe profesionalizëm, me qëllim që ta lartësojmë me nder imazhin tonë kombëtar.

Intervistoi: Nënkolonel Arian Osmani

Shqipëria do të vazhdojë të jetë në Afganistan edhe pas vitit 2014

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Kodheli, merr pjesë në Ministerialin e ministrave të Mbrojtjes në Bruksel



Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, mori pjesë në ministerialin e ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO që u zhvillua në selinë e NATO në Bruksel në datat 22 dhe 23 tetor. Gjatë ditës së parë ministrja Kodheli zhvilloi një takim bilateral me sekretarin e Përgjithshëm të NATO, z. Anders Fogh Rasmussen dhe sekretarin amerikan të Mbrojtjes, z. Chuck Hagel. Në hapje të takimit, z. Rasmussen i uroi mirëseardhjen në selinë e NATO ministres Kodheli dhe e përgëzoi atë për detyrën e re. Duke u ndalur në këtë takim të ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO, ai u shpreh se ky takim do të shërbejë si

hapi i parë drejt Samitit të NATO 2014. Sekretari i Përgjithshëm Rasmussen nënvizoi kontributet pozitive të Shqipërisë në operacione, nisma rajonale dhe në mbështetje të iniciativës "Smart Defence", në të cilën Shqipëria është pjesë aktive. Duke bërë një rezymë të shkurtër të takimeve të sotme, në formate të ndryshme, z. Rasmussen theksoi se pret diskutime të gjera mbi çështjet dhe sfidat tona të përbashkëta. Në fund të fjalës së tij, ai u shpreh i lumtur për rolin e Shqipërisë në NATO dhe pret të bashkëpunojë ngushtë me autoritetet shqiptare në të ardhmen. Në këtë kontekst, ai përmendi takimin e zhvilluar së fundmi me kryeministrin e Shqipërisë,

z. Edi Rama. Ministria Kodheli i dorëzoi nga ana e z. Rama si dhuratë z. Rasmussen edhe një pikturë. Nga ana e saj ministria e Mbrojtjes, znj. Kodheli falënderoi sekretarin e Përgjithshëm të NATO për pritjen që i rezervoi, në këtë pjesëmarrje të parë të saj në Ministerialin e Mbrojtjes të NATO. Ajo e siguroi sekretarin Rasmussen për mbështetjen dhe dedikimin e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe të saj personal, në adresimin e çështjeve dhe sfidave të përbashkëta, për një Aleancë më të fortë. Shqipëria, ka theksuar znj. Kodheli, beson se NATO luan një rol të pazëvendësueshëm në Kosovë dhe për këtë falënderoi lidhshkrimin e sekretarit të Përgjithshëm të NATO. Në lidhje me zhvillimet në Ballkanin Perëndimor, ministria Kodheli shprehu rolin pozitiv të Shqipërisë në mbështetje të paqes, sigurisë dhe prosperitetit, duke investuar me tepër për mirëqenien e rajonit. Kontributi i Shqipërisë në ISAF, KFOR etj do të vazhdojë të mbështetet plotësisht, veçanërisht në kuadër të ISAF, pas vitit 2014. znj. Kodheli u shpreh se Shqipëria do vazhdojë të punojë drejt transformimit të Forcave të Armatosura, modernizimit, interoperabilitetit, për të përmbushur obligimet si një vend aleat dhe i besueshëm. Është bindja ime, vazhdoi më tej znj. Kodheli, që një theks i veçantë do vihet në luftën kundër korrupsionit në institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes, për të poseduar një forcë të armatosur moderne, të mirë-përgatitur dhe profesioniste. Në fund të fjalës së saj, ministria Kodheli i solli sekretarit Rasmussen urimet më të mira të kryeministrit Rama dhe vendosmërinë e qeverisë shqiptare për të qenë një partner i denjë në këtë Aleancë. Z. Rasmussen duke falënderuar znj. Kodheli për mbështetjen e saj, uroi për takime të tjera të frytshme, ndërsa theksoi se megjithëse burimet mbeten të vogla, ato duhen përdorur me kujdes. Nga ana e saj, ministria Kodheli edhe njëherë theksoi, se pavarësisht nga gjendja e vështirë financiare, Shqipëria do të vazhdojë të bëjë më të mirën për të arritur qëllimet e përbashkëta. Po sot, ministria e Mbrojtjes Kodheli zhvilloi një takim me sekretarin amerikan të Mbrojtjes, z. Chuck Hagel me kërkesën e tij. Pasi e uroi për detyrën e re si ministër e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, z. Hagel vlerësoi bashkëpunimin me Shqipërinë. Ai e siguroi ministren Kodheli për mbështetjen e padiskutueshme për ekipin e ri qeverisës dhe nënvizoi faktin se po kërkohen fusha të reja bashkëpunimi. Ministria e Mbrojtjes Kodheli e falënderoi sekretarin amerikan të Mbrojtjes, z. Hagel për mbështetjen e SHBA ndaj qeverisë shqiptare, si dhe i bëri ftesën e qeverisë për të vizituar vendin tonë, ftesë të cilën z. Hagel e pranoi me kënaqësi. Gjatë ministerialit të NATO që po mbahet në Bruksel pritet të diskutohen një gamë e gjerë çështjesh si mbrojtja kibernetike, burimet, Afganistani, zhvillimi kapaciteteve etj, të cilat do të jenë dhe objekt diskutimi në Samitin e ardhshëm të NATO në vitin 2014.

Gjatë ditës së dytë të zhvillimit të punimeve të ministerialit të NATO në Bruksel, ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli në fjalën e saj bëri me dije se Shqipëria do të vazhdojë të jetë e angazhuar në Afganistan edhe pas vitit 2014. Ministria Kodheli ka theksuar gjithashtu se FA të Shqipërisë janë të angazhuara për të marrë pjesë në stërvitjet e përbashkëta me trupa

të NATO nga viti 2015 e në vazhdim. Gjatë qëndrimit të saj në Bruksel, znj. Kodheli realizoi një bisedë telefonike nga selia e NATO me trupat tanë të dislokuar në Afganistan. Ministria Kodheli u shprehu atyre mbështetjen e qeverisë dhe të Ministrisë së Mbrojtjes për vëmendjen dhe kujdesin e vazhdueshëm që u kushtohet trupave që janë në misionet paqeruajtëse, si dhe u uroi atyre suksese në realizimin e detyrave fisnike dhe kthim të shëndoshë në Atdhe. Gjatë qëndrimit në Bruksel, ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli zhvilloi një takim me ministrin e Mbrojtjes së Italisë, z. Mario Mauro, me kërkesë të këtij të fundit. Ministri Mauro e uroi zonjën Kodheli për detyrën e re dhe e ftoi atë të vizitojë Romën në një kohë të përshtatshme. Ai vlerësoi lart bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes midis dy vendeve tona dhe theksoi nevojën për intensifikimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, kryesisht në drejtim të rritjes së kapaciteteve, kontrollit të hapësirës detare dhe në fushën e modernizimit. Nga ana e saj, ministria Kodheli theksoi se, bashkëpunimi i deritanishëm ka qenë shumë i mirë, duke vlerësuar në këtë kontekst kontributin e Italisë në fushën e edukimit dhe trajnimit të ushtarakëve të FA shqiptare, si dhe në fushën e logjistikës. Duke e falënderuar kolegun italian për ftesën, ministria Kodheli u shpreh e gatshme për të realizuar një vizitë në Romë në një kohë sa më të shpejtë. Po këtë ditë, ministria e Mbrojtjes Kodheli zhvilloi një takim pune me ministrin e Mbrojtjes së Greqisë, z. Dimitrios Avramopoulos, me kërkesën e këtij të fundit. Takimi u fokusua në çështje të bashkëpunimit dypalësh në fushën e Mbrojtjes, si dhe në situatën politike në rajonin e Ballkanit. Të dy bashkëbiseduesit ndanë të njëjtin mendim se marrëdhëniet mes dy vendeve tona janë në një nivel të shkëlqyer, të bazuar mbi një arkitekturë të re të bashkëpunimit dypalësh. Duke u ndalur tek fillimi i qeverisjes së re të kryeministrit Rama, ministri Avramopoulos u shpreh se Shqipëria meriton një të ardhme më të mirë dhe beson se kjo do të vijë me lidhshkrimin e guximshëm dhe vizionar të kryeministrit Rama dhe kabinetit të ri qeveritar. Duke e falënderuar për takimin, znj. Kodheli vlerësoi marrëdhëniet mes dy vendeve në fushën e Mbrojtjes dhe shprehu optimizmin e qeverisë së re për ndryshime të thella drejt një të ardhmeje më të mirë për vendin. Në vijim të takimeve dypalëshe që zhvilloi në Bruksel, ministria Kodheli zhvilloi një takim pune me asistentin e sekretarit të Mbrojtjes për Çështjet Strategjike dhe Globale të SHBA, znj. Madelyn R. Creedon. Duke falënderuar Shqipërinë për bashkëpunimin e shkëlqyer me palën amerikane në bashkë-kryesimin e Komitetit të NATO për Mospërhapjen, në formatin e Mbrojtjes për vitin 2012-2013, zonja Creedon u ndal në ecurinë e marrëdhënieve dypalëshe në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes. Të dy bashkëbiseduesit ndanë të njëjtin mendim se marrëdhëniet mes dy vendeve janë në një nivel të shkëlqyer. Ministria Kodheli theksoi se, Shqipëria mbetet e angazhuar për të bashkëpunuar me SHBA, si partneri ynë strategjik dhe për të eksploruar fusha apo projekte të reja bashkëpunimi, në funksion të kontributeve që vendi ynë duhet të japë për një botë më të sigurtë, duke rritur kështu me tej rolin e Shqipërisë në këtë fushë.

Burimi: mod.gov.al



Kremtohet 15 vjetori i krijimit të Forcave Speciale

Paraditen e datës 18 tetor 2013, në ambientet e garnizonit të Zall-Herrit u kremtua 15-vjetori i krijimit të batalionit të Forcave Speciale. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm: ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi, zv/ministri i Mbrojtjes, Dritan Hila, zëvendësambasadori i SHBA në Tiranë, Henry Jardine, gjeneralë dhe ushtarakë të tjerë të Forcave të Armatosura, atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë, ish-drejtuës të këtij batalioni, si dhe mjaft të ftuar të tjerë. Fjalën e hapjes në këtë ceremoni e mbajti komandanti i Batalionit të Forcave Speciale, kolonel Dritan Demiraj. Më pas, të pranishmit i përshëndeti ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, e cila, ndër të tjera, theksoi se, është një kënaqësi e veçantë për mua t'ju drejtohem me rastin e 15-vjetorit të formimit të batalionit të Forcave Speciale. "Unë besoj se në këtë ditë të veçantë duhet të bashkohemi në falënderimin dhe mirënjohjen për të gjithë brezat, që me punën dhe sakrificat e tyre kanë dhënë kontribut të çmuar për ta kthyer batalionin e Forcave Speciale në repartin pararojë, që zotëron përgatitjen dhe kapacitetet

e nevojshme për të kryer një spektër të gjerë të operacioneve brenda dhe jashtë vendit" – ka nënvizuar ministrja Kodheli. Me këtë rast, ajo ka vlerësuar Forcat e Armatosura Turke për mbështetjen që kanë dhënë për ngritjen dhe fuqizimin e këtij batalioni, si dhe mbështetjen bujare që kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet instruktorëve të Forcave Speciale në fushën e trajnimit të shtabit të batalionit, por edhe të trupave, me stërvitjet paradisllokuese. "Ne i jemi mirënjohës SHBA për mbështetjen e gjithanshme që ata u japin kontingjenteve tona, në veçanti kontingjenteve "Eagle" të batalionit të Forcave Speciale, në përmbushjen me sukses të misionit në operacionin ISAF në Afganistan", - shtoi znj. Kodheli. Në vijim të fjalës së saj ministrja e Mbrojtjes Kodheli tha: "Vlerësimi dhe mirënjohja iu drejtohet sot të gjithë atyre djemve dhe vajzave të këtij reparti që prej më shumë se 10 vjetësh janë rreshtuar përkrah aleatëve të vendit tonë, të barabartë midis të barabartëve, për të shërbyer në shumë rajone të botës, në Bosnjë dhe Hercegovinë, Irak, Afganistan, Çad dhe kudo ku paqja dhe stabiliteti kanë qenë në rrezik. Imazhi që këto forca kanë përcjellë kudo ku

kanë shërbyer dhe kanë mbajtur gjithë krenari flamurin tonë kombëtar, ka qenë imazhi i shpresës dhe paqes”. Më tej, znj. Kodheli duke nënvizuar përkushtimin ndaj detyrës që kanë manifestuar efektivat e këtij batalioni, është ndalur dhe ka kujtuar aktin heroik të kapiten Feti Voglit. “Në këtë 15-vjetor, ne kujtojmë me nderim të thellë veprën e “Dëshmorit të Atdheut”, kapiten Feti Vogli, i cili nuk kurseu as jetën e tij të re për të siguruar një të ardhme më të mirë për popullin afgan, të cilët çdo ditë jetojnë nën terrorin e ekstremistëve dhe terroristëve, por edhe për një të ardhme më të mirë për të gjithë ne” - është shprehur ministrja Kodheli. Në fund të fjalës së saj, ministrja Kodheli, duke iu drejtuar edhe njëherë efektivit të batalionit të Forcave Speciale, theksoi: “Shpreh besimin e plotë se ju nuk do të stepeni para vështirësive, por do të vazhdoni me vendosmëri në rrugën pa kthim, për të përfaqësuar denjësisht Forcat e Armatosura dhe Atdheun tonë si një vlerë të shtuar në Aleancë”. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Xhemal Gjunksi i ka akorduar Batalionit të Forcave Speciale medaljen “Repart i Shquar” me këtë motivacion: “Për realizimin me sukses dhe përgjegjësi të lartë të detyrave brenda dhe jashtë vendit, si dhe për përmbushjen me sukses të misioneve luftarake në Afganistan”. Gjatë kësaj ceremonie, ministrja e Mbrojtjes Kodheli është takuar me familjarët e Dëshmorit të Atdheut, kapiten Feti Vogli, të cilët morën pjesë në përvjetorin e krijimit të batalionit të Forcave Speciale. Më pas, ministrja e Mbrojtjes Kodheli dhe të pranishmit e tjerë në këtë aktivitet vizituan muzeun e batalionit të Forcave Speciale, ndërsa më pas ndoqën nga afër disa demonstrime stërvitore që zhvilluan trupat e këtij batalioni, të shoqëruara edhe me mjete të blinduara dhe helikopterë të Bazës Ajrore në Farkë.

Ministrja e Mbrojtjes Kodheli takon komandantin e KFOR, gjeneralmajor Farina

Në datën 16 tetor 2013, ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli priti në një takim të veçantë koman-

dantin e KFOR-it, gjeneralmajor Salvatore Farina, i cili ndodhet në vendin tonë për një vizitë zyrtare. Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Salvatore Farina, falenderoi ministren Kodheli për pritjen që i rezervoi dhe njëkohësisht e uroi për detyrën e re si ministre e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë. Më tej, ai ka theksuar se, bashkëpunimi i Forcave të Armatosura shqiptare me KFOR ka qenë i vijueshëm dhe i suksesshëm. Gjeneralmajor Farina është ndalur veçanërisht në situatën në veri të Kosovës, e cila kohët e fundit ka pësuar ndryshime të ndjeshme pozitive. Në këtë kontekst, ai ka nënvizuar nevojën e projekteve gjithëpërfshirëse për komunitetin e kësaj zone dhe mbështetjen e këtyre projekteve nga faktori ndërkombëtar. Gjithashtu, gjeneralmajor Farina ka theksuar se, takimet dypalëshe në nivelin politik midis Kosovës dhe Serbisë kanë ndikuar në uljen e tensionit dhe krijimin e një klime mirëbesimi sidomos në veri të Kosovës. Ministrja e Mbrojtjes Kodheli, pasi i uroi mirëseardhjen në Tiranë gjeneralmajor Farinas, vlerësoi rolin dhe kontributin që forcat ushtarake të KFOR kanë dhënë për forcimin e sigurisë në Kosovë. Ajo vlerësoi sidomos punën e bërë dhe arritjet e shënuara gjatë këtyre viteve për ngritjen, forcimin dhe konsolidimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës, duke nënvizuar edhe ndihmën dhe mbështetjen e vazhdueshme që Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë dhënë në këtë proces. Gjithashtu, ministrja e Mbrojtjes Kodheli, u shpreh se, ne duhet të punojmë së bashku për integrimin e Kosovës në strukturat euroatlantike. Në vijim, ministrja e Mbrojtjes Kodheli dhe gjeneralmajor Farina kanë diskutuar për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit midis FASH dhe KFOR, rreth situatës në rajonin tonë dhe angazhimin e përbashkët në interes të rritjes dhe forcimit të mëtejshëm të paqes dhe të sigurisë etj. Më herët, komandanti i KFOR, gjeneralmajor Salvatore Farina u prit me një ceremoni të veçantë, me trup roje nderi, nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Xhemal Gjunksi. Gjithashtu dy ushtarakët e lartë zhvilluan edhe një takim të përbashkët.





Prezantohet zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Dritan Hila

Në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes, në datën 8 tetor 2013, u zhvillua një ceremoni e veçantë me rastin e prezantimit të zëvendësministrit të Mbrojtjes Dritan Hila. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin: ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura (FA), gjeneralmajor Xhemal Gjunksi, zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Viktor Berdo, drejtuës dhe ushtarakë të lartë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm. Në fjalën e saj përshëndetëse me këtë rast, ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli u shpreh: "Kam kënaqësinë të prezantoj sot përpara jush zëvendësministren e Mbrojtjes, Dritan Hila. Dritani, ka vijuar më tej, znj. Kodheli, ka shërbyer për një kohë të gjatë në konsullatat tona jashtë vendit. Ai është një analist, gazetar dhe profesionist i shquar". Duke u ndalur tek rëndësia që ka institucioni i Ministrisë së Mbrojtjes, ministrja Kodheli ka theksuar: "Kemi shumë gjëra për të bërë, duke filluar që nga rishikimi dhe deri tek përpunimi i strategjive, në mënyrë që të bëhet e mundur çuarja përpara e misionit tonë si Ministri e Mbrojtjes dhe si Forca të Armatosura, për aq kohë sa vendi ynë është anëtar i NATO". Më tej gjatë fjalës së saj, ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli ka shprehur bindjen se z. Hila do të këtë mbështetje të plotë në detyrën e tij fisnike dhe të vështirë. "Unë jam shumë e kënaqur me këtë vendimarrje të kryeministrit Rama, sepse e shoh Dritanin, jo vetëm si një person të denjë për të qenë në këtë pozicion ku është, por edhe si një bashkëpunëtor shumë të mirë timin". Në fund të fjalës së saj, ministrja e Mbrojtjes, Kodheli ka falënderuar të gjithë stafin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm për punën që ka bërë deri më sot dhe për mbështetjen që i ka dhënë asaj në pozicionin e ministres së Mbrojtjes.

Ministrja Kodheli, takime me ministren Plotësuese të Mbrojtjes të Greqisë dhe ministrin e Mbrojtjes të Kroacisë

Ministrja e Mbrojtjes e Shqipërisë, Mimi Kodheli, në

Ministerialin Gjithëpërfshirës të Rajonit 2013 (Comprehensive Regional Ministerial), në Brdo, Slloveni, në datë 3 tetor 2013 ka zhvilluar një takim dypalësh me ministren Plotësuese të Mbrojtjes Kombëtare të Greqisë, Fofi Gennimata, me kërkesën e kësaj të fundit. Pasi e uroi për detyrën, znj. Gennimata shtroi si çështje domosdoshmërinë e forcimit të bashkëpunimit midis dy vendeve tona. Znj. Gennimata, në mënyrë të veçantë u ndal në nevojën për realizimin e më shumë aktiviteteve në kuadër të Planit të Bashkëpunimit Dypalësh. Nga ana e saj, ministrja Kodheli, duke e falënderuar për takimin dhe mbështetjen e znj. Gennimata, theksoi domosdoshmërinë e forcimit të marrëdhënieve, si dy vende fqinjë me një histori të lashtë dhe interesa të përbashkëta. Po sot, ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli është takuar edhe me ministrin e Mbrojtjes të Kroacisë, Ante Kotromanović. Në këtë takim, të dy ministrat e Mbrojtjes

ndanë mendimin se marrëdhëniet e deritanishme mes dy vendeve tona nuk kanë qenë në nivelin e dëshiruar. Për këtë arsye, ridimensionimi i tyre është i domosdoshëm. Duke u përqendruar në rëndësinë që merr Iniciativa A-5 për vendet pjesëmarrëse, ministri kroat i Mbrojtjes, Kotromanović vuri theksin në rritjen e bashkëpunimit në kuadër të kësaj iniciative. Me tej, ai theksoi gatishmërinë e vendit të tij për të mbështetur integrimin e Kosovës në iniciativat rajonale. Bashkëpunimi nëpërmjet projekteve të përbashkëta dhe më konkretisht rreth sigurisë detare, rritja e bashkëpunimit ndërmjet Forcave Detare të dy vendeve për mbrojtjen nga ndotja të detit Adriatik, ishin gjithashtu në fokus të bisedimeve, sipas propozimit të paraqitur nga ministrja Kodheli. Gjithashtu, ministrja Kodheli kërkoi që bashkërisht të gjenden rrugë të reja bashkëpunimi, të cilat të mund të përfshijnë edhe Kosovën. Po ashtu, pala kroate ofroi mundësinë e trajnimit të personelit ushtarak në fusha për të cilat Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë nevojë. Ministrja Kodheli, duke vënë theksin në vlerat e përbashkëta të të dy vendeve, konfirmoi gatishmërinë e saj dhe të Ministrisë së Mbrojtjes për ridimensionin e marrëdhënieve dypalëshe, duke filluar pa humbur kohë implementimin e projekteve të përbashkëta. Në fund të takimit, ministri kroat i Mbrojtjes Kotromanović ftoi ministren e Mbrojtjes së Shqipërisë, Kodheli për një vizitë zyrtare në Kroaci.

Ministrja e Mbrojtjes Kodheli merr pjesë në Ministerialin e Mbrojtjes të Europës Juglindore (SEDM)

Në ditën e dytë të Ministerialit Gjithëpërfshirës të Rajonit 2013 (Comprehensive Regional Ministerial), datë 3 tetor 2013, që u mbajt në Brdo, Slloveni, ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli mori pjesë në takimin e ministrave të Mbrojtjes të vendeve të Europës Juglindore (SEDM). Ministrja Mbrojtjes, Mimi Kodheli në fjalën që mbajti në këtë ministerial theksoi se, procesi 17 vjeçar i SEDM ka qenë shumë i suksesshëm dhe ka ndikuar në dobi të paqes, stabilitetit, sigurisë dhe demokracisë në rajon. Sot pas shumë vitesh që nga krijimi, ka theksuar ndër të tjera znj. Kodheli, vihet re një diversitet anëtarësimi në këtë iniciativë, shumë vende janë anëtare të Bashkimit Europian dhe NATO, shumë vende të tjera po ndërmarrin hapa të shpejtë për t'u

bërë pjesë e këtyre organizatave duke marrë si shembull eksperiencën e vendeve tashmë të integruara. Në vijim të fjalës së saj, ministria Kodheli nënvizoi se, që nga krijimi i SEDM dhe SEEBRIG, shumë gjëra kanë ndryshuar, ambienti i sigurisë dhe mbrojtjes ndryshon në mënyrë konstante dhe për pasojë lind nevoja të përballemi me sfida të reja. Shqipëria ka mbështetur dhe do të vazhdojë të mbështesë çdo projektet të SEDM duke përfshirë dhe projektet e reja, të cilat i shërbejnë stabilitetit në rajon e më gjerë, ka theksuar znj. Kodheli. Në këtë kuadër znj. Kodheli shprehu mbështetjen e Shqipërisë për zhvillimin e "interoperability and deployability" të SEEBRIG në mënyrë që të rrisë aftësinë e tij në dobi të paqes dhe sigurisë rajonale, por edhe në dobi të misioneve ushtarake ndërkombëtare të NATO. Gjatë fjalës së saj, ministria e Mbrojtjes Kodheli e vuri theksin edhe në një nga çështjet kryesore të SEDM, siç është zgjerimi i kësaj iniciative me anëtarë të rinj. Më konkretisht, znj. Kodheli deklaroi se, politika e dyerve të hapura është konsideruar si një nga parimet madhore të zhvillimit të rajonit dhe për këtë arsye, Shqipëria qëndron thëllësisht e angazhuar në mbështetjen e kësaj politike për çdo vend që pranon parimet dhe kërkon të kontribuojë në kuadër të kësaj iniciative. Në këtë kontekst, theksoi ministria Kodheli, bashkëpunimi rajonal nuk do të jetë i plotë pa pjesëmarrjen e të gjithë vendeve të rajonit, përndryshe politika e dyerve të hapura, që ne promovojmë aq shumë, do të humbte kontekstin e saj. Znj. Kodheli nënvizoi, se duke marrë në konsideratë marrëveshjen e arritur midis Kosovës dhe Serbisë, në muajin prill, ku të dyja palët kanë dhënë angazhimin për të punuar së bashku drejt një të ardhme më të mirë drejt Bashkimit Evropian, ftoj të gjithë vendet anëtare të kësaj iniciative të orientohen drejt të ardhmes për sa i takon implementimit të politikës së dyerve të hapura.

Ministria e Mbrojtjes Kodheli në Ministerialin e Mbrojtjes, SHBA-Karta e Adriatikut

Në kuadër të Ministerialit Gjithëpërfshirës të Rajonit 2013 (Comprehensive Regional Ministerial), që u organizua në Brdo, Slloveni, në datën 2 tetor 2013, ministria e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, mori pjesë në Ministerialin e Mbrojtjes, SHBA-Karta e Adriatikut (A-5). Ministeriali i Mbrojtjes Karta e Adriatiku

(A-5), u hap nga ministri i Mbrojtjes malazez, Milica Pejanović Durišič, kryetari i mbledhjes së kësaj iniciative. Ministrat e Mbrojtjes konfirmuan dhe njëherë rëndësinë e procesit të Integritimit Euro-Atlantik për forcimin e stabilitetit dhe sigurisë në vendet e Europës Juglindore. Në këtë takim një rëndësie të veçantë iu kushtua rolit të Shqipërisë, Kroacisë dhe SHBA, si vende anëtare të NATO, në mbështetjen që po i japin vendeve të tjera pjesëmarrëse në këtë iniciativë në procesin e integritimit në NATO apo struktura të tjera rajonale. Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë, Mimi Kodheli gjatë fjalës së saj garantoi se Shqipëria do të jetë pjesë e nismave të ndërmarra nga A-5 për të ndihmuar Afganistanin në fushat e këshillimit ushtarak, policinë ushtarake, si dhe trajtimin mjekësor. Gjithashtu, ministria Kodheli diskutoi në lidhje me projektet e ndërmarra në kuadër të kësaj iniciative si mekanizim praktik i bashkëpunimit rajonal. Në vijim të fjalës së saj, ministria Kodheli ka theksuar se, bashkëpunimi rajonal duhet të orientohet në konceptin e "Smart Defence", si dhe në përdorimin e asetëve të përbashkëta të mbrojtjes në rast nevojë. Me këtë rast, ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë ka ofruar kontributin e saj në bashkëpunimin rajonal dhe ka ftuar vendet anëtare të A-5, por dhe vende të tjera të rajonit, të ndjekin kurse në Qendrën e Gjuhëve të Huaja apo Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes në Shqipëri, duke nënvizuar se numri i pjesëmarrëseve ndërkombëtar në këtë kurs për vitin 2013 është rritur ndjeshëm. Në vijim, ministria Kodheli i cilësoi stërvitjet e përbashkëta si një mjet i mirë për të rritur e forcuar më tej bashkëpunimin ushtarak në rajon e më gjerë, duke përmendur sidomos stërvitjen e përbashkët të organizuar në vendin tonë në vitin 2013. Ministria deklaroi më tej se, Shqipëria po përgatitet të organizojë përsëri këtë stërvitje dhe për vitin 2015, në të cilën janë ftuar të marrin pjesë vendet e A 5, por dhe vende të tjera. Shqipëria në vitin 2014 do të marrë Presidencën e Iniciativës së A-5 SHBA-Karta e Adriatikut. Është hera e parë që Presidenca merret për një periudhë 1 vjeçare, pasi deri me tani u ndante ndërmjet shteteve çdo 6 muaj.



BUGAJSKI HOUR

“Modernizimi? Edhe pse me më pak parà, ne mund t’ia dalim mbanë...”

Intervistë e ministres së Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli në emisionin “Bugajski Hour”



Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, mbrëmjen e ditës së shtunë, 12 tetor 2013, ka dhënë një intervistë në studion e emisionit “Bugajski Hour”, i cili transmetohet në televizionin Albanian Screen. Gjatë kësaj interviste ministrja Kodheli, duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarit të njohur Janusz Bugajski, foli për politikën e sigurisë kombëtare të Shqipërisë, për Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes, që u përmbyll vitin e kaluar dhe Planin për Zbatimin nga Ministria e Mbrojtjes, për buxhetin e Mbrojtjes dhe përdorimin e tij sa më me efektivitet, për luftën kundër korrupsionit, transparencën e munguar gjatë procesit të shitjes dhe transferimit të pronave të ushtrisë. Më tej, znj. Kodheli ka folur për NATO, çështjet e zgjerimit të saj, pjesëmarrjen dhe kontributin e Shqipërisë në Aleancë, përfshirë Afganistanin, por edhe në misione të tjera, për situatën në rajonin e Ballkanit, bashkëpunimin rajonal, bashkëpunimin mes Shqipërisë dhe SHBA, si partneri ynë kryesor strategjik etj.

Si do të përmblihdhni politikën e Sigurisë Kombëtare të Shqipërisë. Pra, në parim, cilat janë kërcënimet, sfidat, qëndrimet e detyruara dhe mundësitë?

Shqipëria u bë anëtare e NATO në prill 2009 dhe kjo ngjarje shënon historinë tonë, ashtu siç shënon dhe vitet e ardhshme. Sepse kjo ishte një zhvendosje themelore nga strategjia individuale e Mbrojtjes dhe Sigurisë drejt një strategjie kolektive. Ne kemi patur një ushtri të madhe në epokën e komunizmit, shumë prona, me një numër të madh krahasuar me numrin e popullatës dhe me municione të shumta, kjo ka ndikuar mënyrën se si ushtria shqiptare do të donte të transformohej dhe se si do të transformohej, duke respektuar dhe përmbushur obligimet e NATO, strategjinë e NATO dhe, natyrisht, duke përmbushur strategjinë e sigurisë tone kombëtare, sigurinë e vendit tonë, politikën e mbrojtjes së civilëve tanë e të trashëgimisë sonë dhe, sigurisht, mënyrën se si ne po përkrahim anëtarësimin e vendeve të Ball-

kanit për të qenë pjesë e NATO, ku, siç e dini, vetëm Kroacia është anëtare e NATO në këtë moment dhe, sigurisht, për të mbështetur Kosovën për t'u transformuar nëpërmjet të njëjtës rrugë duke qenë një anëtare e BE dhe e NATO. Dhe të gjithë së bashku të kemi një rajon më të sigurtë dhe më demokratik, dhe, pse jo, edhe më global. E dyta, është se si një vend anëtar i NATO sot, ne kemi shumë detyrime për të përmbushur. Ne kemi tashmë trupa që luftojnë në Afganistan, në kuadër të ISAF. Dhe më vonë ne do të mbështesim forcat afgane të sigurisë që ato të mësojnë se si të mbrojnë demokracinë e tyre të brishtë dhe qytetarët e tyre në të ardhmen më të afërt. Më parë ne kemi qenë thjesht një mbështetje për batalionet apo brigadat luftuese, tani jemi në frontin e parë, dhe më vonë, ne, si trupa shqiptare, do të mbështesim forcat afgane të sigurisë. Këto janë hapa shumë të mire nëpërmjet një ushtrie më efikase, më të përgatitur dhe më profesionale, ashtu siç ushtria shqiptare do të donte të ishte në të ardhmen e afërt. Ne kemi disa forca speciale dhe kemi bërë modernizime, po orvatemi të depolitizojmë ushtrinë, por ky është një proces, nuk është diçka që ne mund ta bëjmë sa hap e mbyll sytë. Ministria e Mbrojtjes, nën Qeverinë Rama, ka për të punuar në drejtime të ndryshme për të bërë që gjërat të funksionojnë më mirë, dhe, natyrisht, për të siguruar qytetarët shqiptarë që ata do jenë të mbrojtur më mirë se më parë, që ata të gëzojnë mbështetje dhe se, kësodore, demokracia dhe sundimi i ligjit mund të funksionojnë më mirë dhe e ardhmja e fëmijëve të tyre mund të jetë më e mirë. Ministria e Mbrojtjes dhe politikat e Qeverisë së Shqipërisë janë pjesë e këtij konteksti. Ne duhet ta udhëheqim këtë proces. Dua të kalojmë në çështjen më të gjerë të NATO, përfshirë dhe post-Afganistanin, mbas disa minutash, por më lejoni t'ju pyes gjerësisht mbi Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes, që u përmbyll vitin e kaluar. Hapi tjetër është Plani për Zbatimin nga Ministria e Mbrojtjes. Cili është plani juaj, dhe, ç'është më e rëndësishmja, si do të preket ai nga buxheti i Mbrojtjes, sepse, siç e dini, situata financiare që qeveria e re gjeti nuk është fort e shëndetshme.

Si do të ndikojë kjo në jetësimin e doktrinë strategjike?

Në Parlament, Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes u miratua këtë vit. Ky është një dokument tejet strategjik mbi të cilin ne do të ndërtojmë strategjinë tonë mbrojtëse. Por, natyrisht, ne na duhen para për ta jetësuar atë, dhe kjo s'është periudha më e mirë, nga pikëpamja financiare. Përkundrazi. Unë kam një arsimim dhe një të kaluar si ekonomiste dhe financiere dhe e di përse bëhet fjalë më shumë se sa të tjerë njerëz. E vërtetë! Ne kemi gjetur një nga skenarët më të këqij, ku Shqipëria ka qenë gjatë dy dekadave të fundit. Më e keqja ishte në vitin 1997, me skemat piramidale, dhe tjetra është e tashmja. Kam parë të dhënat dhe, në fund të vitit, ne kemi për të patur gjithnjë e më pak të ardhura. Nga 25.3% e PBB (Prodhimi i Brendshëm

Bruto), të ardhurat do të shkojnë në 23.8% dhe kjo është një shumë e madhe parash, gjë që do të thotë se ne do të kemi shkurtime në të gjithë sektorët dhe kjo natyrisht do të prekë edhe Ministrinë e Mbrojtjes, por ne gjithsesi do të përmbushim obligimet tona ndaj NATO. Më e rëndësishmja është të kemi përpjesëtime të mira kur të hartojmë buxhetin. Detyrimet ndaj stafit në paga; zbatimin e shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe atyre operacionale dhe shpenzime të tjera, natyrisht, kanë për të ndihmuar ushtrinë shqiptare dhe Ministrinë e Mbrojtjes të përmbushin dhe të respektojnë plotësisht Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes, i cili është një aspekt kyç jo vetëm i politikës sonë ushtarake, por edhe i politikës sonë të jashtme. Në këtë rast, ne do të orvatemi fort të shkurtojmë shpenzimet që nuk na duhen.

E dyta, të përdorim në mënyrë efikase paratë që kemi.

E treta, e fundit, por jo më pak e rëndësishmja - madje përkundrazi më e rëndësishmja - të luftojmë korrupsionin.

Sapo do t'ju pyesja për këtë

Pra, ne jemi plotësisht të përfshirë në këtë kohë të hartimit të buxhetit. Falë Zotit unë kam disa kolegë që janë ekspertë mjaft të mirë. Unë vetë po ashtu, gjë e cila nuk është domosdoshmërisht detyra e një ministri, kam për të kryer kontrollin personalisht për shkak të të gjitha arsyeve që u rreka t'ju shpjegoja. Kjo është tej mase e rëndësishme sepse ne kemi nevojë të përmbushim disa detyrime dhe njëri prej tyre është se trupat tona duhet të modernizohen, duhet të mbështeten me pajisje moderne, e kam fjalën për trupa që në përgjithësi janë të përgatitura për të shkuar në Afganistan dhe jo vetëm, por edhe në misione të tjera paqeruajtëse.

Dhe të jenë ndërvepruese me trupat e tjera!

Natyrisht! Ato duhet të jenë në të njëjtin nivel e të kenë të njëjtën përgatitje që nga pajisjet e në gjithçka që atyre u duhen. Pra, kemi shpenzime që duhet t'i bëjmë medoemos, por ne mund të gjejmë mënyrën për t'i bërë ato si mos më mirë. Ne jemi këtu për të bërë pikërisht këtë gjë, sepse njerëzit na dhanë votën, gjithashtu për ta bërë këtë në një mënyrë më të mirë. Dhe kjo është njëra nga gjërat që ne kemi për t'u treguar atyre, me më pak para, ne mund t'ia dalim mbanë.

Evropa dhe Amerika përballen me të njëjtin problem: buxhet më të vogël, riorganizim më të madh, ministri të mbrojtjes dhe rrjete ushtarake më efikase, pra, them se Shqipëria s'është e vetme në këtë orvatje. Më lejoni t'ju bëj një pyetje specifike. Kur ju ishit në opozitë, socialistët kritikuan Ministrinë e atëhershëm të Mbrojtjes mbi çështjet e korrupsionit, shitjes dhe transferimit të pronave të ushtrisë, etj., një problem specifik, i cili kishte të bënte me Shtëpinë Qendrore të Ushtrisë që iu dha PD mbas zgjedhjeve. Çfarë ka për të ndodhur me këto çështje, si kjo që ju përmenda?



Kodheli: Siç e ceka më parë, ushtria zotëronte prona të shumta më parë. Disa gjendeshin në vende mjaft të këndshme, ose në disa pjesë strategjike e delikate të Shqipërisë dhe gjithashtu edhe në qendër të Tiranës. Ne patëm një diskutim të madh kur ishim në opozitë, jo vetëm mbi faktin se si trajtoheshin këto prona, por po ashtu mbi të gjithë procesin korrptiv në të cilën ato u dhanë, apo u shitën, apo u nxorën në ankand. Pra, ka për të patur një diskutim të madh dhe ne kemi për t'i kontrolluar një nga një të gjitha rastet, natyrisht, duke i bërë auditim, duke i inspektuar dhe në fund të historisë, transparenca është gjëja më e mirë që mund të ndodhë kësokohe. Ne do t'u tregojmë qytetarëve nëse pronat e tyre, meqenëse ato janë prona të përbashkëta, përdoren nga njerëzit e duhur apo njerëzit e gabuar, shiten në mënyrën e duhur, apo në mënyrën e gabuar, janë dhuruar si pronë e përbashkët, apo sikur të ishin prona të qeverisë, gjë që përbën një ndryshim të madh, pra, nëse prona është e jona apo e qeverisë. Ajo duhet të jetë gjithmonë e jona, kështu që ne duhet të jemi vërtet transparentë kur kalojmë pronësinë nga njëra palë te tjetra. Në rastin specifik, parimisht, unë s'jam kundër faktit që një pronë e përbashkët të kalojë nga Ministria e Mbrojtjes tek një organizatë tjetër publike, siç është rasti i një partie, problemi qëndron tek procedurat, tek transparenca, pra kjo është më e rëndësishmja. Nëse s'ka procedura, nëse s'ka transparenca, nëse s'ka ligj ku këto procedura janë bazuar, nëse gjithçka është kundër gjithçkaje ligjore, këtu ne kemi një problem të madh. Edhe diskutimet tona, madje që përpara se unë të merrja detyrën, fokusoheshin pikërisht në këtë pikë: përse ata duhet të ndërtonin mure kaq të mëdha ndërmjet tyre dhe publikut, ndërmjet tyre dhe medias, ndërmjet tyre dhe njerëzve që janë të interesuar të dinë se këto prona s'po shiten si torta, s'po shiten për interesa mjaft të ngushta, por ato po përdoren për interesa të përbashkëta. Kjo është pika ku fundja fundit ne duhet të fokusohemi: interesi i përbashkët.

Më lejoni t'ju bëj një pyetje mbi korrupsionin, më saktë mbi politizimin. A do të thonit se ushtria

shqiptare në tërësi është plotësisht e depolitizuar sipas standardeve të NATO?

Aspak! Përkundrazi!

A mund ta shpjegoni!

Shikoni, do të na duhej një orë e tërë për ta shtjelluar, por unë po përpiqem ta them shkurtimisht. Në gjirin e Forcave të Armatosura (FA) dhe të Ministrisë së Mbrojtjes ka pasur shumë trysni lidhur me faktin se ai që s'voton për PD, nuk është pjesë e jona. S'mund të jetë kurrësi kështu. Ne do t'i vëmë fre kësaj gjëje njëherë e mirë. Ushtria është ushtri. Ajo ekziston që të mbrojë integritetin e Shqipërisë, që të mbrojë demokracinë e Shqipërisë, që të mbrojë pronat e qytetarëve, që të mbrojë gjithçka në të mirën e të ardhmes sonë. Pra, ushtria s'ekziston për të treguar nëse ushtarakët kanë votuar për PD apo PS, apo për parti të tjera. E dyta, ka shumë korrupsion, jo vetëm kur diskutojmë mbi pronat apo mbi tenderat apo ankandet apo mbi çdo aktivitet ekonomik që Ministria e Mbrojtjes ka në kornizën e saj, por gjithashtu edhe kur flasim për karrierën, e cila është një temë tjetër që ne do ta ballafaqojmë dhe me të cilën unë ballafaqohem që tani. Po them vetëm një gjë: paraardhësi im kishte vendosur disa yje në spaletat e disa gjeneralëve apo kolonelëve të FA në muajin maj, një muaj para zgjedhjeve, me ligj procesi duhet të përfundonte në shtator.

Shtatorin e kaluar!

Jo, këtë shtator! Pra, ata nxituan që të vendosnin disa yje shtesë në karrierën e dikujt vetëm për të pasur disa vota më tepër, sepse unë s'shoh asnjë arsye tjetër. Dhe kjo s'është e vetmja me të cilën unë po përballem. Ka një mori gjërash! Por...ka një "por" të madhe... Ne jemi me fat që kemi në gjirin e ushtrisë shqiptare dhe të Ministrisë së Mbrojtjes edhe profesionistë dhe njerëz të mirë, të cilët respektojnë ligjin dhe Kushtetutën dhe të cilët respektojnë të gjitha llojet e procedurave. Pra, në këtë rast, ka akoma një mori nëpunësish civilë apo ushtarakë që i mbajnë Forcat e Armatosura të Shqipërisë dhe Ministrinë e Mbrojtjes ashtu siç duhet të jetë. Pra, në këtë rast, them dhe shpresoj që puna ime ka për të qenë më e lehtë, por ka shumë punë për të bërë. Diçka që duhet ta përmend me-

doemos është fakti se korrupsioni ka prekur edhe Shërbimin Informativ dhe madje tejet negativisht. Ka raporte konfidenciale ndërmjet shërbimeve të inteligjencës të anëtarëve të NATO, dhe nëse dikush nga jashtë mëson se ka korrupsion, atëherë ky mund të jetë një problem tejet i rrezikshëm dhe i madh. Pra, agjensia që po merret me shërbimin informativ brenda Ministrisë së Mbrojtjes duhet të ristrukturohet dhe riorganizohet sipas standardeve të NATO dhe lufta kundër korrupsionit ka për ta bërë atë një shërbim më të mirë e më efikas.

Paskeni goxha punë gjatë mandatit tuaj në detyrë! Më lejoni t'i kthehemi tani çështjes së NATO! Ju përmendët pak më parë rolin e Shqipërisë në Afganistan dhe planet pas tërheqjes së forcave të NATO-s...

Në 2014!

Pikërisht! Vitin tjetër! A mund të na jepni një tablo të kontributeve të Shqipërisë në Aleancë, përfshirë Afganistanin, por edhe në misionet e tjera, në teatro të tjera?

Ne jemi një ushtri modeste, por ama gjatë këtyre viteve ne kemi shërbyer me rreth 5 mijë trupa në mbarë botën, i cili është një numër i madh krahasuar me numrin e ushtrisë që kemi, apo me numrin e qytetarëve!

Disa anëtarë më të vjetër të NATO kontribuojnë pjesërisht po aq sa ju!

Po! Pra, ka më tepër se kaq. Trupat tona janë vlerësuar si nga më të mirat që kanë shkuar në front. Ky është lajm i mirë. Por ne jo vetëm, ne që kemi qenë pjesë e misioneve paqeruajtëse duke mos luftuar vetëm në vijën e parë të frontit, por sigurisht ne kemi edhe shumë gjëra të tjera për të bërë, p.sh., të përpiqemi të përmirësojmë strategjinë tonë në kornizën e strategjisë së NATO. Dhe diçka që ka shumë rëndësi, të cilën unë dua ta nënvizoj, është fakti se roli i Shqipërisë në përgjithësi, në aspektin politik dhe roli i ushtrisë shqiptare në Ballkan është një rol tejet i rëndësishëm. Pra, ne po përpiqemi të mbështesim vendet që duan të jenë pjesë e NATO në të ardhmen, si Mali i Zi, Maqedonia, apo Bosnja Hercegovina. Dhe sigurisht, të mbështesim rrugën e re që Brukseli hapi me marrëveshjen ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, e cila natyrisht ka për të hapur perspektiva të reja për rajonin në përgjithësi dhe perspektiva të reja për të gjithë ne, pasi ne e dimë objektivin tonë dhe objektivi ynë është BE dhe strukturat euroatlantike. Pra, të gjithë ne duhet të punojmë bashkërisht, Shqipëria është një ndihmë dhe një përkrahje e madhe për të gjitha vendet që s'janë akoma në NATO, por gjithashtu të gjitha vendet duhet të japin një përkrahje të madhe për Shqipërinë në rrugën drejt BE. Rajoni tani është më i sigurtë dhe ne do të na pëlqente të përfitonim nga kjo situatë, e cila do të na ndihmonte tej mase të gjithë ne. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse ne si shqiptarë kemi një rol tejet konstruktiv në rajon. Pra, kjo është tejet e rëndësishme, në kontekstin e NATO, ne kemi për të

qenë një mbështetje shumë më e madhe. Them se, nga pikëpamja strategjike kjo është tejet e rëndësishme për të gjithë ne dhe, natyrisht, ne duhet të përmbushim të gjitha detyrimet që kemi si vend anëtar i NATO. Por, në të njëjtën mënyrë, ne duhet të forcojmë funksionin e demokracisë brenda vendit tonë, gjë e cila ka për të na ndihmuar të kemi një vend të sigurtë, e kësodore ne mund të kemi më tepër investime të huaja në Shqipëri, duke patur kështu me tepër prosperitet, si dhe rezultate më të mira ekonomike, të cilat në këtë periudhë të krizës financiare janë vërtet një nga problematikat e mëdha me të cilat ne përballlemi.

Ju përmendët vendet fqinje të Shqipërisë dhe tani ka zëra nëse Samiti i ardhshëm i NATO në Londër në vitin 2014 duhet të jetë apo jo një samit zgjerimi. Ka shumë konferenca dhe diskutime mbi këtë çështje. A besoni se ka një vend që është kualifikuar plotësisht për raundin tjetër, nëse do të kishte një raund tjetër në samitin e radhës?

Shikoni vendin tim! Vendi im është një shembull i mrekullueshëm se si një vend i vogël mund të bëhet anëtar i NATO. Axhenda e Samitit s'është botuar akoma, por ka mundësi të shumta që vende të tjera të bëhen pjesë e NATO. Them se në Samitin e Londrës ne do të diskutojmë sukseset që vendet anëtare të NATO kanë arritur tashmë, pozitën e anëtarëve të NATO në Afganistan, sepse atje do të përfundojë...

Misioni ka për të përfunduar!

Po, misioni përfundon dhe një tjetër mision ka për t'u hapur, them se kjo për të qenë pjesë e diskutimeve. Dhe sigurisht, përse jo zgjerimi! NATO ka politikën e dyerve të hapura, si të gjithë ne, por natyrisht, vende të tjera duhet të përballen me kërkesat e forta të NATO dhe këto kërkesa të forta duhet të përmbushen plotësisht, përndryshe zgjerimin e shoh si një çështje që do të shtyhet.

Zgjerimi ka qenë gjithnjë një lloj stimuli për NATO në 20 vitet e fundit, sidomos me shtetet e Evropës Qendrore dhe disa prej vendeve të Ballkanit. Sa i përket kualifikimit për në NATO, a do të thonit se Mali i Zi dhe Maqedonia, si dhe vende të tjera, janë mjaftueshëm të kualifikuara për të aderuar? Pra, a janë ata në nivelin e Shqipërisë kur vendi mori ftesën?

Pyetje e mirë! Nuk e di nëse përgjigja ime do jetë po aq e mirë, por ajo që unë di me siguri është fakti se po, ndoshta ato kanë përmbushur shumë prej kërkesave, por ama ka disa çështje politike që janë pjesë e këtij procesi. Maqedonia ka një problem me emrin, kurse Mali i Zi ka probleme të tjera politike në rrugën drejt NATO. Zgjidhja e tyre me siguri ka për të bërë që ato të jenë anëtarë të NATO. Kjo është e sigurtë! Pra, s'bëhet fjalë vetëm për zgjidhjen e problemeve teknike, por edhe të atyre politike. Kjo është arsyeja përse Ballkani po jeton tanimë në një mjedis mjaft të sigurtë, por jo atje ku ne do të dëshironim të ishim. Pa zgjidhur disa probleme midis nesh, unë s'besoj se kjo ka për të qenë një detyrë e lehtë. Pra, mbetet për t'u parë!

(vijon në numrin e ardhshëm)

“EAGLE 7”

Luftëtarët e heshtur...

Zhvillimet e fundit që nga data kur kontingjenti me minisionin aktual, “Eagle 7”, u dislokua në distriktin e Spin Boldakut në Kandahar

MAJOR AJET JATA

Shef i Seksioni të Zbulimit të Batalionit të FS

Kanë kaluar më shumë se dy muaj kur Kontingjenti “Eagle 7” u dislokua në distriktin e Spin Boldakut në Kandahar. Është hera e dytë që efektiv i kësaj kompanie dislokohe në këtë rajon. Spin Boldak është një rajon strategjik në kufi me Pakistanin. Spin Boldak në veri kufizohet nga distrikti i Argistanit, në perëndim shtrihet distrikti i Tahtapolit dhe qyteti i Kandaharit ndërsa në jug kufizohet me distriktin e Shorabakut dhe në lindje kufizohet me Pakistanin. Afër vijës kufitare ndodhet qyteti i Chamanit dhe me tutje shtrihet Quetta, qytete pakistaneze. Nga këto dy qytete orkestrohen pothuajse pjesa më e madhe e sulmeve që kryhen në Afganistan dhe veçanërisht në Afganistanin jugor dhe atë juglindor. Që andej vijnë direktiva të liderëve kryesor taleban dhe thuren planet e së ardhmes. Përveç trurit, ato dy qytete njihen si baza të rëndësishme nga ku bëhet e mundur mbështetja e aktivitetit kundërshtar. Që andej sigurohet, trajnim, luftëtarë, (kamikazë) mbështetje me armë (makina dhe motorë bombë), materiale ilegale, MSHI si dhe kushte strehimi. I shtrirë në një nyje kryesore dhe pikë strategjike Distrikti i Spin Boldakut, megjithë progresin e bërë vazhdon të ngelet rajon me një aktivitet të lartë të kundërshtarit dhe të trafikimit. Terreni i përthyer në veri të autostradës nr 4 ju jep mundësinë kryengritësve të lëvizin në të dy anët e kufirit, po ashtu ju ofron mundësinë për të fshehur materialet luftarake dhe ilegale dhe për të kryer trafikim të luftëtarëve, materialeve luftarake, drogë dhe mallra të tjera nga Pakistani në Afganistani dhe anasjelltas. Falë terrenit të vështirë ku lartësitë shkojnë mbi 2500m, falë fshatrave të cilët janë pro talebanëve, kryengritësit ndihen më të sigurtë në veprimtaritë e tyre. Por ky terren aq i vështirë dhe i favorshëm për kryengritësit kthehet në një pengesë përgjatë periudhës së dimrit ku zakonisht përkon me fundin e muajit nëntor dhe fundin e muajit shkurt, ku dëborat dhe kushtet jo të mira bën të mundur ndalimin e aktivitetit në zonë. Ndaj kryengritësit eksplorojnë rrugë të tjera si rruga e shkretëtirës në jug të Distriktit të Spin Boldakut apo në periferi të qytetit të

Spin Boldakut, por rruga kryesore ngelet autostrada nr 4 që nisët nga Kandahari, kalon përmes Spin Boldakut dhe lidh qytetet, Qamman, Quetta, në Pakistan. Trafikimin e bën akoma më të lehtë korrupsioni i ngritur në sistem. Në të gjitha strukturat nepotizmi është prezent dhe fshehja e shkeljeve bëhet lehtësisht si rezultat i marrëveshjeve të brendshme. Edukimi është ana tjetër e medaljes që lidhet me korrupsionin, në shumë institucione dhe veçanërisht ato të policisë dhe ushtrisë pjesa më e madhe e tyre është analfabetë, por falë disa përpjekjeve, një numër i vogël ka mësuar të shkruajë dhe lexojë. Paraja dhe mallrat janë elementët që ndeshën më shumë në jetën e korruptuar. Mjafton të kesh para dhe mund të bësh çdo gjë. Mjafton t'i japësh diçka policit në autostradën nr 4 dhe mund të kalosh materiale ilegale apo dhe luftarake. Janë të shumta rastet kur populli ankohe se policë të pikave të ndryshme futen nëpër fshatra dhe i bastisin ato, ju marrin gjëra me vlerë dhe ushqime me pa të drejtë dhe largohen. Sistemi i krimit dhe i korrupsionit është lidhur në të gjitha hallkat, ku të vegjlit punojnë për të mëdhenjtë dhe këta të fundit sigurohen që të ruajnë influencën dhe disbalancat në raport me rivalët. Por dogana në qytetin e Spin Boldakut (Wesh Border) funksionon sipas orekseve, interesave dhe sipas individëve, nëse paguan nuk kontrollohesh dhe e kundërta. Po nga kjo doganë dhe në autostradën nr katër kalojnë një numër i madh luftëtarësh, madje dhe lider të shumë kërkuar, makina dhe motorë bombë, kamikazë, lëndë narkotike, materiale luftarake, mallra dhe material të tjera ilegale, si rezultat i rryshfetit si mjet përfitimi i dyanshëm.

Në këtë distrikt ku shtrihet 2000 m mbi nivelin e detit dhe ku kushtet klimaterike janë të vështira, si temperatura të larta për më shumë se tetë muaj dhe dimër i ashpër e vështirësojnë jetesën e këtyre banorëve. Terreni i zhveshur dhe gjelbërimi i pakët e bën shumë të vështirë përdorimin e blegtorisë, ndaj për të jetuar në pak zona kultivohet grurë, dhe disa bimë të tjera për qëllime vetjake. Ndërsa masivisht kultivohen lëndët narkotike, por për qëllime tregtie. Përdorimi i



lëndëve narkotike bëhet si rezultat i propagandës që bëjnë talebanët për mbjelljen e tyre, pasi nga ato përfitohen shuma të mëdha parash, po kështu bëhet edhe si rezultat i presionit që bëjnë liderët fisnor apo ato shtetarë. Këta të fundit kanë interesin e tyre pasi popullsisë vendase ja blejnë lëndët narkotike më çmim simbolik, ku fitimet janë kolosale, ndaj shpesh herë përplasjet për kontroll shoqërohen me humbje jete. Fraksionet fisnore e vështirësojnë dhe i japin më shumë kompleks situatave për zgjidhje, por në zonën tonë dy janë fiset kryesorë, Achekzai dhe Norzai, (por ka edhe të tjera si alokozai, popolzai, nomade etje ku fisi i parë me një pjesëmarrje simbolike të fisit norzai kontrollon strukturat komanduese dhe drejtuese në distrikt. Në vitin 2010 këto fise janë ulur për herë të parë së bashku në Spin Boldak me përfaqësuesit e tyre (kryepleqtë) për të diskutuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të shumta dhe problemeve që i karakterizojnë këto banorë. Në mënyrë shumë simbolike, familja që ka më shumë djem dhe që është e fuqishme vihet në krye të fshatit për të drejtuar punët dhe problematikën që ndeshin në jetën e përditshme, ndërsa njerëzit që kanë para dhe miqësi vihen në pozita të quajtura shtetërore drejtuese. Ndaj shumë komandantë të strukturave të ndryshme policore janë të implikuar drejtpërdrejt në veprimtari antiligjore si korrupsion, mitmarrje, shpërdorim detyre, përbushje të qëllimeve individuale etj. Shpesh herë besueshmëria e tyre vlen për tu mbajtur në mendje sa herë që i takon, pasi për interesa shumë të ngushta ato kryejnë lojë të dyfishtë dhe është e vështirë të përcaktosh se cilit krah i përket. Ku shpesh herë janë këto komandantë, të cilët i mbështesin kryengritësit dhe ju krijojnë favore talebanëve për të kryer sulme ndaj FK. Në këtë panoramë të përgjithshme të paraqitur më sipër operon Kontingjenti Eagle7, një trupë tepër kompakte, shumë profesionale dhe me njohuri

të mira të situatës që i rrethon ato çdo ditë. Mirëpo të vepros në një mjedis ku trendet e luftës ndryshojnë dita ditës, ku humbjet e jetës së Forcave të Sigurisë Afgane, pothuajse ndodhin çdo ditë si rezultat i sulmeve, minave dhe i rebelimit të kryengritësve, ku çdo javë shfaqet një lloj kërcënimi i ri, do të thotë të kesh aftësinë dhe talentin ti përshtatësh dhe të kundërveprosh. Së fundmi është konstatuar dhe vlerësuar se kundërshtari ka kaluar nga sulmet me IED në përdorimin e sulmeve direkte (armë të kalibrit të vogël) si goditja bazë, e ndjekur më pas me sulmet indirekte, sulmet me mina (MSHI), kamikazë dhe makina bombë. Deklarimi i tërheqjes së FK në vitin 2014, zgjedhjet e ardhshme në Afganistan për pushtetin qendror në pranverë të vitit 2014, reduktimi i FK dhe patrullave në terren, kalimi i kontrollit të sigurisë së forcave afgane, kanë ndikuar në rritjen dhe intensifikimin e përpjekjeve të fundit taleban për të kundërsulmuar dhe për të krijuar bindjen tek populli dhe në arenën ndërkombëtare se Afganistani nuk do gjejë paqe derisa Talebanët nuk e drejtojnë atë. Po kështu është rritur prezenca e luftëtarëve kryengritës në zonë, të cilët tashmë planet e tyre i qartësojnë më mire dhe shpesh herë edhe me mbështetjen e disa strukturave të sigurisë afgane. Objektivi i sulmit të tyre janë FK, forcat e sigurisë afgane, institucionet qeverisëse, liderët e pushtetit lokal dhe qendror si dhe persona me influencë. Por përballë gjithë kësaj situatë kërcënuese, ku ëndrrat e këqija, lodhja, pagjumësia, stresi, stërmundimet familjare janë të prekshme dhe prezente për secilin pjesëtarë, operon Kontingjenti "Eagle 7" i BFS të dislokuar në Spin Boldak, Kandahar ku zanafilla e krijimit të kësaj njësie nuk është e largët. Para 15 vitesh u krijuan FS, ndërsa sot ato operojnë në një zonë të vështirë në Afganistan. Batalioni i FS falë anës profesionale të ngritur në vite dhe veçanërisht në vitet e fundit arriti të dislokohej përkrah

vendeve të mëdha që operojnë në Kandahar që nga gushti i vitit 2010. Është herë e parë që një njësi Speciale Shqiptare kryen detyra të mirëfillta luftarake jashtë trojeve shqiptare në mbështetje të FK dhe në interes të paqes dhe stabilitetit në rajon. Investimi për krijimin e një force elitë, kompakte, profesioniste dhe lehtësisht të dislokueshme duket se po merr frytet e veta në të gjitha përfitimet, ku kjo forcë prodhon. Shpesh herë përfitimet nuk përfshijnë vetëm fushën ushtarake, por edhe atë politike, ekonomike, etj, por më me rëndësi është përfitimi profesional. Është krenari dhe vlerë kombëtare të marrësh me vete eksperiencën e luftës, eksperiencë që do ti shërbejë jo vetëm njësisë Speciale, por edhe ushtrisë dhe kombit shqiptar në tërësi për dekada të tëra. FS prej kohësh shtetet e ndryshme i kanë parë si një aset kombëtar dhe i kanë përdorur për realizimin e objektivave strategjike, politike, ekonomike apo për përmeshjen e interesave kombëtare. Duke synuar përmeshjen e qëllimeve kombëtare këto forca janë krijuar që të stërviten dhe të përdoren në mënyrë të fshehtë, duke ruajtur dhe mbajtur larg medias dhe veprimtarive të zbulimit dhe kundërzbulimit. Shpesh herë krijimi i tyre është i lidhur me vështirësitë dhe medaljen e dobët nga forcat konvencionale, madje këto forca kanë treguar se përdoren në momente kulmore në fushëbetejë duke siguruar suksesin përfundimtar mbi kundërshtarin. Historia e krijimit të tyre lidhet që në lashtësi, ku komandantët shpesh herë ndanin ushtarë të fortë dhe të mirëstërvitur dhe i përdornin për betejat që merrnin pjesë edhe mbretërit, apo këto reparte i përdornin në moment kritikë duke siguruar suksesin e betejës. Por para luftës së parë botërore këto forca marrin trajtën e njësisive më të specializuara në veprime të caktuara, përveç kësaj edhe në teknikë, kjo gjë vërehet më së miri tek forcat xheniere të Napolon Bonapartit. Gjatë Luftës së Parë Botërore, FS nuk

gjen përdorim të mjaftueshëm pasi koncepti ishte tek masa dhe jo tek cilësia, por përgjatë Luftës së Dytë Botërore, ishin FS ato të cilat formësonin betejat, mjafton të përmendim shkatërrimin e "Heavy Water" ku aleatët nuk kishin arritur ta bënin dot me anë të bombardimeve dhe se përbënte rrezik për ta nëse nazistët do të krijonin armën bërthamore në vitin 1943 nga 9 FS norvegjeze të cilat ishin të trajnuara nga Forcat Komando Angleze, ky sukses u pa në depërtimin, shkatërrimin dhe largimin pa humbje dhe dëmtime, po kështu mjafton të përmendim përdorimin e SAS-ve anglezë për shkatërrimin e avionëve nazistë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Gjatë periudhës së luftës së ftohtë FS janë parë si element i rëndësishëm në duart e shtetit dhe ato janë konsideruar si njësitë nga ku shtetet mund të përfitojnë ndaj njëra tjetrës. Ato janë përdorur në mënyrë të fshehtë kryesisht në detyra zbulimi dhe sabotazhi, por shumë pak në detyra si goditje direkte etj. Fillimi i shek XXI nxjerr në pah rrethana të panjohura dhe për rrjedhojë shtetet filluan ti kushtojnë shumë rëndësi rritjes së aftësive, cilësive dhe pajisjeve të kësaj force, ku rendimenti ishte shumë herë më i lartë sesa rendimenti i një force konvencionale ku kostoja kalonte me shumë se dhjetëfish në përdorimin e saj. Tashmë është i njohur fakti se përdorimi i FS për të njëjtin mision në vend të një armate me makineri të rëndë dhe të blinduar sjell më shumë sukses, më pak dëme kolaterale dhe minimizon koston e lartë dhe shpenzimet e paduhura. Qasjet e fundit drejt FS duke reduktuar forcat konvencionale shikohet si një trend i kohës, pasi përballë një kërcënimi modern, kërkohet një forcë e speciale, lehtësisht e dislokueshme dhe e aftë për t'u përballë me këtë lloj kërcënimi. Investimet e bëra së fundmi në njësinë e FS, si stërvitje dhe teknikë, tregojnë më së miri se ne jemi në rrugën e duhur dhe ecim në të njëjtin drejtim me të njëjtat ritme me vendet anëtare kryesore të



NATO-s dhe madje jemi pararojë për disa vende. Historitë e suksesit të kësaj njësie nuk janë krenari vetëm për ushtrinë shqiptare, por edhe për shqiptarët kudo ndodhen. Ato u krijuan në ditë të vështira saktësisht më 16 tetor 1998 me qëllimin e kryerjes së detyrave specifike në interes të FA shqiptare, rruga ka qenë e gjatë, plot sakrificë dhe mundime. Menjëherë pas krijimit të tyre ato do të përballen me vendosjen e rendit dhe luftën e Kosovës në pranverën e vitit '99'. Por rezultatet ishin domethënëse, ato treguan më së miri se profesionalizmi i tyre shkon përtej, perceptimeve dhe shpesh herë kjo prodhonte zemërim dhe xhelozik tek pjesa tjetër e ushtrisë. Plot 15 vite rrugë kaluan mbi 8 kurse bazë seleksionimi për FS, ku katër kurset e para drejtohen nga instruktorë turq, ndërsa katër të fundit batalioni rrit kapacitetet e tij dhe i drejton vetë. Misionet e kryera në Bosnjë, Afganistan, Iraku, Chadi dhe së fundmi misioni Combat, si dhe ato të Asistencës Ushtarake në Afganistan janë tregues të një force që ka ecur gjithmonë drejt progresit dhe ecjes në kahun e duhur. Vitet e fundit falë eksperiencës së grumbulluar në misionet e kaluara dhe së fundmi eksperiencës luftarake dhe trajnimit të mundësuar nga pala amerikane nëpërmjet një ekipi trajnues amerikan të lëvizshëm, stërvitjeve të përbashkëta me njësitë e FS amerikane dhe të vendeve të tjera, kurset e mundësuar nga pala amerikane për trajnimin e shtabit të batalionit të FS etj, kanë bërë të mundur rritjen e nivelit operacional të kësaj njësie të krahasueshme me vendet e tjera të NATO-s në shumë drejtime. Pa mohuar punën e të gjithë komandantëve që nga krijimi deri më sot, një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kësaj force ka luajtur edhe komandanti i FS kolonel Dritan Demiraj, ku nën drejtimin e tij FS kanë ecur me hapa galopantë drejt perfeksionimit si njësi e tillë. Ai me përvojën dhe eksperiencën e tij, solli ndryshime të reja në repart. Krahas përpjekjeve për modernizimin e pajisjeve kolonel Demiraj është fokusuar në rritjen e nivelit të stërvitjes dhe të përgatitjes së shtabit të kësaj njësie. Këto vite u soll eksperiencë e re në repart, u bënë ndryshime strukturore si dhe u modernizua në pajisje. Ndërsa fokusimi dhe interesi i treguar mbi stërvitjen dhe përgatitjen e kësaj njësie me parametrat e duhur ka treguar më së miri se ka rritur nivelin e saj operacional. Teknikat dhe taktikat e përdorura sot nga FS janë teknikat dhe taktikat e fundit dhe se me plot krenari themi se njësitë e FS shqiptare tashmë janë të afta të kryejnë tre misionet bazë të FS të NATO-s siç janë Goditjet direkte, Zbulim Special dhe Asistencë ushtarake. Por përveç këtyre detyrave njësitë e FS shqiptare kanë treguar se kanë aftësi në Operacionet kundër kryengritësve, operacione për shoqërimin e VIP, operacione të kundërzbulimit, operacione në ujë dhe në terrene të vështira si dhe operacione në shpella...etj. Përveç krenarisë së shënimit të 15 viteve, këto individë krenohen edhe me punën e bërë në terren. Për momentin kontingjenti "Eagle 7" i drejtuar nga major Pali Dakolli është forca e vetme që operon në zonën operacionale në partneritet me batalionin amerikan 1-6 FA dhe SFAAT. Për të festuar 15 vjetorin e krijimit të FS, por edhe festën e Kurban Bajramit, Eagle 7 organizoi një festë ku ishin të ftuar të gjithë aktorët pjesëmarrës në ndërtimin e paqes dhe të sigurisë në zonë. Ku merret pjesë komandanti i Batalionit 1-6 FA n/ kolonel McNeilly së bashku me kapterin White, komandanti i SFAT major Baker si dhe pjesëtarë të shtabeve të këtyre njësive, pjesëtarë të shëndetësisë, agjencive të zbulimit, të de-

partamentit të zjarrfikësve, pjesëmarrës të tjerë të institucioneve të ndryshme, shqiptarë dhe përkthyes. Përveç partnerëve nga Amerika, ne e quajmë veten krenar pasi këtu janë të punësuar më shumë se 10 shqiptarë, të cilët janë nga Prishtina, Tetova, Gjilani dhe Ferizaj, të cilët punojnë për departamentin e zjarrfikësve, për kompaninë shqiptare ekolog dhe për kompani të tjera amerikane, ku koha e lirë kalon shumë shpejt me bashkëbisedim dhe argëtim. Akoma më shumë vlen të përmendet shefi i kuzhinës së bazës, i cili është nga Gjilani, ku me gatimet e tij na ka bërë të shuajmë sadopak mallin për ushqimet tradicionale shqiptare duke gatuar enkas për ne dhe duke shtuar oksin e partnerëve tanë, të cilët i pëlqejnë në maksimum ushqimet tona. Për organizimin e festës çdo kush kishte përgjegjësitë dhe detyrat e tij, ndaj çdo gjë shkoi shumë mirë ku major Pali Dakolli përshëndeti dhe uroi mirëseardhjen e të gjithë të ftuarve. Më pas uroi besimtarët myslimanë për festën e Kurban Bajramit si dhe pjesëtarët e Eagle 7 për 15 vjetorin e krijimit të Batalionit të FS. Pasi foli për historikun e Batalionit të FS, duke theksuar në fund se ne të gjithë duhet të jemi krenar për arritjet e kësaj njësie deri më tani dhe duhet të vazhdojmë kështu, ai gjithashtu kërkoi të mbahej një minutë heshtje për heroin tonë kapiten Feti Vogli të rënë në krye të detyrës ndërsa shërbente në zonën e Rabatit. E gjithë festa u shoqërua me një ndjenjë kombëtare dhe patriotike, përveç ushqimit të gatuar sipas kërkesave tona, të ftuarve ju kushtua një përkujdesje e veçantë ku bisedat, shakatë, muzika ishin të pranishme gjatë gjithë festës. Në fund të gjithë ndaheshin me mbresa, ku të nesërmen të gjithë flisnin me superlativa për organizimin.



Projekt-ideja, Kosova dhe Shqipëria sistem të përbashkët Mbrojtje

Gjeneralbrigade Piro Ahmetaj: “Janë të gjitha rrethanat historike, gjeopolitike dhe ekonomike që të projektojmë, paraqesim dhe finalizojmë një projekt të përbashkët në fushën e Mbrojtjes midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës”

Intervista e mëposhtme me gjeneralbrigade Piro Ahmetaj, i cili pak kohë më parë ka marrë gradën madhore të gjeneralbrigade dhe është emëruar në detyrën të zëvendëshefit të SHPFA, sjell para lexuesit disa ide që kanë lidhje me procesin transformues të sistemit të Mbrojtjes. I detë e tij ai i mbështet në një eksperiencë të gjatë në strukturat e Integritimit dhe në PUK në Komandën Supreme të NATO në Evropë. Krahas opinionit që shfaq për transformimin, ai jep edhe një vlerësim në lidhje me situatën e sigurisë në Ballkan dhe Kosovë.

Gjeneral Ahmetaj, ju prej pak kohësh keni marrë gradën madhore të gjeneralit të brigadës, si dhe jeni emëruar në detyrën e rëndësishme të zv/SHSH-PFA. Cili është komenti juaj për këtë moment të rëndësishëm në jetën dhe karrierën ushtarake?

Në radhë të parë dëshiroj t'ju falënderoj për mundësinë që më jepni për të komunikuar me audiencën e revistës “Mbrojtja”, si dhe për bashkëpunimin që shprej të kemi edhe në të ardhmen. Ecuria në karrierë ka qenë dhe mbetet pa asnjë dyshim një aspiratë konstante njerëzore. Besoj se, më shumë se në çdo fushë tjetër, fjala karrierë “ngjit” më shumë në profesionin tonë, kështu që është e dëshiruar dhe natyrshme për çdo ushtarak në radhët e FA. Një yll më tepër përmbi supe do të thotë shumë më tepër përgjegjësi, pritshmëri, profesionalizëm dhe përkushtim. Në këtë kontekst, promovimin dhe detyrën e re e shoh si një privilegj, nder dhe në të njëjtën kohë përgjegjësi dhe sfidë të madhe, e cila kërkon modesti, përkushtim, vizion dhe maturi.

Ju keni një eksperiencë të gjatë në strukturat e Integritimit, dhe mbas anëtarësimit, për një periudhë 5 vjeçare si PUK në Komandën Supreme të NATO në Evropë. Nëse mundet të ndani me opinionin publik disa nga momentet dhe eksperiencën Tuaj në këtë proces ?



Ju faleminderit për vëmendjen dhe ngacmimin. Për t'ju përgjigjur pyetjes tuaj, po tregoj një histori personale që ua kam treguar shpesh shumë kolegëve të huaj: kur ndiqnim shkollën ushtarake (që siç e dini mbante emrin e diktatorit), gjuha e huaj nuk ishte me ligj e ndaluar, por ata që mësonin gjuhë të huaja shiheshin si subjekt dyshimi dhe pse jo si objekt për të dënuarit potencial të radhës. Nënvizoj se lista e ushtarakëve të dënuar është më e gjata se në çdo fushë tjetër, dhe kjo për arsye se ushtarakët vinin nga shtresat e ulëta, pa



përkrahje dhe shumë afër për t'u përdorur nga "makineria e krimin". Besoj e kujtojmë të gjithë, që mallrat kineze kishin vërshuar në treg shqipëroreshin "made in China"! Mesazhi kësaj historie: sinqerisht e konsideroj veten "made in NATO", për shkak të privilegjit që kam patur për të punuar për gati 10 vjet në Strukturat Strategjike të Planifikimit të Mbrojtjes, e cila ka qenë dhe mbetet në eksperiencën time një makineri e prodhimit të elitave të planifikimit strategjik. Me këtë rast, dua të shpreh respektin dhe mirënjohjen për themeluesit e fushës së planifikimit, Bektash Kolasin, Thimi Hudhra, Pëllumb Qazimi, etj (nuk po përmend as detyra dhe as grada, për një arsye të thjeshtë që shpresoj të jetë e kuptueshme), korrektesa, integriteti, vizioni, përgjegjshmëria, fryma e mirëkuptimit dhe profili i tyre zyrtar, më kanë shoqëruar dhe do të më shoqërojnë si model në pjesën e mbetur edhe përtej karrierës ushtarake. Për sa i takon pjesën së dytë të pyetjes tuaj, ngritjen e PUK së RSH në SHAPE, u realizua si pjesë e paketës së detyrimeve kombëtare për anëtarësimin në NATO. Nënvizoj po ashtu se mbas marrjes së ftesës së anëtarësimit (në Samitin e Bukureshtit), nga qershori 2008, kam qenë "negociator teknik" për të ngritur zyrën e Përfaqësisë Ushtarake Kombëtare (PUK) në SHAPE dhe pjesëmarrjen në NCS. Në 2 Prill 2009, u zyrtarizua ngritja e Përfaqësisë në SHAPE, ku edhe kam patur privilegjin që si PUK të RSH, së bashku me kolegun e Kroacisë të ulesha për herë të parë në forumin "NMR Echelon" të shoqëruar nga ish-SACEUR, Gjeneral John Craddock. Kjo ceremoni shënon momentin zyrtar të krijimit të PUK, SHAPE si dhe fillimin e ushtrimit të përgjegjësisë përfaqësuese dhe me të drejtën e votës, ashtu si 27 vendet e tjera anëtare të Aleancës së Atlantikut të Veriut. Për mua personalisht të punoj me stafin e SHAPE, përveçse privilegj i pa-përshtuar, ka qenë shkollë, shumë e pazëvendësueshme se të gjitha shkollat që kam bërë brenda dhe jashtë vendit. Jam thellësisht i bindur se për sa i takon kontributit dhe aritjet në ngritjen e Përfaqësisë Ushtarake Kombëtare në SHAPE, për të gjithë stafin do të mbeten arsye afatgjata për t'u ndjerë i realizuar dhe njëherësh kërenarë para vetvetes, familjes, shoqërisë dhe të parën nga rëndësia, para vendit tonë. Kam bindjen se një publik i gjerë dhe jo vetëm audiencia ushtarake është në dijeni se pas anëtarësimit, Shqipëria është kon-

sideruar "vend model në përmbushjen e detyrimeve ushtarake". Nënvizoj se ka qenë një vlerësim i merituar, për shkak të kontributeve në kuadër të NATO-s (të cilat u rritën gati tre herë në numër dhe katër herë në cilësi), dhe për shkak të përmbushjes me cilësi të masave ushtarake të integritimit. Pa dashur të hyj në detaje, janë nënshkruar 10-tra marrëveshje mirëkuptimi, marrëveshje teknike. Sjell gjithashtu në vëmendje se në fund të këtij muaji, në vendin tonë do të zhvillohet konferenca përfundimtare, nëpërmjet se cilës do finalizohet edhe procesi i integritimit ushtarak. Së pari, do të do përmendja me respekt, ish ministrin e mbrojtjes, Z. Arben Imami, si dhe shefin e Shtabit, Gjeneral Gjunkshi, për vëmendjen dhe mbështetjen zyrtare që kanë dhënë për ngritjen e PUK, por edhe dhe ndaj meje personalisht, pasi është e qartë se strukturat e përfaqësimit nuk mundet të ngrihen pa mbështetjen e autoriteteve strategjike. Dua të shpreh po ashtu mirënjohjen ndaj personaliteteve dhe ekspertëve ushtarakë të SHAPE, që në periudha të ndryshme kanë aspiruar, inspiruar dhe kontribuar në përmbushjen e detyrimeve teknike të anëtarësimit, si SACEUR Admiral Stavridis, DSACEUR Shireff, COS etj. Për ne që kemi përfaqësuar Institucionin e MM/SHP në këtë strukturë, të punoj "për ta dhe me ta" ka qenë privilegj dhe shkollë, e pazëvendësueshme. Në aspektin personal, për mua si PUK në Komandën Supreme të NATO-s në Evropë, ka qenë sfidë por edhe privilegj të komunikoj, bashkëpunoj dhe përfaqësoj një elitë profesionalistësh të përgjegjshëm, të cilët në këtë proces kanë zhvilluar cilësitë e lidershit, ekspertizën, aftësitë planifikuese dhe menaxhuese, frymën dhe bashkë me të, kulturën e komunikimit në grup. Gjithashtu, dëshiroj që të shprehja një vlerësim të sinqertë për të gjithë ushtarakët që kanë shërbyer dhe shërbejnë me dinjitet e përkushtim në operacionet aktuale të NATO dhe në strukturat e komandimit ushtarak të NATO (NCS), të cilët kanë demonstruar një performancë dinjitoze në strukturat ndërkombëtare ku punojnë. Po ashtu, dua të përcjell një mesazh mirënjohje për të gjithë ushtarakët dhe familjarët e tyre, që në këtë periudhë kanë shërbyer me sakrificë dhe profesionalizëm në operacionet jashtë vendit. Ata janë me mijëra, ndoshta më pak se 10 nuk i njoh me emër, por kam patur detyrimin dhe privilegjin për të komunikuar nëpërmjet sistemeve të SHAPE me cilës-



inë e PUK. Dua ta nënvizoj, në opinionin tim sakrifica dhe kontributi i tyre është “bërthama e krediteve të Shqipërisë në NATO”. E përsëris, pa asnjë mëdyshje, ata janë heronj, meritojnë të respektohen me dinjitet. Specifikisht, dua të përshëndes familjen e dëshmorit të parë Feti Vogli, dhe të nënvizoj se gjaku i tij është faqe e lavdishme e historisë së Shqipërisë në NATO. Kujtoj se për këtë rast, kemi zhvilluar një intervistë së bashku. Dua të ndaj një moment personal shumë të singertë: kur është lexuar emri i Kapiten Feti Vogli në forumin e përmuajshëm në SHAPE që organizohet për nder të të rënëve në operacione, bashkë me heshtjen dhe lutjet ceremoniale, kam ndarë dhimbjen e thellë dhe lotët për jetën e prerë në mes.

Gjeneral Ahmetaj, nëse mundet te na paraqisni një vlerësim të përgjithshëm mbi proceset transformuese në FA, dhe statusin e integritetit në strukturat Euro-Atlantike.

Forcat e Armatosura ndodhen në fazën përfundimtare të anëtarësimit të plotë në NATO. Por për të arritur deri këtu, padyshim që është dashur një angazhim i jashtëzakonshëm. Si në të gjitha reformat është shoqëruar me sfida jo të lehta, ne aspektin e mentalitetit apo nostalgjisë, dhimbjes sociale, të ruajtjes së kohezionit, dhe sigurisht edhe me kosto financiare. Si një ushtarak që mu dha mundësia dhe privilegji të shoh me sytë e mi pothuaj të gjitha modelet (27 vende), me lejoni t’i bëj një përmbledhje personale asaj që trashëgoi nga regjimi komunist RSH në këtë fushë. Shqipëria trashëgoi një “model eksperiment” në sistemin kombëtar të mbrojtjes, për arsytet e mëposhtme:

eksperiment dhe qesharak pasi “do luftonte kundër gjithë botës, superfuqive/bllloqeve ushtarake”;
eksperiment, pasi ky model e çoi vendin në varfëri ekstreme;

eksperiment, pasi një popull i rraskapitur harxhonte 25% të GDP-së për mbrojtjen;

eksperiment, pasi la mbrapa 300 mijë ton municione, të cilat e nënvizoj “nuk ishin pasuri por problem/barrë kritik për sigurinë kombëtare dhe më gjerë”;

eksperiment deri në dhimbje, pasi në përpjekjen për “njeriun e ri”, deformoi thellësisht integritetin e ushtarakut lider, që mbi të gjitha interesat kishte partinë

dhe udhëheqjen.

Është e njohur se përpjekjet drejt anëtarësimit në strukturën më të madhe të sigurisë globale e kanë zanafillën pas vitit 1991, me përmbysjen e regjimit, de-politizimin dhe vendosjen e kontrollit civil në Forcat e Armatosura. Në vitin 1992 Shqipëria aplikoi zyrtarisht dëshirën e saj për t’u bërë anëtare e NATO-s, për të vijuar në vitin 1994 me nënshkrimin e iniciativës së Partneritetit për Paqe (PfP). Plani i Veprimit për Anëtarësim (MAP), i vitit 1999 do të vijonte me ftesën për anëtarësim gjatë Samitit të NATO-s, mbajtur në Bukuresht, në 2008. Prilli i vitit 2009 do ta rreshtonte vendin tonë zyrtarisht si anëtare të denjë të Aleancës Euro-Atlantike. Për këtë arritje të Shqipërisë është trajtuar nga të gjithë aktorët, shoqëria civile, etj. Por përtej modestisë, por “si një ndër ekspertët e vëmendshëm”, më lejoni të them që nuk është kurrë e tepërt që të përsëris në këtë komunikim me publikun që anëtarësimi në NATO është arritja më e madhe historike, strategjike dhe gjeopolitike e RSH. E di që mes këtyre zërave ka entuziastë, oponentë dhe kritikë, por ka edhe hallëxhinj që nuk duan filozofime strategjike. Për të gjitha kategoritë, më lejoni të përcjell një mesazh profesional: NATO është jo vetëm thelbësisht strukturë politike, është jo vetëm aleanca më e fuqishme e globit në fushën e sigurisë, por në kontekstin tonë është strukturë me histori, profil, koncept, përjasje dhe profil thellësisht perëndimore, që përtej “papakshmërisë së sovranitetit”, fokusohet te vlerat dhe prosperiteti njerëzor. Sigurisht, është tejkaluar tashmë pritshmëria se anëtarësimi do na sillte zgjidhje, me fjalë më të thjeshta do na sillte para nga qielli, por në rrugën e integritetit në NATO, vendi ynë reduktoi më shumë se 10 herë personelin, reduktoi me shumë se 80 herë instalimet dhe infrastrukturat ushtarake, ka ulur më shumë se 15 herë shpenzimet e mbrojtjes, etj. Duhet të themi që gjatë gjitha kësaj rruge të gjatë dhe të mundimshme ka pasur një mbështetje të plotë politike, si dhe padyshim një mbështetje të gjerë dhe mbresëlënëse (mbi 90 %) nga opinioni publik. Sigurisht, ndërsa ambienti i sigurisë, vetë sfidat e sigurisë dhe kërkesat e qytetarëve janë në ndryshim të madh dhe të gjithanshëm. Kështu është edhe me sistemin kombëtar të

mbrojtjes, kështu edhe me FA, dhe për rrjedhojë procesi transformimit nuk ka për të ndaluar asnjëherë. Në këtë kontekst dëshiroj të ndaj disa vlerësime dhe konsiderata personale, për statusin dhe perspektivën në fushën e mbrojtjes: nevojë kritike për të finalizuar dhe formalizuar ndryshimin rrënjësor të modelit të mbrojtjes, pra përshpejtimin/reflektimin në paketën e dokumenteve strategjike të mbrojtjes (Kushtetutës së RSH, SK, SU). Ndërkohë qartësoj se, me gjithë terminologjinë e kujdesshme SSK e 2005, dhe SU e 2007 - që nga Prill të 2009, kohë kur Shqipëria u anëtarësua në NATO, modeli zyrtar i mbrojtjes të përcaktuar në dokumentet strategjike mbetet po ai i para anëtarësimit. Realiteti i ri i sigurisë, anëtarësimi në NATO kërkoi riformulimin e misionit të FA-së, nivelit të ambicies së RSH-së, transformimin e sistemit të planifikimit të mbrojtjes dhe ngritjen e një force të vogël në numër, por më cilësore në kapacitete, më e mirë-trajnuar dhe më e pajisur. Për rrjedhojë, kërkohet hartimi i një liste të qartë kapacitetesh me fokus "jo tërësinë/integritetin territorial" por interesat strategjike, burimet kritike të vendit (hapësirën ekskluzive ekonomike të detit, ajrit dhe tokës), pronat, integriteti, prosperiteti i qytetarëve dhe kontribute modeste (të balancuara) në kuadër të NATO-s të fokusuara po ashtu në interesat strategjike të RSH-së. Në optikën time profesionale, domosdoshmëri kritike është mbajtja e buxhetit të mbrojtjes në shifrat 2% të GDP-së, përmirësimi cilësor i strukturës së shpenzimeve, si dhe çlirimi i buxhetit nga zëra që e rëndojnë atë dhe që nuk janë pjesë e shpenzimeve të mbrojtjes. Po ashtu, bëhet më eminente se asnjë herë më parë, ri-ngritja e "kohezionit në FA" masë kritike që kërkon lidhshmëri të fortë, kërkon vizion, kërkon respekt dhe vlerësim për kontributet/sakrificën e ushtarakëve, kërkon që të tejkalohet konfliktualiteti, triumfalizmi, lufta brenda llojit, dhe mbi të gjitha, "rregulla loje" të qarta në të gjitha aspektet.

Vlerësimi juaj profesional mbi situatën e sigurisë në rajonin e Ballkanit, dhe në mënyrë specifike në lidhje me çështjet e Sigurisë në Kosovë. Vizioni dhe rekomandimet tuaja në këtë çështje.

Rajoni i Ballkanit Perëndimor, rajoni i Evropës Juglindore, apo me çdo definicion tjetër ku përfshihet atdheu ynë, ka kapërcyer dhe po triumfon mbi historinë e përgjakshme shekullore, historinë e konflikteve fetare, etnike dhe mbi (keq) përdorimin e nacionalizmit nga elitat politike si burimin e luftës së përgjakshme për pushtet. Me gjithë progresin dhe problematikën e trashëguara, të gjithë janë fokusuar te gara "kush do integrohet më shpejt" dhe kjo sigurisht që ka krijuar një klimë bashkëpunimi pozitiv. Me këtë nuk po them që kanë përfunduar sfidat dhe do jetojmë në të ardhmen e afërt ndonjë mrekulli, por sfidat në fushën e sigurisë janë të përbashkëta, si terrorizmi, sistemet të paqëndrueshme politike, krizat ekonomike, kërcënimet elektronike, kontrabanda, krimi i organizuar, etj. Dua të nënvizoj se nga sfidat mundet dhe duhet të eksplorojmë oportunitete pozitive, për të mbjellë "paqe të qëndrueshme", për vete, fëmijët tanë dhe brezat që do të vijnë. Për sa i takon rolin dhe vendit të Kosovës, në kuadër të mbrojtjes së mençur "Smart defence" si dhe në vlerësimet/optikën strategjike, shpreh bindjen se janë të gjitha rrethanat historike, gjeopolitike dhe ekonomike që të projektojmë,

paraqesim dhe finalizojmë një projekt të përbashkët në fushën e mbrojtjes midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës. Një projekt i tillë mund të konkretizohet pse jo edhe me Malin e Zi dhe Maqedoninë në fushën e policimit ajror, mbrojtjes kibernetike (cyber), sistemit arsimor, qendrave të stërvitjes, kapaciteteve të inteligjencës, kapaciteteve të përbashkëta për menaxhimin e krizave, etj. Kjo do ta kontribuonte më shumë se retorika ballkanike, që Kosova të ndryshonte statusin nga "konsumues", në kontribuues për sigurinë, dhe kjo është një eksperiencë që vendi ynë e ka tejkaluar. Ndërtimi i kapaciteteve më vete (nacionale), në optikën time profesionale dhe në këndvështrimin strategjik është si të merremi me yjet, pra thjesht e pamundur, është gjetje jo e zgjuar dhe duke qenë kështu, do ishte njëherësh edhe një gabim historik. Përsa i takon aspektin të së drejtës apo kufizimeve për pjesën diplomatike, (ose caviat me termat e NATO-s) qartësoj qetësisht se kjo përjasje është "në mode", është duke u aplikuar në të gjitha vendet, p.sh. vendet Baltike, vendet Nordike (Norvegji, Finlande, Suedi) si dhe Sllovenia me Hungarinë, pa përmendur vende që mendoj se e tejkalojnë etikën e konfidencialitetit.

Le të ndalemi te një element shumë i rëndësishëm për çdo njeri, që është familja. Kemi dijeni, se Ju jeni babai i një djali, student në Universitetin e Hagës, si dhe i një vajze, tashmë një pianiste në rrugën e vështirë dhe impenjative të suksesit. Sa ju mbështet familja dhe sa ju mungon ajo, si dhe cilat janë pritshmëritë tuaja ndaj fëmijëve?

Ndihem shumë i lumturuar dhe krenar njëherazi, për dy fëmijët, që padyshim janë motivi i vërtetë dhe më i bukur i jetës prindërore. Kam përjetuar historinë dhe ndjenjën më të bukur, kur djali im Arlindi, mori medalje të artë nga Presidenti SHBA-së, Barack Obama, dhe me tej për rezultate të shkëlqyera u konfirmua për dy vjet radhazi si "ambasador" i universitetit të Hagës. Po ashtu, kam përjetuar dhe përjetoj një ndjenjë lumturie të veçantë kur vajza jonë Esmeralda, ka marrë pjesë në disa koncerte të suksesshme duke përfaqësuar jo vetëm veten, por edhe atdheun tonë të dashur, Shqipërinë. Ndihem po përunjesisht i detyruar ndaj bashkëshortes sime të mrekullueshme Lindita, që më ka shoqëruar me urtësi dhe dinjitet në një rrugëtim jo të lehtë të ushtarakut. Besoj biem dakord që udhëtimi i ushtarakëve është jo i lehtë, dhe ne si ballkanas, si shqiptarë, dhe ushtarak po ashtu në raportet bashkëshortore nuk është se shkëlqejmë. Në përmbledhje duke ju falënderuar edhe njëherë për intervistën, konfirmoj se në respekt të një investimi të gjatë në strukturat strategjike, promovimin dhe veçanërisht efektin mbi familjen që ka sjellë angazhimi im në strukturat e përfaqësimit jashtë vendit, më bën përunjesisht të motivuar për të bërë më të mirën, më profesionalen, më të përgjegjshmen për të kontribuar në formëzimin e një projekti që jo vetëm konsolidon në shinat e perëndimit institucionin e mbrojtjes, por edhe në mënyrë "smart" që shikon nga e ardhmja. Më lejoni që të bëj një qartësim për sa jam shprehur në këtë intervistë: "gjithë përmbajtja, konteksti dhe mesazhet e shprehura në të, janë vlerësime personale dhe në asnjë rast dhe për asnjë rrethanë nuk përbëjnë qëndrimin zyrtar apo të strukturave ku unë kam shërbyer dhe shërbej".

UDHËHEQJA USHTARAKE

Një Doktoraturë, në Ditën e Fishtës...

NGA PANO HALLKO

Më datën 23 tetor, në sallën e madhe të leksioneve të Akademisë Ushtarake, përpara Komisionit të gradave shkencore e në prezencën e njerëzve të shumtë, ishte një disertant "jo i zakonshëm". Ai vinte përpara Komisionit me dy "atu"; -Më së pari me punën shkencore dhe aktivitetin në fushën kërkimore të shtrirë në shumë vite, dhe -së dyti, me vlerat profesionale të ushtarakut madhor që kishte kaluar në shumë faza të organizimit, drejtimit dhe udhëheqjes në Forcat tona të Armatosura. Disertanti Sandër Lleshi, gjeneral në rezervë, ish zëvendës shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA, vinte në Ditën e Fishtës jo vetëm me autoritetin e padiskutueshëm të tij, por edhe me modestinë e kërkuesit të gradës shkencore "Doktor i Shkencave". Asgjë nuk ishte rastësi. Përveç koincidence fatlume, që data e paracaktuar kushedi sa kohë më parë, përkonte me ditëlindjen e Fishtës. Siç ndodh rëndom tek ne, të paktë ishin ata në Shqipëri që përkujtuuan ditëlindjen e Fishtës-në këtë botë-Zef Ndocit-(vërtet, sa përqind e shqiptarëve e dinë emrin e saktë të Gjergj Fishtës?!?). Duke u thelluar mirë në jetën e dy personaliteteve, në ecurinë, arritjet, ngritjet dhe rëniet, pastaj në finalen e (drejt)vlerësuar, pavarësisht distancës në kohë, fushave tejet të ndryshme të veprimtarisë, dimensioneve, edhe pse të gjitha krahasimet në

këtë botë çalojnë, gjen disa "paralele" në jetët e tyre... Kjo me sa duket, sepse...Shqipëria ajo që ka qenë është, me ndonjë ndryshim të vogël, pikërisht për faktin se jemi në shekullin e XXI-të...

Temë aktuale, se i takon e ardhmja

Si shumë gjëra të tjera që nuk ishin rastësi (përjashtoj rastësinë e bukur domethënëse të datës), edhe tema e zgjedhur nga Doktori i Shkencave nuk ishte një zgjedhje e rastësishme. Përkundrazi, ishte nga gjetjet e rralla që aplikohen në këtë periudhë të ngjeshur me Mbrojtje Doktoraturash: "Udhëheqja Ushtarake në epokën e globalizmit". Çfarë është globalizimi dhe cilat janë ndikimet e tij në zhvillimet kryesore botërore në fushën e politikës, ekonomisë, teknologjisë dhe forcave të armatosura? Cilat janë sfidat e reja me të cilat përballen forcat e armatosura në kushtet e epokës së re të globalizmit? Cilat janë shkollat dhe teoritë që përbëjnë bazën e organizimit dhe të menaxhimit. Cila është përvoja e FA në fushën e zhvillimit të mendimit ushtarak, të udhëheqjes dhe të organizimit ushtarak? A është koncepti i drejtimit përmes misionit një përgjigje moderne ndaj sfidave që qëndrojnë para Forcave të Armatosura të Shqipërisë? Këto ishin ndër pyetjet kryesore që kishin problematizuar gjeneralin gjatë hartimit dhe zhvillimit të temës. Pas një pune disavjeçare, e nën drejtimin e Prof. Dr Pëllumb Danaj, gjeneral Lleshi arriti të paraqitë një punim dinjitoz, shumë-planesh në të gjithë kapitujt e tij. Au-





tori kishte studiuar dhe përpunuar një volum shumë të rëndësishëm të literaturës bashkëkohore, e cila trajton problemet e globalizimit dhe të ndikimit të tij në botën e sotme. Në muajin shkurt 2011 autori mbajti një leksion me temën: “Shqipëria - Porta për Lindjen dhe Perëndimin”, në Institutin e Studimeve të Larta të Mbrojtjes në Itali (Istituto Alti Studi Della Difesa (IASD) përpara Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, i cili frekuentohet nga oficerë me grada të larta e madhore (kolonel-gjeneral) nga Italia dhe vende të tjera të NATO-s. Në periudhën qershor-korrik 2011, ai ndoqi edhe Kursin e Lartë Ndërkombëtar për Menaxhimin e Burimeve të Mbrojtjes në Shkollën Pasuniversitare të Marinës në Monterey, Kalifornia të SHBA. Në këtë kurs, kuptohet që atij iu krijuan mundësi të shumta për të siguruar literaturë të bollshme, por edhe mundësi për t’u konsultuar me personalitete të shquara akademike të fushës së menaxhimit dhe të organizimit. Qëndrimi i tij në SHBA pranë një institucioni prestigjioz botëror, doemos ishte një mundësi e artë për thellimin e punës në interes të studimeve për doktoraturën. Në material dalin përfundime të rëndësishme, të cilat mund të gjejnë hapësira zbatimi në fushën e organizimit të FA të Shqipërisë. Mbi bazën e kontekstit teorik të përpunuar, janë analizuar me shumë hollësi parimet strategjike, parimet e drejtimit, skemat e organizimit dhe reformat e FA.

Organizimi-Shkencë, Udhëheqja-Art

“Shumë gjëra kanë ndryshuar, e s’ mund të jenë siç kanë qenë në këtë botë-nënvizoi gjenerali. “Thënë në mënyrë figurative, është “shkërmoqur” zamka e kufijve. Shtetet thuhet janë bërë virtuale, e për këtë arsye ato e kanë zvogëluar kapacitetin prodhues të bazuar në territorin e tyre. Kjo ka sjellë si pasojë rritjen e rolit të individit. Sepse individit sot komunikon dhe vepron jashtë influencës së shtetit. Lufta e Brezit të katërt, i takon rebelimeve të grupeve të vogla. Ne jemi mësuar që udhëheqjen ushtarake ta quajmë Art. Do të thosha që është art dhe përtej artit, shumë mbi artin, më mirë të themi shkencë. Aq më tepër sot, në epokën e revolucionit të informacionit. Revolucionin e informacionit është mirë që ta kuptojmë si revolucion të Konceptit. Në këto kushte, meriton të marrë përparësi Drejtimi përmes Misionit. Do të ishte më e drejtë që tjetrit t’i tregojmë çfarë duhet të bëjë dhe përse duhet ta bëjë, sesa t’i tregojmë se si duhet

ta bëjë. -Për këtë, na ka ardhur në ndihmë Emanuel Kanti, kur thoshte:-“Kij guxim ta përdorësh mendjen tënde”- theksoi doktoranti. Nëse i besojmë thënies Klauzeviçiane se lufta është Akt i marrëdhënieve njerëzore, atëherë duhet pranojmë se ajo (pra lufta), zhvillohet në prehrin e politikës. Një Kapitull i veçantë në punim, është: -“Udhëheqja Ushtarake Shqiptare në vitet 1966-2011. Me kompetencë profesionale dhe shkencore, kjo etapë e udhëheqjes ushtarake kalon “në sitë”, duke nisur qysh me heqjen e gradave, e deri në strukturimin e Forcave të Armatosura si një Forcë Profesionale. Fokusi i punës për realizimin e kësaj nën-çështjeje, ka qenë kërkimi dhe studimi i burimeve arkivore në Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura. Kështu janë studiuar një numër shumë i madh dokumentesh arkivore, janë analizuar shumë çështje të strategjisë ushtarake, të lidhshimit dhe të organizimit në Forcat tona të Armatosura. Gjatë kësaj periudhe janë studiuar dhe analizuar çështje që kanë të bëjnë parimin e udhëheqjes nëpërmjet misionit. Duke e konsideruar këtë koncept si një nevojë të domosdoshme për të ardhmen e FA, gjatë është studiuar në detaje historia e lindjes dhe e zhvillimit të këtij koncepti të drejtimit. Kryesisht studimi është fokusuar në analizën e eksperiencave të Gjermanisë (që mbahet si vendi i origjinës së këtij koncepti) dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (që e kanë futur prej kohësh në praktikën e tyre ushtarake këtë koncept). Po kështu është trajtuar edhe roli e përvoja e Britanisë së Madhe dhe Rusisë në këtë fushë. Analiza e thelluar e konceptit të drejtimit nëpërmjet misionit ka sjellë edhe në një seri të konsiderueshme përfundimesh dhe rekomandimesh, të cilat kanë vlerë të mirëfilltë aplikimi për të ardhmen e FA të RSH. Në përfundim të një procesi intensiv studimesh dhe kërkimesh, në një fushë me shumë interes dhe të pa trajtuar më parë nga studimet ushtarake shqiptare, janë nxjerrë edhe shumë përfundime më rëndësi, të cilat mund dhe duhet të merren në konsideratë nga Forcat e Armatosura të RSH. Kur lexuesi të njihet me materialin e botuar, do të vërejë se shumë prej përfundimeve të nxjerra nga ky studim dhe analiza e çështjes, në disa drejtime kanë një fushë përdorimi edhe përtej “kuadrantit” të Forcave të Armatosura. Në fund, Doktorin e shkencave shprehu falënderimet e tij për ndihmën e të gjithë stafit mësimor dhe shkencor të Akademisë së Mbrojtjes, ndihmë e cila ishte shumë e rëndësishme për realizimin e punimit.



Dinamika e NATO-s, rajoni dhe transformimet në ardhje

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, në sesionin vjetor të 2013-s, të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, në Dubrovnik, Kroaci, në fjalën e tij, ndër të tjetër do të thoshte: "Mesazhi im është i qartë: Nëse duam të vazhdojmë të korrim përfitimet e mbrojtjes, nuk ka alternativë. Duhet të vazhdojmë të investojmë në mbrojtje. Duhet të vazhdojmë të investojmë në NATO politikisht, ushtarakisht dhe financiarisht dhe duhet të gjejmë mënyrën për të ndarë në mënyrë të barabartë barrën e mbrojtjes transatlantike." Në pamje të parë duket si diçka e thjeshtë: investo dhe shto sigurinë. Koha po tregon se nuk është edhe kaq e thjeshtë. Tashmë vendet e Aleancës përballen me probleme financiare, shkurtime buxhetesh etj dhe të flasësh për investim ngjan se nuk është një moment i përshtat-

shëm. Nga ana tjetër, sfidat në mjedisin e sigurisë rriten e ndryshojnë. Krahas atyre tradicionale është shtuar edhe aspekti ekonomik, i cili është një sfidë në vetvete përse i përket të qenit të sigurt. Rajoni ynë është pjesë e këtyre zhvillimeve dhe Shqipërisë si dhe shumë vende të tjera, pjesëtare apo jo në NATO, përballen me këto sfida kaq delikate, si në mënyrë individuale edhe në mënyrë kolektive. Përmbledhja e shkrimeve që vijnë në vijim, synon të japë një kornizë të aktiviteteve të fundit të zhvilluara nga NATO. Kjo panoramë jep njëfarë informacioni në lidhje me ato zhvillime me të cilat duhet të përballen edhe vendi e rajoni ynë. Dy artikujt e fundit japin skicën e të ardhmes për NATO-n dhe hedhin edhe idetë e një transformimi të mundshëm gjeoekonomik ku aktorë kryesorë do të jenë ata të hapësirës euro-atlantike.

A.H



Rasmussen:
Mbrotjtja vlen...



Bashkëpunimi i Mbrojtjes
Rajonale për Europën Juglindore



Vështrim i përgjithshëm mbi
çështjet e Samitit "NATO 2014"

Më 22-23 tetor u zhvillua Ministeriali i Mbrojtjes në selinë e NATO-s në Bruksel. Përmirësimi i aftësive, progresi në Afganistan dhe bashkëpunimi NATO-Rusi ishin në krye të axhendës së Ministerialit dy-ditor të Mbrojtjes së kësaj jave, i cili filloi ditën e martë më 22 tetor. Sesiioni i parë i punës së këtij ministeriali u fokusua tek aftësitë dhe tek përpjekjet për t'i përmirësuar ato. Ministrat e Mbrojtjes diskutuan gjithashtu mbrojtjen kibernetike, sistemin e mbrojtjes raketore balistike të NATO-s dhe rishikimin e reformave të saj. Gjithashtu, ministrat vlerësuan progresin e bërë në mbi 20 projekte të Mbrojtjes së Zgjuar të propozuar në samitin e Çikagos vitin e kaluar. Një sesion i dytë pune konsideroi hapin e ardhshëm në Iniciativën e Forcave të Ndërlidhura të Aleancës me fokus në trajnimin, edukimin dhe programet e stërvitjes pas përfundimit të misionit të ISAF-it në Afganistan në vitin 2014. Në ministerial, u zhvillua dhe një takim midis ministrave të Mbrojtjes së NATO-s dhe vendeve partnere që kontribuojnë në misionin e ISAF-it dhe homologun e tyre afgan, Bismullah Mohammadi Khan, për të diskutuar progresin në Afganistan. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, i cili kryesoi këto takime tha se përmirësimi i trajnimit, edukimit

dhe stërvitjeve së forcave të NATO-s përmes Iniciativës së Forcave të Ndërlidhura do të sigurojë se Aleanca "është e gatshme dhe në gjendje të adresojë sfidat e shekullit XXI". Në ministerial, u diskutua rreth mbrojtjes kibernetike -"përpjekjet tona të vazhdueshme për të mbrojtur rrjetet tona dhe mënyrën se si Aleanca duhet të adresojë këtë kërcënim në rritje përmes një mbrojtjeje kibernetike të zgjeruar", tha Rasmussen para mediave para hapjes së këtij ministeriali. Ministrat e Mbrojtjes ranë dakord për të siguruar që eksperiencia e 20 viteve të operacioneve në Afganistan, Ballkan dhe gjetkë është ruajtur nëpërmjet më shumë trajnimesh dhe stërvitjesh. Ata ranë dakord mbi elementët kyçe të Iniciativës së Forcave të Ndërlidhura dhe se ekspertët do të punojnë tani rreth kësaj si një çështje me prioritet. "Një qasje edhe më rigoroze e sistematike për trajnimet dhe stërvitjet tona është

çelësi në arritjen e qëllimit tonë së Forcave të NATO-s 2020: Moderne, të lidhura fort, të pajisura, të trajnuara, të komanduara, kështu që mund të punojnë së bashku dhe me partnerët, në çdo mjedis", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Rasmussen. Rasmussen njoftoi se Aleanca do të kryejë një stërvitje direkte në vitin 2015, e cila do të përfshijë një numër të konsiderueshëm forcash të dislokuara në tokë, ajër dhe det. Spanja, Portugalia dhe Italia u ofruan të organizojnë stërvitjen. "Nga viti 2016 e më tej, ne do të kryejmë stërvitje të tilla direkte në një bazë të rregullt, me një spektër më të gjerë e duke mbuluar një gamë të plotë misionesh të Aleancës. Ne ramë dakord në hartimin e një koncepti më të gjerë për trajnimin e ushtrimit deri në vitin 2020, për t'u siguruar që gjithçka bëjmë është koherente dhe e ndërlidhur, brenda Aleancës dhe me vendet partnere", tha Rasmussen. Në lidhje me mbrojtjen kibernetike, ministrat ranë dakord se Aleanca është në rrugën e duhur në përmirësimin e aftësisë



së saj për të mbrojtur rrjetet e NATO-s. "Mbrotjtja kibernetike është një përgjegjësi kombëtare, por të gjithë jemi dakord se NATO mund e duhet të luajë një rol të dobishëm për të lehtësuar zhvillimin e aftësive të mbrojtjes kibernetike kombëtare", tha Sekretari i Përgjithshëm. Ministrat diskutuan mbrojtjen raketore dhe programin e NATO-s për të mbrojtur popullsinë, territorin dhe forcat e Aleancës kundër sulmeve raketore që vijnë jashtë zonës euroatlantike. "Si një hap tjetër në sistemin e SHBA-së për mbrojtjen nga raketat në Europë, një novator për sistemin Aegis të bazuar në tokë, do të zhvillohet në Rumani deri në fund të muajit tetor. Kjo është një punë komplekse dhe ne po bëjmë mjaft progres", vuri në dukje Rasmussen. Ai përfundoi se çështjet e trajtuara nga ministrat e Mbrojtjes janë jetike që misioni i NATO-s të ofrojë siguri për të ardhmen.

Alba Musaraj

Rasmussen: Mbrojtja vlen...

Fjala e Anders Fogh Rasmussen në sesionin vjetor 2013 të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, në Dubrovnik, Kroaci

Mesazhi im është i qartë: Nëse duam të vazhdojmë të korrим përfitimet e mbrojtjes, nuk ka alternativë. Duhet të vazhdojmë të investojmë në mbrojtje. Duhet të vazhdojmë të investojmë në NATO politikisht, ushtarakisht dhe financiarisht dhe duhet të gjejmë mënyrën për të ndarë në mënyrë të barabartë barrën e mbrojtjes transatlantike

“Më lejoni të filloj duke falënderuar qeverinë kroate, parlamentin si dhe presidentin e Asamblesë Parlamentare të NATO-s që më ftoi të jem sot me ju. Si një ish-parlamentar mezi pres të vij në këto takime dhe kjo mbledhje më jep mundësinë të përgëzoj Kroacinë për anëtarësimin në Bashkimin Europian këtë verë. Ky është një hap i rëndësishëm në integrimin e qëndrueshëm të Europës Juglindore brenda zonës euroatlantike. Marrëveshja Beograd-Prishtinë për normalizim përfaqëson një tjetër hap të rëndësishëm. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje duhet të vazhdojë dhe NATO e KFOR-i luajnë një rol kyç në këtë zbatim. Krahas Bashkimit Europian, NATO do të luajë rolin e saj për të siguruar një të ardhme më të mirë, për të gjithë vendet e Europës Juglindore. Ne do të vazhdojmë të sigurojmë paqe e siguri, të angazhojmë të gjithë vendet e interesuar në partneritet dhe bashkëpunim dhe të mbajmë dyert e hapura për anëtarët e rinj. Gjatë dekadës së fundit, Kroacia ka ecur tashmë përmes dyerve të hapura të NATO-s e kështu kanë bërë dhe Shqipëria e Sllovenia. Bosnje dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë të gjithë e dinë se dera e NATO-s është e hapur për ta, nëse ata demonstronjë vendosmëri të re për të zgjidhur mosmarrëveshjet e vjetra. Një rekord i gjurmëve të reformave dhe përgjegjësisë dhe angazhimi politik për ndërtimin e sigurisë dhe stabilitetit së bashku me fqinjët e tyre dhe me popujt e tjerë. Duke pasur parasysh historinë e tyre së kohëve të fundit, njerëzit e këtij rajoni kuptojnë vlerën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ata e kuptojnë pse mbrojtja ka rëndësi. Mjedisi i sigurisë



ndërkombëtare ka ndryshuar në mënyrë dramatike. Shumica e veprimeve dhe operacioneve tona kryhen larg shtëpisë. Shumë pak prej kombeve tona akoma kanë rekrutim dhe kjo ka çuar në një hendek të caktuar midis publikut dhe institucioneve të mbrojtjes, të tilla si ushtria. Në të njëjtën kohë, kriza financiare ka vendosur presione të mëdha mbi ekonominë tona. Kjo ka çuar në shkurtime të mbrojtjes në shumë prej vendeve tona dhe ka ngritur pyetje në lidhje me nevojën për mbrojtje. Gjatë gjashtë muajve të fundit, NATO ka punuar me institucionet kërkimore të shquara nga tetë vendet anëtare të Aleancës për t'u marrë me këtë çështje. Këto institute e kanë diskutuar mbrojtjen me përfaqësues të shoqërisë civile. Ata gjithashtu nxjerrin rezultate nga sondazhet e opinionit publik dhe disa kryejnë intervista me politikbërës dhe parlamentarë. Qëllimi ishte për të pasur një tablo të gjerë sesi publiku ynë e shikon mbrojtjen dhe vlera që ata kanë vendosur mbi të. Pyetja e madhe është: Sa rëndësi ka me të vërtetë mbrojtja jonë? Rezultatet dhe përgjigja tashmë janë të qarta. Me pak fjalë,



mbrojtja ka akoma rëndësi, por të gjithë ne duhet të bëjmë një punë shumë të mirë. Nga hulumtimet dalin katër rezultate: Së pari, ka një përhapje të gjerë respekti për forcat tona ushtarake dhe mbështetje të gjerë për investimet e mbrojtjes. Niveli i mbështetjes varion nga vendi në vend. Disa njerëz mendojnë se duhet të shkurtohen edhe më tej, por akoma më shumë besojnë se duhet të mbajmë nivelin tonë aktual të shpenzimeve, ose ta rrisim atë. Të njëjtat rezultate dolën edhe nga sondazhi i sivjetshëm i tendencës transatlantike. Së dyti, publiku e kupton se liria dhe prosperiteti i një vendi varen nga siguria e tij, por ata se kuptojnë se sa shumë ne investojmë, si përdoret investimi ynë dhe çfarë roli kanë aktualisht forcat tona ushtarake. Rezultati i tretë nga ky hulumtim është se industritë e mbrojtjes shihen përgjithësisht si kontribute pozitive në ekonomitë tona, por këto pikëpamje janë të ngjyrosura nga perceptime të kota shpenzimesh, mungesë transparence dhe jo-efikasitet në prokurim. Së katërti, sondazhi ynë tregoi një ndarje në rritje ndërmjet Amerikës së Veriut dhe Europës në lidhje me perceptimet e NATO-s. Në përgjithësi, europianët kanë tendencën të vlerësojnë anëtarësimin e vendit të tyre në Aleancë. Në veçanti, duke qenë një aleat shihet si përmirësim transparence dhe efektivitet të forcave kombëtare të mbrojtjes së një vendi. Amerikano-veriorët mendojnë gjithnjë e më shumë se NATO nuk ofron shumë për sigurinë e tyre dhe se europianët duhet të marrin më shumë përgjegjësinë e barrës së sigurisë transatlantike. Pra, në dritën e këtyre zbulimeve, si mund të kemi një rast më të mirë për mbrojtjen tonë në përgjithësi dhe për NATO-n në veçanti në të dy anët e Atlantikut?

Lidhur me këtë, unë shoh tre prioritete: Së pari, ne duhet të nxjerrim në pah qëllimin themelor të mbrojtjes sonë: Mbrojtjen e popujve dhe parimeve tona, lirinë, demokracinë, të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit. Gjithkush në Aleancë ndan këto vlera themelore. Ato janë jetike për paqen e prosperitetin tonë të vazhdueshëm, por ato nuk janë të gatshme. Ne duhet të ngrihem të gjithë për këto vlera dhe nëse është e

nevojshme duhet të jemi të përgatitur për të luftuar e për t'i mbrojtur ato. Ishte vendosmëria jonë për t'i mbrojtur ato vlera që në fund të fundit i dhanë fund Luftës së Ftohtë. Ish-kundërshtarët u bënë aleatë. Europa tashmë është në paqe dhe njerëzit ndjehen të sigurt dhe lufta midis vendeve europiane është thjesht e paimagjinueshme. Dy dekada më parë, ne ndërhyëm për të mbrojtur vlerat tona në Europën Juglindore dhe dy vjet më parë, ne vepruam për të mbrojtur civilët në Libi dhe zbatuam rezolutën historike të Kombeve të Bashkuara. Çdo herë të vetme, ne mbrojtëm vlerat tona. Çdo herë të vetme, ne vepruam për të mbrojtur një mnëyrë jete të ndërtuar mbi këto vlera dhe çdo herë të vetme, vlerat tona fituan. Mbrojtja e vlerave tona është arsyeja më e rëndësishme pse mbrojtja ka rëndësi. Së dyti, ne duhet të zhvendosim argumentin tonë nga kostoja e mbrojtjes në koston e jo-mbrojtjes. Ta zhvendosim argumentin nga ajo që vendosëm në atë që morëm. Nuk është e lehtë për publikun të shohë se çfarë humbim nëse nuk investojmë në mbrojtje. Pra, duhet të bëjmë më shumë për të përcaktuar sasinë e kësaj dhe ka të dhëna në dispozicion që na ndihmojnë ta bëjmë argumentin. Për shembull, sulmet terroriste të 11-shtatorit çuan në një humbje prej rreth 1.7 trilionë dollarësh amerikanë në kapitalizmin e tregut të aksioneve. Shërbimi i Kërkimit të Kongresit Amerikan ka llogaritur se ato çuan gjithashtu në humbje të të ardhurave dhe prodhimin e gati 300 bilionë dollarëve amerikanë dhe një rritje në shpenzimet e biznesit mbi sigurinë prej 234 bilionë dollarësh amerikanë. Më parë gjatë këtij viti, Banka Botërore vlerësoi që impakti globa vjetor i piraterisë somaleze është një vënie në skenë e 18 bilionëve dollarësh amerikanë. Qendra Amerikane e Analizave Detare ka vlerësuar se nëse ngushtica e Hormuzit do të mbyllej plotësisht, çmimet e naftës mund të trefishohen. Europoli, Agjencia e Zbatimit të Ligjit së Bashkimit European





e vë vlerën e humbjeve vjetore të korporatave nga veprimtaria kriminale kibernetike në një trilion dollarë amerikanë. Megjithatë, kjo kosto financiare nuk është asgjë në krahasim me koston njerëzore. Këto janë vetëm disa shembuj të koston së sulmeve, të koston së pasigurisë dhe koston së jo-mbrojtjes. E di që është e vështirë të llogaritet një kosto totale, por këto shembuj ilustronë se ndërsa ka një kosto që duhet paguar për mbrojtjen, kosto e jo-mbrojtjes do të ishte shumë më e lartë. Në botën e sotme të paparashikueshme, mbrojtja është një politikë sigurie e domosdoshme. Ne duhet të shpenzojmë para për të ruajtur para dhe për të shpëtuar jetë. Investimi në mbrojtje është gjithashtu një investim në një nga industritë më inovative, më të afta dhe më produktive. Për shembull, në vitin 2012, industria e mbrojtjes europiane kishte një qarkullim prej 96 miliardë eurosh dhe kjo punësoi afërsisht 1 milionë e gjysëm njerëz direkt dhe indirekt. Ekspertiza e industrive të mbrojtjes sonë është ndërtaur mbi brezat dhe ka çuar në shumë produkte që kanë transformuar jetën tonë të përditshme për mirë, si pers shembull motori reaktiv, navigacioni satelitor dhe interneti. Si çdo industri tjetër e teknologjisë së lartë, sektori po evoluon vazhdimisht. Nëse ne i shkurtojmë shpenzimet e mbrojtjes shumë e për një kohë të gjatë, ne do e sakrifikojmë atë ekspertizë dhe do të jetë e pamundur ta zëvendësojmë atë me nxitim kur të kemi nevojë. Pika ime është: Ne kemi nevojë për mbrojtje për të mbrojtur popullatën, principet, vlerat dhe shoqëritë tona e pasi të kemi një sektor mbrojtjeje, duhet të kuptojmë se nuk është vetëm një kosto. Ka gjithashtu përfitime të rëndësishme, duke përfshirë inovacionin dhe progresin teknologjik. Prioriteti i tretë është të theksojmë rëndësinë e gjerë të mbrojtjes, si një mjet për ndikimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Për të gjithë kombet tanë, diplomacia ka qenë dhe do të mbetet mjete kryesor për ballafaqimin me sfidat e sigurisë ndërkombëtare. Duke investuar në mbrojtje, ne jemi në gjendje që fjalët t'i mbështesim ushtarakisht e në këtë mënyrë të bëhemi më të besueshëm. Personalisht, mendoj se zhvillimet e fundit në krizën siriane na dhanë një mësim të rëndësishëm në këtë drejtim. Pa kërcënimin e besueshëm të forcës

ushtarake, Siria nuk do të binte dakord për të shkatërruar arsenalin e saj të armëve kimike. Këto janë tre arsye pse mbrojtja ka rëndësi për vendet individuale dhe janë tre nga arsye pse NATO ka rëndësi gjithashtu. NATO është një forcë unike dhe i ndihmon aleatët të bëjnë një kthim edhe më të mirë në investimet e tyre të mbrojtjes. Si pjesë e ekipit të NATO-s, 28 aleatët marrin më shumë siguri se sa mund të arrinin ndonjëherë vetëm. Ata kanë miq të cilët i ndihmojnë në kohë nevojë dhe kanë qasje në më shumë aftësi ushtarake, ata marrin një rrjet partneritetesh sigurie me vendet përreth globit si dhe luajnë një rol më të madh ndërkombëtar. Qoftë në Kosovë, Libi apo Afganistan, forca ushtarake të udhëhequra nga NATO na kanë ndihmuar t'i japim fund dhunës dhe gjakderdhjes. Asnjë komb nuk do ta kishte bërë dot këtë i vetëm. Puna së bashku në NATO ofron besueshmëri politike. Së fundmi, puna së bashku në NATO na ka ndihmuar të forcojmë një institucion tjetër: Kombet e Bashkuara. Duke vepruar nën një mandat së Kombeve të Bashkuara, kemi siguruar më shumë forcë ushtarake efektive dhe të kontrolluar që Kombet e Bashkuara përndryshe nuk do të kishin qenë në gjendje të ofronin. Muajin e kaluar, gjatë Asamblesë së Përgjithshme së Kombeve të Bashkuara, u takova me Sekretarin e Përgjithshëm, Ban Ki-moon dhe një nga çështjet që diskutuam ishte se si NATO mund të bëjë më shumë për të mbështetur Kombet e Bashkuara, veçanërisht në operacionet humanitare. Mesazhi im është i qartë: Nëse duam të vazhdojmë të korrim përfitimet e mbrojtjes, nuk ka alternativë. Duhet të vazhdojmë të investojmë në mbrojtje. Duhet të vazhdojmë të investojmë në NATO politikisht, ushtarakisht dhe financiarisht dhe duhet të gjejmë mënyrën për të ndarë në mënyrë të barabartë barrën e mbrojtjes transatlantike. Samiti i Këshillit Europian në fund të vitit, dedikuar sigurisë dhe mbrojtjes dhe samiti i NATO-s i vitit të ardhshëm do të jenë mundësi ideale për të ndërmarrë veprime konkrete dhe për të ri-balancuar këtë barrë. Mbrojtja vlen. Unë e di këtë, ju e dini këtë. Puna juaj është që dhe publiku ta njohë këtë. Siguria dhe liria janë të çmuara, por asgjë nuk është falas. Ne duhet të jemi në gjendje dhe të gatshëm për t'i mbrojtur të dyja. Kjo është arsyeja pse mbrojtja vlen”.

Bashkëpunimi i Mbrojtjes Rajonale për Europën Juglindore

Fjalimi kryesor i mbajtur nga zëvendëssekretari i Përgjithshëm i NATO-s, ambasadori Aleksandër Vershbou, në Ministerialin Gjithëpërfshirës Rajonal, Brdo, Slloveni

Përgatiti Alba Musaraj

Ministra, ambasadorë, kolegë, zonja dhe zotërinj, falënderoj ministrin Pejanoviç Djurisiç për kryesimin e takimit të sotëm dhe ministrin Jakiç për mikpritjen e këtij takimi gjithëpërfshirës të ministrave të Mbrojtjes. Është kënaqësi e veçantë të flas me ju sot. Ky ministerial tregon solidaritetin e vazhdueshëm, si të vendeve të Kartës së Adriatikut ashtu edhe më gjerë në rajonin e Evropës Juglindore. Kjo konfirmon se armiq të mëparshëm sot mund mblidhen së bashku, për të diskutuar mbi mënyrat se si të rrisim sigurinë tonë. Dhe kjo nxjerr në pah rëndësinë që i japin vendet e këtij rajoni përmirësimit të kapaciteteve tona të mbrojtjes në një epokë ku buxhetet e mbrojtjes janë në rënie dhe sfidat globale në rritje. Këto sfida të sigurisë globale janë sfida të vështira. Ato përfshijnë efektet e jashtme, që vijnë nga shtetet e dështuara, përhapjen e raketave, piraterinë dhe luftën kibernetike. Dhe ndonjëherë ne përballemi me këto sfida në kufijtë tanë, siç e tregojnë edhe ngjarjet në Siri. Asnjë vend nuk është imun ndaj këtyre sfidave dhe as edhe një vend nuk mund të përballet me to i vetëm. Ato kërkojnë bashkëpunimin më të gjerë të mundshme mes vendeve dhe organizatave. Për fat të mirë, edhe pse sfidat janë të forta, forca jonë kolektive është edhe më e fortë. Ne mund të bëjmë që kjo forcë e përbashkët të dalë mbizotëruese duke bërë bashkë burimet (resurset) që kemi për të arritur aftësitë e duhura; pra duke bashkëpunuar nëpërmjet standardeve të përbashkëta; dhe duke u specializuar në atë që vendet tona bëjnë më mirë. Unë besoj se organizatat rajonale të tilla si Karta e Adriatikut dhe Ministeriali i Mbrojtjes së Evropës Juglindore janë blloqe në themelet e ndërtimit të sigurisë sonë të përbashkët. Ndonjëherë, ne harrojmë sa përpara ka ecur ky rajon që nga fillimi i viteve 1990. Vetëm dy dekada më parë, ne shikonim ndarje dhe konflikte. Sot, ne shohim një dinamizëm ekonomik, partneritet politik dhe

integrim europian e euroatlantik. Gjatë disa viteve të fundit, dy vende të Kartës së Adriatikut u bënë anëtarë të NATO-s; Shqipëria dhe Kroacia. Vetëm verën e shkuar, Kroacia u bë anëtare e Bashkimit Europian. Vendet e tjera janë duke ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt integritet euro-atlantik, qoftë si anëtarë të plotë apo si partnerë të vlefshëm. Por, ato gjithashtu e dinë se kanë ende rrugë për të bërë, para se të arrijnë në destinacionin e tyre. Në këtë drejtim, marrëveshja e fundit Beograd-Prishtinë është një hap i madh përpara për të gjithë rajonin. Ajo tregon se kur dy palët veprojnë për të zgjidhur mosmarrëveshjet e vjetra, nga kjo përfitojnë të gjitha vendet e rajonit. Beogradi dhe Prishtina meritojnë nderim (besim) të madh për gatishmërinë e tyre për kompromis. Bashkimi Europian, dhe në veçanti Përfaqësuesja e Lartë Catherine Ashton, luajtën një rol të rëndësishëm në arritjen e marrëveshjes përfundimtare. Gjithashtu edhe NATO është e angazhuar për të ndihmuar në garantimin e zbatimit të saj. Karta e Adriatikut ka siguruar një kuadër të rëndësishëm për sukseset e fundit në këtë rajon. Ajo ka kontribuar për integrimin euroatlantik të disa vendeve të rajonit. Dhe duke bërë këtë, ajo ka përmirësuar stabilitetin rajonal, ka ndihmuar në ndërtimin e besimit dhe mirëkuptimit dhe na ka afruar më shumë me një Europë që është bashkë, e lirë dhe në paqe. Aleatët e NATO-s – ashtu si edhe partnerët e saj në këtë rajon – ndajnë vlera të përbashkëta, të tilla si dëshirën për liri, demokraci dhe sundimin e ligjit. Këto vlera duhet të promovohen, të ruhen dhe të mbrohen. Grupime të tilla rajonale, si Karta e Adriatikut, Katërshja e Visegradit, Ministeriali i Mbrojtjes së Evropës Juglindore dhe Bashkëpunimi i Mbrojtjes Nordike, duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në lidhje me këtë. Ato mund të ndihmojnë aleatë dhe partnerë të caktuar të





punojnë së bashku dhe të përqendrohen në zhvillimin e aftësive (kapaciteteve) kyçe . Ato mund t'i bashkojnë këto kapacitete nëpërmjet shkëmbimit të përvojave në trajnime dhe stërvitje të përbashkëta dhe nëpërmjet zhvillimit të procedurave të përbashkëta. Dhe ato mund ta ndihmojnë Europën të arrijë një spektër të plotë të aftësive ushtarake. Kjo si këmbim do të siguronte një zë të fuqishëm europian në sigurinë dhe mbrojtjen , si rajonale ashtu edhe globale, dhe do të sillte balancë përforcuese ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve europianë në kuadër të Aleancës sonë, duke forcuar lidhjen transatlantike që është guri ynë i themelit. Përqendrimi i vendeve në arritjen e aftësive kryesore, lidhja mes rajonit dhe bashkëpunimi europian - kjo është mënyrë për të arritur një të ardhme europiane të sigurt, ku kombet europiane, së bashku, të kenë forcën e nevojshme për t'u përballur me sfidat globale që dominojnë agjendën e sigurisë. Ne kemi bërë tashmë progres drejt arritjes së një të ardhme të tillë. Në samitin tonë të fundit të NATO-s, në Çikago, në vitin 2012, aleatët u morën angazhim për arritjen e objektivit të Forcave të NATO-s 2020. Këto forca duhet të jenë moderne, forca të bashkuara që janë të pajisura , të trajnuara , të stërvitura dhe të komanduara në mënyrë që ata mund të veprojnë së bashku dhe me partnerët në çdo mjedis dhe kundër çdo kërcënimi. Ky është objektivi i synuar. Për ta plotësuar atë , NATO ka aplikuar Smart Defence dhe nismën e Forcave të Bashkuara. Të dyja kanë në thelbin e tyre bashkëpunimin shumëkombësh. Në fokus të Mbrojtjes së Zgjuar është zhvillimi dhe përvetësimi i aftësive (kapaciteteve). Ndërsa në fokus të Forcave të Bashkuara janë trajnimet dhe stërvitjet shumëkombëshe - veçanërisht dhe sidomos mes aleatëve, por gjithashtu edhe me ushtritë partnere. Të dyja këto iniciativa synojnë të prezantojnë "Forcat e NATO-s 2020", gjatë një periud-

he kursimi. Dhe të dyja këto kërkojnë të garantojnë se NATO mbetet e fortë dhe e besueshëm. Vendet në Europën Juglindore kanë potencial të madh për të kontribuar si për Forcat e NATO-s 2020 ashtu edhe për operacionet e NATO-s në përgjithësi. Ne e kemi parë këtë potencial në praktikë. Për shembull, anëtarët e Kartës së Adriatikut dhe Sllovenia kontribuuan për një kontingjent me instruktorë për Shkollën e Policisë Ushtarake të Ushtrisë Kombëtare Afgane në Kabul. Aleatët dhe partnerët e tjerë e vlerësuan mjaft këtë kontribut dhe mendoj se ne mund të bëjmë edhe më shumë. NATO tashmë është duke punuar për të sjellë së bashku aleatë dhe partnerë në grupime operative të bazuara në aftësitë e tyre aktuale dhe në fuqinë e dëshmuar. Kjo përfshin idenë e angazhimit të grupeve të aleatëve pranë një aleati të madh që zotëron një spektër të gjerë kapacitetesh dhe aftësish. Ky aleat më i madh – si një vend organizator- do të lehtësojë dhe bashkërendojë punën e grupit, si në aspektin e zhvillimit të aftësive dhe në atë të pozicioneve në operacione. Për ta arritur këtë, aleatët dhe ndoshta edhe disa nga partnerët mund të zgjedhin që të përqendrohen në specializimin e disa aftësive të caktuara, duke bërë kështu më të mirën e tyre drejt kauzës së përbashkët. Unë e kuptoj se specializimi vetëm në aftësi të caktuara mund të ngrejë shqetësime rreth sovranitetit kombëtar. Por disa aleatë kanë zgjedhur tashmë të specializohen dhe e kanë forcuar sigurinë e tyre pa e dobësuar sovranitetin e tyre. Holanda dhe Belgjika, për shembull, janë përqendruar, përkatësisht, te fregatat dhe mirëmbajtja e anijeve që pastrojnë rrugët ujore nga minat, për të mirën e përbashkët të të dy vendeve. Republika Çeke është përqendruar në mbrojtjen kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore (CBRN). Por e vërteta qëndron, se për sa kohë do të vazhdojë rënia ekonomike, shumë aleatë rrezikojnë të

specializohen sipas mundësive të tyre financiare, kur kuptojnë se shumë aftësi të tjera janë thjesht shumë të shtrenjta për t'u arritur apo për t'u ruajtur prej tyre. Kjo rrezikon krijimin e boshllëqeve të reja në gamën e aftësive që i nevojiten NATO-s, si dhe dëmtimin e solidaritetit të Aleancës. Ne duhet të sigurohemi që në vend që të specializohen sipas rastësisë apo mundësisë, aleatët duhet të inkurajohen të specializohen sipas një plani, në mënyrë që së bashku, të kombinuara, këto aftësi t'i japin vendeve të NATO-s mundësinë e një përgjigjeje kolektive. Natyra bashkëpunuese e një përgjigjeje të tillë do t'i dhurojë operacioneve tona një legjitimitet të qëndrueshëm politik, gjë që është vendimtare në këtë ditë dhe këtë epokë. Merrni për shembull, Brigadën e Europës Juglindore, SEEBRIG. Kjo brigadë ka demonstruar vlerat e saj gjatë kohës së saj në komandën e Brigadës Shumëkombëshe të Kabulit. Forcat në gatishmëri të kësaj brigade janë mbresëlënëse. Aktualisht, fokusi i SEEBRIG është paqeruajtja. Kjo mund të kërkojë një numër elementesh të tjerë të kombinuar, për t'i mundësuar kësaj brigade kryerjen e projektit aktual të sigurisë dhe stabilitetit. Unë do t'ju inkurajoja të shikoni mirë se çfarë mund të bëhet për të rritur aftësitë e kësaj brigade. Dhe në veçanti, do të sugjeroja, që vendet e Europës Juglindore të marrin në konsideratë një kontribut më të madh për Forcën e Reagimit të NATO-s, ndoshta me elementet e SEEBRIG. Duke vepruar së bashku, kombet kontribuuese kanë potencialin për të krijuar një brigadë që ka një spektër të gjerë aftësish dhe mund të marrë pjesë në misionet më të kërkuara të Aleancës. Ekziston gjithashtu potenciali në përvetësimin e radarëve të mbikëqyrjes ajrore, përmes Përqasjes Rajonale të Ballkanit ndaj Mbrojtjes Ajrore (BRAAD). Përveç kësaj, ne mund të rrisim mbështetjen tonë për zhvillim e Task Forcës Mjekësore të Ballkanit, që do të krijonte aset rajonal mjekësor për një reagim të shpejtë në rast të një fatkeqësie natyrore

ose një krize humanitare. Përgjithësisht, ndërtimi i kapaciteteve të mbrojtjes mbetet një fushë e rëndësishme pune. Disa vende në këtë rajon kërkojnë ndihmë shtesë - për shembull - në forcimin e planifikimit të tyre strategjik dhe në koordinimin e programeve të tyre të trajnimit dhe stërvitjes. Organizatat rajonale mund të sigurojnë këtë ndihmë për to. Në Bruksel, ne shohim një potencial të madh në organizatat rajonale, që shërbejnë si shpërndarës për ndërtimin e kapacitetit mbrojtës, prandaj do të kërkoja që ju të shikoni dhe analizoni mirë se çfarë mund të bëni më shumë së bashku në mënyrë kolektive. Në këtë drejtim, NATO mirëpret vendimin e ministrave të Mbrojtjes të Europës Juglindore për krijuar programin "Ndërtimi i Integritetit" në mënyrë të përshtatshme. Shoh se e keni këtë në axhendën tuaj nesër. Në klimën aktuale financiare, të gjitha vendet janë ballafaquar me sfidën e reformimit, rinovimit dhe forcimin e aftësive operacionale dhe institucionale. NATO është një bashkësi vlerash të përbashkëta dhe ne i inkurajojmë të gjitha vendet për forcimin e transparencës, përgjegjshmërisë dhe integritetit në sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes. Unë mendoj se Karta e Adriatikut dhe SEDM mund të na ndihmojë madje, për të rritur ndihmën tonë edhe në vendet jashtë këtij rajoni. Shumë aleatë të NATO-s dhe partnerë sapo kanë përjetuar procesin e tranzicionit të reformës në sektorin e sigurisë dhe të ndërtimit të kapaciteteve. Ju mund t'i ndihmoni duke ndarë me vendet në kufijtë tanë duke përfshirë edhe partnerët tanë përgjatë Mesdheut -, ato përvoja dhe njohuri të fituara në vështirësi. Duke u përqendruar në specializimin e aftësive, duke u bashkuar në grupe rajonale dhe duke bashkëpunuar për të arritur një spektër sa më të gjerë aftësish, vetëm kështu Europa është e aftë të përballë me çdo krizë apo emergjencë - si brenda kufijve të saj ashtu edhe jashtë saj: ky është objektivi ynë, dhe ky është një objektivi që ne mund ta arrijmë.

Zonja dhe zotërinj,

në fund të këtij viti, në muajin dhjetor, Këshilli European do të organizojë mbledhjen e një samiti kushtuar sigurisë dhe mbrojtjes, mbledhja e parë e një samiti të këtij lloji. Ndërsa vitin e ardhshëm, NATO do të organizojë mbledhjen e samitit të saj. Këto do të jenë dy raste të rëndësishme për ne, për të punuar drejt këtij qëllimi të përbashkët - të një Europe të përbashkët, të lirë dhe në paqe, dhe e aftë për të mbrojtur dhe ruajtur vlerat dhe interesat e përbashkëta.

Takimet tuaja sot dhe nesër ju ofrojnë mundësinë për të marrë në konsideratë se si kombet në Europën Juglindore mund të ndihmojnë për të arritur këtë vizion dhe të përçoni një mesazh të fuqishëm, se vendet e këtij rajoni kanë shumë për të kontribuar në sigurinë tonë të përbashkët. Siguria kërkon angazhimin tonë të përbashkët për të mbrojtur interesat tona, vlerat tona dhe popujt tanë. Kam sugjeruar disa ide në lidhje me mënyrat se si kombet mund të grupohen në një bashkëpunim rajonal për të përmirësuar sigurinë tonë. Pa dyshim, mund të ketë edhe mjaft ide të tjera dhe unë ju inkurajoj të shpalosni idetë tuaja. Duke e përfunduar me këtë, mbetem në pritje të diskutimeve tuaja sot.



Zv.sekretari i Përgjithshëm i NATO-s,
ambasadori Aleksandër Vershbow

Vështrim i përgjithshëm mbi çështjet e Samitit “NATO 2014”

Përgatiti: Migena Xoxe

Kohët e fundit u bë e ditur se Samiti “NATO 2014”, do të zhvillohet në Mbretërinë e Bashkuar. Hera e fundit kur Britania e Madhe organizoi këtë samit ka qenë në vitin 1990, kur Margaret Thatcher ishte kryeministre dhe Luftës së Ftohtë po i vinte fundi. Ky do të jetë një samit veçanërisht i rëndësishëm për dy arsye kyçe. Se pari, ky është samiti i fundit para se NATO të përfundojë operacionet e saj luftarake në Afganistan dhe ka gjasa jetë samiti i parë për sekretarin e përgjithshëm (sekretarin e radhës), të NATO-s, i cili do të marrë detyrën në korrik të 2014-ës. Shumë prej çështjeve që do të diskutohen në këtë samit do ti nevojitet një “terren”, i përgatitur paraprakisht nga SHBA-ja. Ky është vetëm një rishikim paraprak i disa prej çështjeve kryesore që duhet të adresohen në samitin e ardhshëm.

Misioni në Afganistan

Dy nga çështjet më të rëndësishme të samitit, në lidhje me Afganistanin do të jenë: Numri i trupave amerikane dhe NATO-s në Afganistan dhe financimi për Forcat e Sigurisë Kombëtare Afgane (ANSF), pas vitit 2015. Një nga periudhat kritike të fushatës afgane do të fillojë në vitin 2015, kur afganët të marrin rolin udhëheqës për sigurinë e tyre. Një pjesë e madhe e strategjisë së tranzicionit në Afganistan ka trajnuar ANSF, në një nivel ku mund të përmbushë sfidat e brendshme të sigurisë së Afganistanit, pa nevojën e dhjetëra mijëra trupave të NATO-s, në terren. Rruajtja e ANSF pas vitit 2015 do ti kushtojë komunitetit ndërkombëtar rreth 4.1 miliardë \$ në vit. Për të vënë këtë në perspektivë, SHBA transferonte të njëjtën shumë çdo 12 ditë në Afganistan, për të mbështetur operacionet luftarake të vitit të kaluar. SHBA-ja është angazhuar për financimin me 2miliard \$ në vit, por sipas një raporti nga ana e Zyrës Përgjegjëse të Qeverisë, komunitetit ndërkombëtar është me -1.8miliard



\$, përse i përket financimit të ANSF për vitet 2015-2017. Samiti “NATO 2014”, do të jetë gjithashtu një mundësi për anëtarët e aleancës, ku ata duhet të vendosin mbi numrin e numrat e trupave që do të dërgojnë për trajnimin e misionit post-2014 dhe misionin e udhëzimit. Zyrtarë të lartë (ushtarakë) amerikanë kanë bërë thirrje për deri në 13,600 trupa amerikane së bashku me 7,000 trupa të NATO-s. Afganistani, Pakistani, Talebani dhe të tjerët në rajon duhet të shohim një angazhim më të qartë të NATO-s në lidhje me këtë temë. Pra, NATO-ja duhet të demonstrojë angazhimin e saj në Afganistan edhe pas vitit 2014.

Zgjerimi i NATO-s

Çështja që i mungonte agjendës së samitit të fundit të NATO në vitin 2012 Çikago, ishte zgjerimi i saj. Duke iu përgjigjur kritikave, Sekretarja e Shtetit në atë kohë, Hillary Clinton, tha: “Unë besoj se (Samiti i Çikagos), duhet të jetë samiti i fundit që nuk përmendet dhe diskutohet rreth aneksimit të NATOS “. Presidenti Obama është i vetmi president amerikan që nga fundi i Luftës së Ftohtë, i cili nuk të mbikëqyrë zgjerimin e NATO-s. Bosnja dhe Hercegovina, Gjeorgjia, Maqedonia dhe Mali i Zi janë vendet që zyrtarisht aspirojnë të bëhen anëtarë të NATO-s. Disa janë më të gatshëm për t'u bashkuar me NATO-n, se të

tjerët. Për shembull, Maqedonia pesë vjet më parë duhet të ishte bërë anëtare me të drejta të plota në NATO dhe duhet të merrte pjesë në samitin e Çikagos 2012. E vetmja arsye që e bëri të pamundur anëtarësimin, ishte vetoja e Greqisë, e cila vazhdon të insistojë në lidhje me mosmarrëveshjen e emrit me Maqedoninë. Megjithatë, kjo situatë është akoma e paqartë dhe nuk dihet nëse Administrata do ta miratojë në agjendën e samitit të ardhshëm.

E ardhmja e NATO-s

Me përfundimin e misionit në Afganistan edhe nxitësi kryesor i bashkëpunimit të mbrojtjes në Europë do të zhduket ngadalë. Në një situatë kur NATO po ripërcakton misionin e saj në një botë post-afgane të Luftës, do të shfaqet nevoja për udhëheqje amerikane. NATO, mbi të gjitha është një Aleancë e Sigurisë Kolektive. Për të qëndruar relevante, ajo duhet të përgatitet për tu mbrojtur nga kërcënimet e shekullit të XX, kryesisht në rajonin e Atlantikut të Veriut. Aleanca duhet të fokusohet në mbrojtjen kolektive dhe në parandalimin e përhapjes së armëve bërthamore, duke u mbrojtur kundër sulmeve kibernetike, duke siguruar sigurinë e energjisë, në luftën kundër terrorizmit, si dhe krijimin e një sistemi mbrojtës nga raketat nukleare. NATO gjithashtu duhet ti rikthehet trajnimit të misionin se saj, sipas nenit 5.

Partneritetet e NATO-s

Nën flakën e kryengritjeve në të gjithë Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut si dhe kërcënimet e vazhdueshëm në rajon, nga al-Kaeda dhe kërcënimin bërthamor nga Irani, shumica e aleatëve të NATO-s kanë vendosur të fokusohen në një bashkëpunim më të ngushtë me partnerët rajonalë, të cilët i përkasin periferisë së NATO-s. NATO-ja, tashmë ka përcaktuar strukturat e saj për të bashkëpunuar me partnerë në këtë pjesë të botës, të tilla si: Dialogut Mesdhetar dhe Nismës së Bashkëpunimit të Stambollit. Marrëdhëniet e NATO-s, janë jetike për të siguruar suksesin e Aleancës. Për fat të keq, përtej fjalëve në komunikata, shumë pak është bërë për të përmirësuar këto marrëdhënie.

Mungesa e fondeve të Europës për shpenzimet e mbrojtjes

Si një Aleancë Ndërqeveritare e Sigurisë, NATO është aq e fortë sa edhe shtetet anëtare të saj. Vendet europiane kolektivisht kanë më shumë se 2 milionë burra dhe gra në uniformë, por sipas disa vlerësimeve vetëm 100,000 prej tyre thjesht një 5% -, ka mundësinë për tu dislokuar jashtë kufijve kombëtarë. Në vitin 2012, vetëm katër prej 28 anëtarëve të NATO-s (Shtetet e Bashkuara, Britania, Estonia, Greqia), shpenzuan 2% të produktit të brendshëm bruto për mbrojtjen. Franca ra nën 2% në vitin 2011. Europianët, për të përballuar këtë krizë kanë krijuar programe të tilla si: "Mbrojtja e Zgjuar" dhe përtej një listë të madhe aspiratash, nuk kanë arritur të ofrojnë aftësi dhe mundësi të konsiderueshme ushtarake në Aleancë. Aftësitë ushtarake

nuk mund të krijohen në një afat të shkurtër kohor dhe as kundrejt një "çmimi të ulët". Pa investimin e duhur në Forcat e Armatosura të Europës, koncepte të tilla si: "Mbrojtja e Zgjuar" dhe Nisma e "grupimit dhe ndarjes së përgjegjësisë", nuk do të ofrojë as edhe një kapacitet shtesë.

Hedhja e themeleve

Për të siguruar që Samiti i ardhshëm i NATO-s të ketë sukses, SHBA duhet të fillojë hedhjen e themeleve. Një nga këto themele është edhe Fokusimi i NATO-s në Afganistan. SHBA-ja ka nevojë të rrisë mbështetjen financiare për ANSF dhe të kërkojë zotime konkrete të trupave të mentorimit për misionin në Afganistan, pas vitit 2014. Ky nuk është momenti që NATO ti kthejë shpinën situatës atje.

Nxitja e partneriteteve me Aleatët e NATO-s

SHBA-ja duhet të nxisë një takim me Dialogun Mesdhetar gjatë samitit që përfshin krerët e shteteve dhe qeverive. Tani që marrëdhëniet mes Turqisë dhe Izraelit janë kthyer në rrugën e duhur, kjo duhet të shihet si një mundësi, por në të njëjtën kohë do të kërkojë më shumë angazhim diplomatik deri në mbajtjen e samitit.

Mbështetja për aneksim

"Politika e dyerve të hapura", të NATO-s, është kritike për mobilizimin e Europës dhe aleatëve të saj rreth një mbrojtje kolektive transatlantike. SHBA-ja duhet të



punojë për të vazhduar politikën e dyerve të hapura për vendet europiane që kualifikohen.

Nxitja e aleatëve në rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes

Presidenti Obama duhet të adresojë këtë çështje drejtpërdrejt me homologët e tij europianë para mbajtjes së samitit. Deri më sot, presidenti Obama nuk ka qenë i gatshëm të veprojë në këtë mënyrë, duke ia lënë këtë detyrë Sekretarit të tij të Mbrojtjes.

Investoni në NATO

NATO-ja ka promovuar demokracinë, paqen dhe sigurinë në Evropë, më shumë se çdo organizatë tjetër shumëpalëshe, duke përfshirë këtu edhe Bashkimin Europian. Samiti "NATO 2014", do të vijë në një moment kyç për Aleancën. Është thelbësore që SHBA të vazhdojë të jetë një pjesëmarrës aktiv në të ardhmen e Aleancës.

-Luka Coffey është partneri i Margaret Thatcher në Qendrën "Për Liri". Ky është një divizion i Institutit të Studimeve Ndërkombëtare, "Kathryn and Shelby Cullom Davis", në Fondacionin e Trashëgimisë.

Përgatiti: Elda Sinani

TRANSFORMIMI

Një epokë e re për tregtinë midis SHBA-së dhe BE-së

Fjala e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Rasmussen, në Kopenhagen

“**M**ë lejon të falënderoj Konfederatën e Industrisë daneze për organizimin e kësaj konference. Është kënaqësi të bisedoj rreth një çështjeje që e kam për zemër: Marrëdhënien transatlantike. Disa mund të pyesin pse Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s duhet të nisë një diskutim rreth tregtisë ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Europian dhe për këtë kam mjaft arsye. Për shkak se kam mbrojtur partneritetin transatlantik që nga viti 2006, si kryeministër i Danimarkës, sepse Traktati i Uashingtonit, Traktati i NATO-s, thekson në nenin 2 se aleatët “do të kërkojnë të eliminojnë konfliktet në politikat e tyre ekonomike dhe do të nxisin bashkëpunimin ekonomik mes tyre” dhe sepse kohët e fundit, ekonomia dhe siguria janë të ndër-lidhura ngushtë. Tregtia inkurajon krijimin e mirëqenies. Ajo dekurajon konfliktet dhe pushtimet. Rritja e aktivitetit ekonomik krijon prosperitet më të madh dhe kjo çon në siguri më të madhe duke qenë se njerëzit nuk duan të venë prosperitetin e tyre në rrezik. Një ekonomi e shëndetshme dhe një siguri e shëndoshë krijojnë një rreth virtuoze. Në botën tonë të ndërlidhur, lidhja midis ekonomisë dhe sigurisë dhe ndërmjet paqes dhe prosperitetit, është më e fortë se kurrë më parë dhe kjo është veçanërisht e fortë në marrëdhëniet ndërmjet Europës dhe Amerikës së Veriut. Këto dy kontinente varen shumë ekonomikisht nga njëri-tjetri. Së bashku, ne llogarisim rreth gjysmën e prodhimit ekonomik të botës dhe pothuajse 40% të tregtisë globale. Çdo ditë, më shumë se 2 bilionë euro në mallra e shërbime tregtohen nëpër Atlantik dhe miliona punë në të dy anët e oqeanit varen nga ajo tregti. Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Europian janë gjithashtu burim primar për njëri-tjetrin dhe destinacioni për investimet e huaja direkte. Për shembull, në Europë më shumë se 60% e të gjitha investimeve të huaja në Kërkime e Zhvillime bëhet nga bashkëpunëtorët amerikanë dhe subjektet europiane janë përgjegjëse për rreth ¾ e investimeve të huaja në Kërkime e Zhvillime në Shtetet e Bashkuara. E gjithë kjo tregon interesin e madh që kemi në ekonomitë e njëri-

tjetrit dhe në suksesin e ekonomive të njëri-tjetrit, por Europa dhe Amerika janë shumë më tepër se vetëm partnerë ekonomikë. Ne jemi të bashkuar nga miqësi e lidhje familjare që i përkasin shumë gjeneratave më para. Ne jemi të bashkuar dhe nga vlerat tona të përbashkëta, liria, demokracia dhe sundimi i ligjit dhe jemi të bashkuar në vendosmërinë tonë për të mbrojtur ato vlera duke punuar së bashku në NATO. Kjo është arsyeja pse vizioni im është “Komunitet i Vërtetë Transatlantik i Integruar”. “Një Komunitet i Integruar Transatlantik” do të na ndihmojë të forcojmë marrëdhënien tonë, lidhjet tona ekonomike, lidhjet tona personale dhe bashkëpunimin tonë të sigurisë. Kjo do të na ndihmojë të mbrojmë vlerat tona të përbashkëta, popullsitë e shoqëritë tona, të promovojmë rendin ndërkombëtar të bazuar në ligje, norma e praktika, për të ruajtur paqen e prosperitetin tonë dhe të ndihmojmë progresin e kombeve të tjerë drejt paqes e sigurisë. Ekonomia dhe tregtia do të jenë jetësore në “Komunitetin e Integruar Transatlantik”, prandaj e mbështes fuqishëm idenë e një tregtie transatlantike dhe partneriteti investimesh. Sipas disa vlerësimesh, një marrëveshje gjithëpërfshirëse, brenda 5 viteve, mund të nxisë eksportet ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Europian me më shumë se 150 bilionë dollarë amerikanë. Ajo mund të zgjerojë ekonomitë tona me 250 bilionë dollarë amerikanë dhe kjo mund të gjenerojë më shumë se gjysmë milioni vende punësh të paguara. Për shembull, marrëveshja do të ndihmojë në thyerjen e barrierave tarifore. Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Europian mbajnë tarifa të larta në sektorë që janë me interes kritik ekonomik për tjetrin. Ne duhet t'i shkurtojmë këto tarifa sidomos në sektorë të ndjeshëm si agrikultura, ushqimi i përpunuar dhe mjetet motorike. Nëse mund të eliminojmë ose të reduktojmë në mënyrë drastike këto tarifa, tregtia e mallrave mund të rritet me 2%. Gjithashtu, në të njëjtën kohë, ne duhet të heqim kufizimet e forta kombëtare që ekzistojnë në shërbime të tilla si transporti detar dhe ajror dhe duhet të kapërcejmë dallimet e mëdha në rregulloret për industrinë e shërbimeve financiare,



time. Unë mendoj se studentët, akademikët dhe artistët duhet të kenë mundësi më të mëdha të kalojnë Atlantikun në të dy drejtimet. Një program gjithëpërfshirës për bashkëpunim më të madh kulturor, arsimor dhe shkencor do të ndihmojë në forcimin e komunitetit tonë të vlerave dhe do të mbështesë gjithashtu tregtinë transatlantike dhe partneritetin e investimeve. Së fundmi, nëse duam të krijojmë një "Komunitet të Integruar Transatlantik" të vërtetë, duhet të vazhdojmë të forcojmë pjesën e tretë të rëndësishme

ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Europës si dhe mes shteteve anëtarë të Bashkimit European. Gjithashtu, marrëveshja do të na lejojë të kemi koherencë dhe transparencë në rregulloret teknike, standardet dhe certifikimin. Studimet kanë treguar se ndryshimet e rregulloreve zakonisht shtojnë 10% në koston e tregtisë dhe investimeve dhe 50% më shumë në disa fusha si sektori i pijeve dhe ushqimit. Në sektorin e automobive, këto barrierat shtojnë më shumë se 25% në koston e tregtisë dhe të investimeve. Ato tregojnë gjithashtu se shkurtimi i shpenzimeve administrative, liberalizimi i tregtisë në shërbime dhe hapja e prokurimit publik ndaj ofertuesve të huaj, do të gjenerojë 80% së fitimeve të përgjithshme të kësaj marrëveshjeje tregtie të propozuar. Gjithashtu, ato tregojnë se shkurtimi i shpenzimeve administrative, liberalizimi i tregtisë në shërbime dhe hapja e prokurimit publik për ofertuesit e huaj do të gjenerojë 80% të fitimeve të pasurisë së përgjithshme të kësaj marrëveshjeje tregtie të propozuar. Si përfundim, përfitimet afatgjata të një tregtie transatlantike dhe partneriteti për investime do të jenë të mëdha. Kjo do të nxisë tregtinë dhe investimet, do të stimulojë punën, rrisin dhe rritjen ekonomike, do të promovojë parimet e një sistemi të bazuar në rregulla tregtare dhe do të jetë një hap i rëndësishëm drejt një zone tregtie të lirë transatlantike. Ky duhet të jetë qëllimi ynë përfundimtar. Sigurisht, jemi të vetëdijshëm se ka dhe interesa vetjake dhe ndjeshmëri mbi një gamë të gjerë çështjesh, të tilla si subvencionet bujqësore, organizmat e modifikuar gjenetike, shëndeti publik dhe rregulloret sanitare. Ndërkohë, ne duhet të respektojmë shqetësimet legjitime, nuk duhet të lejojmë që interesat e veçantë të minojnë të mirat që mund të arrijmë për të gjithë kombet tona dhe për pjesën tjetër të botës. Forcimi i tregtisë dhe aktivitetit ekonomik përgjatë Atlantikut është një prioritet i veçantë, por vizioni im për një "Komunitet të Integruar Transatlantik" është shumë më i gjerë. Kjo vlen gjithashtu për të forcuar marrëdhëniet midis njerëzve dhe për të promovuar vlerat e idealet që ne të gjithë ndajmë. Unë përfitova shumë nga udhëtimi im në Shtetet e Bashkuara si një politikan i ri, tridhjetë vjet më parë. Kuptova shumë rreth atij vendi dhe njerëzve të tij dhe kjo krijoi lidhjet me familjet, kolegët dhe institucionet që kam për zemër dhe që vazhdojnë të më ndihmojnë në punën

të lidhjes sonë transatlantike, që është siguria. Ajo është themeli për çdo që kemi dhe për çdo gjë që shpresojmë të arrijmë. Për më shumë se gjashtë dekada, NATO ka garantuar sigurinë dhe stabilitetin, të cilët kanë lejuar të gjithë kombet tona të lulëzojnë. Me strukturën e komandës sonë unike të integruar së aftësive ushtarake të pakrahueshme, forcave e procedurave të testuara e të provuara dhe shtrirjes së rrjeteve të partneriteteve, NATO është Aleanca më e suksesshme në histori. Siç e dimë, asgjë nuk vjen falas. Gjithashtu edhe siguria. Prandaj është e rëndësishme që NATO të mbetet e aftë për këtë qëllim, jo për hir të luftës, por të paqes. Kjo do të thotë që të gjithë aleatët duhet të vazhdojnë të investojnë në NATO politikisht, ushtarakisht dhe financiarisht. Të gjithë ne duhet të ndajmë në mënyrë të drejtë të gjithë barrën, siç ndajmë edhe përfitimet. Ky përkushtim është gjithashtu një pjesë e rëndësishme e vizionit tim për një "Komunitet të Integruar Transatlantik". Në një botë ku jemi të lidhur ngushtë, marrëdhëniet transatlantike mbetet marrëdhëniet më të rëndësishme që kemi. Ajo është jetike për lirinë, sigurinë dhe prosperitetin në Europë dhe në Amerikën e Veriut. Tregtia transatlantike dhe partneriteti i investimeve që është tani në diskutime, është përshkruar si "NATO ekonomike" dhe ky është një krahasim i mirë. Tregtia transatlantike dhe partneriteti i investimeve mund të sjellin përfitime të mëdha për të gjithë njerëzit e kombet tona dhe për brezat e ardhshëm. Kjo mund të vendosë një standard të ri të artë në bashkëpunimin ekonomik, siç ka qenë NATO për një kohë të gjatë standardi i artë në bashkëpunimin e sigurisë dhe po ashtu si NATO, mund të jetë shtylla e fortë për një "Komunitet të Integruar Transatlantik" të vërtetë. Për ta kthyer atë vizion strategjik në realitet, do të duhet imagjinatë dhe fleksibilitet në të dy anët e Atlantikut për të kapërcyer kundërshtimet dhe pengesat e pashmangshme. Këto nuk duhet të lejojnë që vizioni ynë të zbehet. Prandaj hapi më i rëndësishëm drejt suksesit do të jetë një udhëheqje politike e fortë dhe e vendosur. Gjithashtu, kjo do të kërkojë mbështetje të fuqishme dhe inkurajim nga bizneset dhe industritë. Gjasat janë të larta, për të gjithë ne, por i tillë është edhe shpërblimi. Ju bëj thirrje të gjithëve ta kapni atë".

Përgatiti: Alba Musaraj

Sistemi PPBES, një “Deus ex machina” për menaxhimin e burimeve të Mbrojtjes

Kolonel (r) Foto Duro mbron tezën e doktoraturës me punimin e tij mbi një qasje gjithëpërfshirëse në menaxhimin e burimeve të mbrojtjes. Intervista e mëposhtme jep disa detaje nga ky studim i vlefshëm

INTERVISTOI: ALBERT HITOALIAJ

Muajin e kaluar, në Akademinë e Forcave të Armatosura, pas një ndërprerje disa vjeçare, ka nisur mbrojtja e tezave të doktoraturës për fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, për ciklin 2010-2013. Foto Duro, kolonel në rezervë, ishte doktoranti i dytë. Punimi i tij mbi një qasje gjithëpërfshirëse në menaxhimin e burimeve të mbrojtjes u vlerësua “shkëlqyeshëm”. Ai u ndoq nga specialistë të fushës, miq, studentë të kurseve të larta të Akademisë etj. Mes të pranishmëve në sallë ishin gjithashtu Atasheu i Mbrojtjes i ShBA, z. Glen Brown dhe shefi i kompanisë amerikane CUBIC, atashuar në Ministrinë e Mbrojtjes, Lou Borosh. Me këtë rast, Revista “Mbrojtja” i mori intervistën që vijon. Përdorimi në titull, i termit “Deus ex machina” u shfrytëzua për të dhënë që në fillim, rëndësinë që ka për Mbrojtjen dhe FA në tërësi, sistemi PPBES (Planifikim-Programim-Buxhetim-Ekzekutimi), të cilin e merr në shqyrtim studimi i kol. (r) Foto Duro. “Deus ex machina”, për ata që nuk e dinë, është një term i cili përdorej në teatri grek e atë romak. Më pas ka gjetur përdorim të përditshëm e të gjerë në kohet moderne. Shprehja tregon shfaqjen e papritur e të paimagjinuar të dikujt a diçkaje, që hyn në skenë duke bërë të mundur zgjidhjen e problemeve të komplikuar e që dukeshin të pazgjidhshme. Në dramën antike, ky dikush ishte një aktor-perëndi që zbriste me një mekanizëm, nga lart brenda skenës, duke zgjidhur problemet e aktorëve. Ky mekanizëm, ishte zgjidhja e tipit “Deus ex machina”. A mund të jetë PPBES, e zbatuar ashtu siç duhet një zgjidhje e tipit “Deus ex machina”? Intervista e mëposhtme jep një informacion të përgjigjëm i cili mund të krijojë mundësinë e një përgjigje.



Zoti Foto, së pari ju urojmë për gradën “Doktor”, nga ana tjetër do të donim të dinim diçka më shumë për ecurinë e procesit të doktoraturës në Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA).

Ju faleminderit për urimin, por në mënyrë të posaçme për mundësinë për të komunikuar me lexuesit e Revistës “Mbrojtja”, pasi për vetë fushën e zgjedhur si objekt të punës sime të doktoraturës, numri i të interesuarve për ta lexuar direkt natyrisht që do të jetë më i kufizuar. Për sa i përket procesit të doktoraturës ose programit të studimeve të ciklit të tretë pas një farë shkëputjeje, duke filluar nga viti 2010, AFA ka marrë sërish autoritetin për



dhënien e diplomave për gradë të tilla shkencore në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Konkretisht, për mua ka qenë një periudhë 3 vjeçare nga më të veçantat. Kjo për shkak të një numri detyrimesh në modulën e punës kërkimore, por edhe për thellim në objektin e zgjedhur për tezën e doktoraturës, obligimin për të plotësuar një numër botimesh në revista shkencore brenda e jashtë vendit, si dhe për të referuar në disa konferenca ndërkombëtare, prej të cilave, jo më pak se dy jashtë vendit. Sidoqoftë, falë ndihmës dhe inkurajimit prej drejtuesit tim shkencor, Prof. Dr. gjeneralmajor Kostaq Karoli, por edhe kolegëve të tjerë, punimi u konsiderua nga oponentët si "...punimi i parë edhe një kontribut me vlerë për përmirësimin e menaxhimit të burimeve të mbrojtjes në FASH".

Cili ishte objekti i kërkimit dhe i tezës suaj të doktoraturës?

Në objekt të punimit për doktoraturë ishte menaxhimi i burimeve të mbrojtjes, më konkretisht mundësitë që ofron sistemi i Planifikim-Programim-Buxhetim-Ekzekutimit (PPBES) për rritjen e nivelit të këtij menaxhimi.

Duke qenë se Revista jonë komunikon me një kategori të gjerë lexuesish, brenda e jashtë FASH, me interesa e formim të larmishëm, a mund të shtjelloni diçka më shumë për këtë sistem, ku qëndron veçoria e tij?

Sistemi i PPBES është aplikuar për herë të parë në menaxhimin e burimeve të mbrojtjes në SHBA, në vitin 1961. Ishte Sekretari i Mbrojtjes i asaj kohe, McNamara, i cili me njohuritë e rralla menaxheriale dhe autoritetin e padiskutueshëm, e futi atë për të përballuar sfidën e lidhjes së vizioneve afat-largëta të FA Amerikane me kërkesat vjetore për buxhet të bëra nga drejtuesit e forcave. Thënë shkurt: PPBES është ajo strukturë komplekse ku buxheti buron nga programet, programet nga kërkesat op-

eracionale, të cilat rrjedhin nga misionet, ndërsa këto të fundit, nga objektivat e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare. Kontributi i McNamarës qëndron posaçërisht tek "Programimi" ose puna me programet e mbrojtjes, si një urë lidhëse midis "Planifikimit" e "Programimit", e cila nuk ekzistonte deri në atë kohë.

Cila është vlera aplikative e këtij sistemi në FASH?

Sistemi i PPBES është përqafuar aktualisht nga një numër vendesh të tjera. Sidomos ish vendet socialiste, të cilat përqafuan vlerat perëndimore të demokracisë dhe ekonomisë së tregut, e kanë aplikuar atë pa përjashtim. FASH e kanë adoptuar këtë sistem në vitin 2002, por ende ndeshen dobësi, sidomos në komponentin e "Programimit" dhe "Ekzekutimit" të cilat, parë nga këndvështrimi i PPBES, mund të thuhet se janë ende jo-ekzistente. Këtë fakt jam përpjekur ta qartësoj qysh në fillim të tezës sime dhe e argumentoj në vijimësi në kapitujt përkatës. Është pikërisht për dobësitë e aplikimit të PPBES që FASH, me gjithë sukseset e padiskutueshme në reformimin e tyre, me gjithë përkushtimin dhe vlerësimin edhe nga të huajt në misionet e vështira jashtë vendit, kanë ende mungesa në pajisje në raport me ushtritë e tjera të NATO-s ndërsa në disa vite, rreth 1/5 e buxhetit të mbrojtjes i është kthyer sërish Qeverisë, me argumentin e pamundësisë për t'u shpenzuar. Duke u kthyer tek pyetja juaj, një sistem i konsoliduar menaxhimi i burimeve, konkretisht PPBES, jo vetëm u ngushton hapësirën anomalive të tilla, por kthehet në një faktor vendimtar për krijimin e kapaciteteve operacionale të efektshme.

A janë ngritur më parë këto probleme? Sa janë bërë ato objekt i diskutimeve në nivelet e larta?

Sigurisht këto probleme janë bërë objekt i diskutimeve midis autoriteteve të larta të FASH, si



dhe midis tyre dhe NATO apo disa prej vendeve më të rëndësishme partnere të Shqipërisë. Problemi është se nga njëra anë ato kanë qenë më shumë të karakterit administrativ (pra mbledhje pune) nga ana tjetër nuk kanë pasur efektin e pritshëm. Teza ime e doktoraturës i trajton këto probleme nga aspekti akademik, duke bërë analizat përkatëse, të paktën ashtu siç i kam gjykuar unë, me njohjen që më kanë mundësuar detyrat dhe trajnimet që kam kryer gjatë kësaj periudhe. Për secilin nga komponentët e PPBES jam përpjekur të zbuloj rrënjët (shqiptare) të dobësive si dhe të rekomandoj e ofroj modele për përmirësimin e tyre. Do të doja të nënvizoja se përveç diskutimeve administrative që përmenda, aktualisht mungon një qasje akademike për to. Ky fakt, ma ka bërë disi të vështirë punën me tezën time të doktoraturës, por bashkë me to kam ndjerë edhe nxitjen dhe kënaqësinë që të jep një ndërmarrje e tillë, një “çarje e akullit” për herë të parë. Në mënyrë të posaçme, dy komponente, “Programimi” dhe “Ekzekutimi” i kam përpunuar “në themel”, pasi trajtimet për to në FASH mungojnë plotësisht.

A mund t'i bëni lexuesit tonë një paraqitje të shkurtër të konstatimeve tuaja?

Në lidhje me “Planifikimin”, përveç përpjekjes për t'i paraqitur të gjithë produktet e tij (sidomos “Plani Afatgjatë i Zhvillimit”, “Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, “Plani i Modernizimit”, “Politikat Drejtuese”, “Direktiva e Mbrojtjes”) të lidhura e në shërbim të njëra-tjetrës, kam sjellë një numër konstatimesh e rekomandimesh. Kështu, për Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, e parë në raport me dokumentet homologe të rajonit, por edhe vërejtjet e bëra për të nga Qendra Marshall (Gjermani) problemet qëndrojnë tek “vjetërsia” e saj (prodhuar në vitin 2004) por edhe tek konceptimi në formë sloganesh që nuk ndihmojnë për ta kthyer në një dokument pune për institucionet e sigurisë. Strategjia Ushtarake, me gjithë vlerat dhe strukturën përgjithësisht të konceptuar drejt, është gjithashtu e “vjetëruar”, pasi e prodhuar në

vitin 2007, nuk pasqyron më strukturën e FASH (të ndryshuar tre herë qysh atëherë) por edhe dy evenimente në fushën e sigurisë (hyrja e Shqipërisë në NATO dhe shpallja e Kosovës republikë). Në mënyrë të posaçme është analizuar Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Plani i Modernizimit duke konstatuar se dokumentet aktualë janë më shumë të natyrës administrative dhe jo aq të natyrës së planeve strategjike. Për sa u përket “Politikave Drejtuese” dhe “Direktivës së Mbrojtjes”, ndërsa të parat praktikisht nuk ekzistojnë (të paktën në mënyrën si konceptohen në PPBES) e dyta në ndonjë prej viteve (vitet 2010, 2011), është përgatitur në një formë të tillë që nuk i shërben qëllimit për të cilin është krijuar. Për to kam sjellë përvoja nga rajoni e më gjerë, si dhe definicione e citime që shpresoj të “ngjitin”. Njëri prej tyre, i dedikohet direktivës së mbrojtjes: “Ne mund të themi me bindje që një direktivë është e mirë, kur nga veprimet e njerëzve, jemi në gjendje të dallojmë ata që e kanë lexuar atë, nga ata që nuk e kanë lexuar fare” (Russell Murray). Për secilin prej produkteve të “Planifikimit”, krahas trajtimit akademik e sjelljes së përkufizimeve më të përshtatshme për realitetin shqiptar, kam ofruar strukturën e organizimit (në formë “outline”) për t'iu ardhur në ndihmë stafeve që do të mund të narkohen në të ardhmen për t'i ripunuar. Pas këtij shtjellimi disi të gjatë të “Planifikimit” do të doja të bëja me dije se “Programimin” e kam trajtuar jo vetëm nga ana akademike, por edhe praktike, duke marrë si shembull Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, me një qasje nga poshtë-lart, në një hierarki programore, duke filluar nga “element programet” të përshtatshme për njësi të vogla “homogjene” (si p.sh. një laborator për modulin e ndërlidhjes, të departamentit tokësor të Shkollës së Trupës) e deri lart, tek Programi Madhor i FASH. Sikundër u shpreha në hyrje, “Programimi” është një nga kyçet e kontributit të McNamarës. Programet përfaqësojnë struktura komplekse me komponentët personel, pajisje, aktivitete operacionale e mirëmbajta, infrastrukturë etj, ndërsa në FASH

programet e mbrojtjes janë thjesht lista pajisjesh e armatimesh, të cilat për më tepër nuk kanë mundur të imponohen e të orientojnë "Buxhetimin", por i janë "nënshtruar" këtij të fundit. Për vetë "Buxhetimin" kam konstatuar faktin që i mungon qasja "operacionale". Shpesh reduktimet në buxhet, janë bërë nga dora e teknikienit të financave, atje ku ky reduktim mund të bëhet më lehtë, duke deformuar e deri ndalur në vend krijimin e "kapaciteteve operacionale". Argumentet e sjella për këtë në tezën e doktoraturës, në formë tabelore e sidomos grafike, tregojnë qartë shformimet, ulje-ngritjet pa kriter e pa vizion që kanë pasur si pasojë shpenzime fondesh, ndërtime objektesh (të cilat më pas janë braktisur) kapacitete operacionale të kërkuara edhe nga NATO si pjesë e paketës së "capability targets", afatet e realizimit të të cilave shtyhen vit pas viti etj. Për sa i përket "Ekzekutimit", sidomos pjesës së tij që ka të bëjë me prokurimet, kam ofruar analizën e tipit "kosto-përfitim" dhe modelet përkatëse të matematizuara e kompjuterizuara të cilat jo vetëm që ndihmojnë në përzgjedhjen e ofertave më të mira në sisteme e pajisje, por i presin rrugën spekulimeve për favorizime të paligjshme, për të cilat FASH me të drejtë apo jo, janë bërë objekt kritikash të shumta.

Pas kësaj paraqitje të përgjithshme të punimit tuaj të doktoraturës, natyrshëm lind pyetja: "Cili do të jetë efekti i tij, a prisni ndonjë sensibilizim, sado të vogël nga strukturat përkatëse, në interes të një menaxhimi më të mirë të burimeve të mbrojtjes"?

Kjo mbetet për t'u parë. Vetë punimi im është publikuar i plotë në rrjetin e brendshëm të KDS. Në disertacion, në secilin nga kapitujt, por sidomos në përfundim të tij, jam përpjekur të sjell një numër rekomandimesh të cilat personalisht i gjykoj si të domosdoshme për një sistem menaxhimi të frytshëm të burimeve tona të mbrojtjes.

Së pari: është e domosdoshme që futja dhe zbatimi i PPBES duhet të merret në dorë fort nga titullarët më të lartë të Ministrisë dhe Shtabit të Përgjithshëm. Nëse në SHBA ky sistem pati suksesin që ka, kjo i detyrohet kryesisht qartësisë dhe autoritetit të McNamarës por edhe të sekretarëve të tjerë të mbrojtjes, të cilët, pa cenuar unitetin e komponentëve të tij, bënë përshtatjet e nevojshme



për kohën.

Së dyti: sistemi i PPBES duhet të "kodifikohet" në kuptimin që me dokumente të tjerë metodikë të përcaktohet "kush-bën-çfarë" si institucion dhe si komponent i PPBES. Në mënyrë të veçantë duhet të kuptohet që buxheti buron nga programet, programet nga kërkesat operacionale, të cilat rrjedhin nga misionet, ndërsa këto të fundit, nga objektivat e Strategjisë së Sigurisë, ndryshe nga aktualisht ku "buxheti" u është imponuar gjithë komponentëve të tjerë.

Së treti: PPBES mund të aplikohet e mbahet në këmbë nga një kontingjent i konsoliduar menaxherësh të aftë. Krijimi i këtij aseti duhet të konsiderohet po aq i rëndësishëm sa edhe krijimi i kapaciteteve operacionale. Për më tepër, "menaxherializmi" si mendësi e praktikë pune duhet të bëjë vend në çdo pjesëtar të FASH, pavarësisht nga pozicioni. Këtu ka rolin e vet edhe shkolla jonë ushtarake. Është e trishtueshme që aleatët tanë kanë financuar trajnime jashtë vendit në të shkuarën, por efektet e tyre po humbasin me kohën. Veçanërisht SHBA, ka shpenzuar shuma të mëdha për trajnimin si menaxherë të mbi 40 ushtarakëve dhe civilëve të FASH, shumica e të cilëve aktualisht janë jashtë radhëve të FASH, ndërsa pjesa tjetër, në jo pak raste shërbejnë në pozicione ku njohuritë e marra nuk mund t'i vënë në punë.

Këto e një numër konkluzionesh e rekomandimesh të tjera gjykoj se i kam shprehur në mënyrën më të fortë të mundshme në disertacionin tim. Ndoshta të tjerë studiues do të mund t'i shprehin më mirë e më fort në të ardhmen, rëndësi ka që, përtej fjalëve, të ketë lëvizje për mirë e në drejtimin e duhur. Në fakt, deri tani, në jo pak raste, kemi parë që për gjërat që çalojnë të mos vendoset gishti në shkaktarët e vërtetë, por të gjendet zgjidhja duke bërë ndryshime në strukturë, reduktime apo ndryshim varësish organike apo vend dislokimesh fizike, të cilat në mënyrën më sintetike ka mundur t'i shprehë një ushtarak dikur, në një shkrim të tij në gazetën "Ushtria", me titull: "Hej, po vjen struktura...!".

Mesazhi juaj i fundit për lexuesin tonë?

Së pari falënderim e mirënjohje për të gjithë ata që më ndihmuan e mbështetën për realizimin e temës së doktoraturës, gjeneralmajor Karoli, për durimin dhe shtysën e tij në këtë ndërmarrje të vështirë, Genci Kokoshi, për kontributin për të kthyer në gjuhë kompjuterike një numër modelesh matematike të punimit, gjithashtu miqtë e mi Dhimitër Kerri, Ulsi Meta, Dritan Stroni e Bledi Muka, të cilët njohuritë e tyre i ndanë bujarisht me mua. Së dyti, një mesazh për ushtarakët e rinj - të mos rreshtin kurrë së lexuari, të jenë kërkues e të formulojnë pyetje edhe për çështje e praktika në dukje vendosura prej kohësh. Sidomos u sugjeroj të shkruajnë. Të shkruarit nuk është vetëm kontribut për të tjerët, është së pari për veten, të ndihmon të thellohesh e vetorganizohesh, nganjëherë, më mirë se kurse të mirëfillta trajnimi. Faleminderit sërish edhe Revistës "Mbrojtja", për mundësinë të komunikoj me lexuesin tuaj të nderuar.

FORCAT SPECIALE

FS nën reformën e FA, vendi dhe roli i tyre si prioritet

NGA: KOLONEL DRITAN DEMIRAJ

Eksperienca e vendeve anëtare të NATO-s në drejtim të FS

Të gjitha vendet anëtare të NATO-s, kanë ngritur kapacitete SOTG dhe për më tepër kryejnë operacione në interes të ISAF SOF. Këto vende kanë adoptuar me shpejtësi rekomandimet e ekspertëve të NSHQ dhe për një periudhë shumë të shkurtër kanë reformuar forcat e tyre speciale qoftë në pikëpamje strukturore ashtu dhe në atë të teknikës e pajisjeve, duke i sjellë ato në nivelin e kërkuar të ndërveprueshmërisë me njëri tjetrin. Në vartësi të madhësisë së Forcave Speciale dhe eksperiencave kombëtare, vende të ndryshme të NATO-s i kanë modeluar ato në nivel komande. (10 vende nga 16 të studiuar), ose në nivel komponenti (4 vende). E përbashkëta e

të gjitha organizimeve strukturore të këtyre forcave është akses i tyre i drejtpërdrejtë tek lidhshipi i lartë politik dhe ushtarak për komandim kontrollin dhe drejtimin operacional. Gjithashtu një tipar tjetër i përbashkët është ekzistenca e një zyre përfaqësie e SOF në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Kjo zyrë këshillon vendimmarrësit e niveleve të larta politiko-ushtarake për misione specifike me ndjeshmëri të lartë politike si brenda dhe jashtë vendit.

Forcat Speciale nën reformën e FA – vendi dhe roli i tyre si prioritet

Politika e mbrojtjes në thelb ka mbrojtjen e interesave jetësore të vendit si: mbrojtjen e sovranitetit, të pavarësisë, të integritimit territorial, të rendit kushtetues dhe të jetës së qytetarëve Shqiptarë. Ajo e realizon këtë nëpërmjet mbajtjes së Forcave të Armatosura e përdorimit të burimeve të vendit për mbrojtje. Duke u nisur nga rreziqet dhe nga kërcënimet, politika e





mbrojtjes përcakton si objektiva kryesorë:

- Mbrojtjen e pavarësisë, e sovranitetit e të integritetit territorial të vendit, të jetës së qytetarëve tanë dhe ndihmesën për paqen e stabilitetin në rajon;
- Zhvillimin e kapaciteteve të mjaftueshme mbrojtëse për të mënjanuar një sulm të armatosur apo agresion ushtarak kundër Republikës së Shqipërisë, si dhe nxitjen e bashkëpunimit e të proceseve integruese;
- Rivendosjen e integritetit territorial, nëse preket, nëpërmjet krijimit të kushteve të përshtatshme për rimarrjen e territorit të kapur nga armiku.

Kapacitetet tona ushtarake duhet të sigurojnë forcën e mjaftueshme për mbrojtjen e vendit. Ato duhet të bindin çdo agresor të mundshëm se nuk është e leverdishme të sulmohet Shqipërinë, pasi dëmet do të jenë më të mëdha se fitimet. Për të qenë sa më efikase dhe në mënyrë që të arrihen këto objektiva në kohë, janë ndërmarrë disa reforma dhe ristrukturime të analizuar për Forcat e Armatosura.

Forcat Tokësore përbëhen nga tri kategorit trupash: të luftimit, të mbështetjes së luftimit dhe të mbështetjes.

Në trupat e luftimit përfshihen: Forcat Speciale, Komandot, Këmbësoria, Këmbësoria e Mekanizuar dhe Tanket;

Në trupat e mbështetjes së luftimit përfshihen: Zbulimi, Artileria Kundërajrore, Artileria Fushore, Xhenjo, Komunikimi, Policia Ushtarake dhe Mbrojtja nga Armët e Dëmtimit në Masë;

Ndërsa në trupat e mbështetjes përfshihen: Transporti, Shëndetësia, Municionet, Personeli, Riparimet e Mirëmbajtja, Intendenca, Karburantet dhe shërbimet e tjera.

Kuptohet që prioriteti kryesor janë trupat e luftimit dhe konkretisht Forcat Speciale. Forcat Speciale janë të veçanta në llojin e tyre pasi vete misioni i tyre është mjaft i veçantë dhe specifik. Në Forcat e Armatosura janë ndërmarrë një sërë reformash që synojnë rritjen

e kapaciteteve dhe potencialeve të FS për të performuar në mënyrë sa më dinjitoze. Investimet synojnë në përfundimin e projekteve të nisura për modernizimin e BFS, të projektit të mbështetjes logjistike dhe vendosjes, përdorimit me efikasitet të investimeve të tjera të bëra në vite.

1. Bazuar në dokumentet e sigurisë dhe të mbrojtjes së pothuajse të të gjitha vendeve anëtare të NATO-s theksohet se mjedisi i sotëm i sigurisë karakterizohet nga kërcënime të çrregullta "shumë më të ndryshme, më pak të dukshme dhe të paparashikueshme". Për këtë ambient strategjik, NATO ka identifikuar një numër fushash e kapacitetesh për tu përmirësuar në mënyrë që të rrisë aftësinë e saj për tu përballuar me këto sfida. Një nga kapacitetet e cilësuara nga NATO për përballimin e këtyre kërcënimeve janë qartësisht Forcat Speciale. Nëse i referohemi ngritjes dhe funksionimit me shpejtësi të madhe të Komandës së Forcave Speciale të NATO-s, NSHQ dhe rolit që ajo po luan në operacionin e ISAF-it, do të kuptojmë se kush është e ardhmja e SOF për vendet e NATO-s.

2. Nëse i referohemi gjithashtu ndryshimeve strukturore që kanë pësuar FA të vendeve të NATO-s, do të shohim qartë një tendencë të dukshme në drejtim të fokusimit dhe investimit për rritjen e kapaciteteve të SOF. Reduktime të ndjeshme të njësive dhe të kapaciteteve për luftë konvencionale, Forcave Tokësore, Ajrore dhe Detare dhe ruajtje apo përmirësim i dukshëm i kapaciteteve për luftë jo-konvencionale, Forcat Speciale dhe shërbimet sekrete kombëtare e ushtarake janë të parat në radhë. Shembuj në këtë drejtim na jep padyshim SHBA, Britania e Madhe, Franca, Spanja, Turqia, Gjermania, etj.

3. Po ashtu dhe tendenca e vendeve në rajon është po e tillë. Nëse shikojmë Kroacinë, Slloveninë, Maqedoninë, Greqinë, Turqinë, do të vërejmë mbajtjen e një kapaciteti të qenësishëm të Forcave Speciale brenda FA, me një tendencë të dukshme të modernizimit dhe përmirësimeve cilësore të armatimeve, pajisjeve, ko-



munikimit, zbulimit dhe transportit taktik.

4. Për më tepër mësimet e nxjerra nga Afganistani dhe Iraku kanë theksuar rëndësinë e të paturit gati të kapaciteteve të lehta, menjëherë të dislokueshme, shumë të stërvitura e të përgatitura për të përballuar luftën kundërkryengritëse. Më të suksesshme në këtë fushë dhe vitale për arritjen e suksesit në nivel strategjik janë cilësuar SOF. Mbështetur në këto vlerësime unë vlerësoj se mbajtja dhe zhvillimi me shpejtësi i një kapaciteti të SOF në FA Shqiptare është një domosdoshmëri e kohës. As më pak as më shumë do të doja të theksoja dhe impaktin e lartë dhe "përfitimet politike" që merr vendi jonë nga misionet "Eagle" që Forcat Speciale Shqiptare po kryejnë me profesionalizmin më të lartë që prej 3 vjetësh, misione të cilat sot e kanë bërë ushtrinë shqiptare të vlerësohet me notat më të larta, nga politikanët më të lartë të vendit dhe të huaj, ku kjo është arritur me një investim minimal (Smart Defense), në vend që të investohej me miliona në "Battle Group" dhe ku nuk do të mund të merrnim përsipër këtë lloj kontributi në misionet luftarake të NATO-s.

5. Ekziston një qasje e njëjtë tek të gjitha FA të vendeve të NATO-s, por dhe më gjerë se natyra e sfidave, rreziqeve dhe e kërcënimeve të sotme, si "jo të zakonshme" dhe "jokonvencionale" është një detyrë ideale për FS. FS karakterizohet si një aset strategjik për shkak të aftësisë së tyre të arrijnë objektiva strategjike, politike, ushtarake, psikologjike dhe informimi që përfaqësojnë instrumentat themelore të fuqisë kombëtare.

Domosdoshmëria e krijimit, mbajtjes dhe modernizimit të një kapaciteti të SOF, realizohet nëpërmjet përcaktimit të saktë të vendit dhe rolit të tyre në një dokument Strategjik dhe një strategjie kombëtare për FS. Hartimi i kësaj strategjie argumentohet me:

- Vetë natyrën e detyrave që zgjidhin Forcat Speciale

dhe të taktikave dhe teknikave që ato përdorin për realizimin e tyre në interes të arritjes së objektivave/interesave kombëtare strategjike apo edhe të atyre në nivel operacional.

- Me domosdoshmërinë e të paturit të një baze të fortë ligjore për përmbushjen e detyrave të tyre specifike si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Për të përcaktuar qartë misionin, detyrat, synimin për përdorimin dhe zhvillimin e këtij kapaciteti/aseti strategjik.


Kapacitetet e FS duhet të merren në konsideratë në zhvillimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare dhe në Strategjinë Ushtarake. Forcat Speciale i ofrojnë Këshillit të Lartë të Mbrojtjes Kombëtare një aset forcash të stërvitura dhe të pajisura në mënyrë të veçantë, të cilat mund të përshtaten lehtësisht për të ekzekutuar veprime në të gjithë zonën e operacionit dhe veprime që kërkojnë fshehtësi për të frenuar ose zgjidhur krizat e ndryshme. Në kohë paqe, FS mbështetin politikën e Sigurisë Kombëtare duke i ofruar kapacitet për të parandaluar ose ndaluar aktet e agresionit, ose akte kërcënimi terroriste që mund të pengojnë interesat e Sociale, Politike, Ekonomike, Ushtarake dhe të Sigurisë. Zinxhiri i komandimit duhet të sigurojë që FS të jenë të reflektuara në udhëzimet e Planeve të Mbrojtjes dhe dokumenteve të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare. Kapacitetet e Forcave Speciale dhe shpërndarja e tyre është në Planin e Aftësive Strategjike Kombëtare. Shtabi i Përgjithshëm në vartësi të situatave dhe terrenit ku veprohet, ndan burimet tek komandantët e luftës bazuar në armikun që kanë përpara, terrenin ku veprojnë, aftësitë ushtarake të njësive në terren, planet e luftës dhe buxhetin në dispozicion. Të gjitha reformat dhe ristrukturimet që kanë bërë Forcat e Armatosura duhet të arrijnë mbajtjen e një forcë që në

çdo kohë të jetë e gatshme të përmbushë misionin e saj kushtetues. Por gjatë të gjithë këtyre reformave të thella dhe ristrukturimeve duhet marrë në konsideratë që Forcat e Armatosura të zbatojnë konceptin e mbrojtjes të NATO-s dhe të jenë të ndërveprueshme me strukturat e saj. Politika e Mbrojtjes parashikon që NATO dhe vendet anëtare të saj do të jenë aleatë në zbatimin e konceptit të tyre të mbrojtjes dhe veprimet e tyre të jenë koherente dhe të zhvillohen paralelisht. Si pjesë e NATO-s, Forcat tona të Armatosura duhet ti përmbahen konceptit të ri të mbrojtjes, dhe të përmbushin detyrimet dhe të jenë pjesë e barabartë e zgjidhjes së detyrave të aleancës. Duke parë kërcënimet e reja dhe mënyrën më efikase të reagimit ndaj këtyre kërcënimeve është hartuar koncepti i ri strategjik i mbrojtjes së NATO-s. Zhvillimet e fundit të samitit të Çikagos për të ardhmen e NATO-s pas 2014 duhen marrë në konsideratë i dhanë një dimension të ri koncepteve dhe planeve të mbrojtjes. Planet për të dorëzuar përgjegjësinë e plotë të sigurisë tek Afganët deri në fund të vitit 2014 mbeten prioritet. Afati i përfundimit të këtij tranzicioni është deri në fund të vitit 2014. Në atë kohë mendohet që misioni i tanishëm luftarak i ISAF-it do të përfundojë. Që nga viti 2015, ai do të pasohet nga misioni i trajnimit, këshillimit dhe asistencës të udhëhequr nga NATO dhe ky nuk do të jetë një mision luftarak. Shqipëria do të vazhdojë të jetë një vend model për sa i përket realizimit të detyrimeve të Aleancës, duke vijuar kontributin e saj në operacionet e NATO-s. Rezultati i reformave të ndërmarra në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë ka bërë të mundur rritjen e kontributeve që vendi ynë jep në kuadër të Aleancës, gjë që reflektohet veçanërisht në kontributin tonë në teatrin e operacioneve në Afganistan. Pas thujtjes 12 vitesh pjesëmarrje të SHBA dhe forcave të koalicionit, në operacione luftarake, ruajtja e atyre rezultateve të arritura dhe tërheqja e sigurt e trupave e reduktimi i tyre duke i kaluar pushtetin Afganëve, mbetet një çështje thelbësore për planet e Aleancës karshi Afganistanit. Stërvitja e ushtrisë dhe e policisë Afgane shërben pikërisht për këtë synim (FID mision). Shqipëria është angazhuar seriozisht përkrah trupave të Aleancës në këto misione trajnimi dhe luftarake. Misionet OMLT janë edhe llojet e misioneve më të fundit në të cilat FARSH dhe BFS janë angazhuar, si në trajnimin e ushtrisë Afgane edhe në trajnimin e policisë Afgane në Qendrën e Stërvitjes së Forcave Speciale të Policisë (SPTC) në Wardak. Së fundi, po në këtë drejtim FS Shqiptare janë bërë pjesë e një misioni të ri. Krahas detyrave që ato kryejnë nëpërmjet kontingjenteve "Eagle", tashmë janë angazhuar edhe me këtë detyrë të re. Misioni i tyre është intensifikuar dhe konkretisht, janë angazhuar me trajnimin e Forcave Speciale të Policisë Afgane. Kjo tregon një rritje kapacitetesh dhe aftësisë për Forcat Speciale Shqiptare. Reformat e njëpasnjëshme, ristrukturimi dhe puna e BFS solli një dimension të ri në kontributin për ndërtimin e paqes dhe sigurisë në Afganistan, me dërgimin e FS për trajnimin, këshillimin dhe mbështetjen e FS të policisë Afgane. Koncepti i ri i strategjik i mbrojtjes së NATO-s ka sjellë mjaft risi dhe ndryshim konceptimesh për mënyrën e trajnimit të forcave, maksimizimin e përpjekjeve tek ato forca që sjellin më shumë efikasitet dhe që i përgjigjen



më së miri mënyrës së re të kërcënimeve me të cilat përballlet sot NATO. Një vend shumë të rëndësishëm në strategjinë e NATO-s është paraqitur dhe puna për rritjen e mëtejshme të kapaciteteve të FS dhe për operacionet brilante që ato bëjnë në teatrin e luftimeve duke ndryshuar rezultatin në favorin tonë. Duke parë këto ndryshime edhe Forcat tona të Armatosura nën mbështetjen direkte të Ministrit të Mbrojtjes dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, kanë prioritetizuar FS në investimet dhe angazhimet e tyre, për të pasur një Forcë sa me kompetente dhe të aftë për të vepruar në të ardhmen si SOTG përkrah aleatëve të aleancës në mënyrë të barabartë. Misionet luftarake jashtë vendit janë sukses i jashtëzakonshëm për forcat tona. Performanca e FS në misionet luftarake gjatë këtyre viteve ka njohur një transformim rrënjësor, si për vetë FS dhe për FA duke sjellë eksperiencë, maturi dhe një rritje kapacitetesh të lakmueshëm për çdo forcë konvencionale dhe jo-konvencionale. Vëmendje e veçantë i është kushtuar modernizimit dhe pajisjeve në mënyrë që të krijohen kapacitete standartet veprimi nga toka, deti dhe ajri për FS. Një vend të rëndësishëm zë përgatitja e personelit të SOF në kurset brenda dhe jashtë vendit, në vendet anëtare të NATO-s, duke pasur parasysh mënyrën e funksionit SOF, detyrat që kryejnë dhe aftësisë dhe fleksibilitetit që kanë, stërvitjeve të shumta vjetore që zhvillohen me FS të shteteve më të fuqishme të NATO-s. Reformat gjithashtu përshpejtojnë procesin dhe të ardhmen për FS për të vepruar si SOTG në të ardhmen e afërt, duke bërë hapin më të madh në historinë e saj. Prioritetet e mbrojtjes për vitet e fundit kanë qenë modernizimi i mëtejshëm i FS, duke i plotësuar me pajisje për operacione speciale në tokë, det dhe ajër. Këto kanë bërë që të vazhdojë të rritet më tej ndërveprueshmëria e BFS kjo e treguar në stërvitjet e përbashkëta me aleatët e FS të NATO-s dhe SHBA-së, misionet Combat dhe së fundi misionet trajnuese të FS Shqiptare.

BUBRRIME



Jeta është e bukur...

ALBERT HITOALIAJ

Në një nga filmat e tij më të mirë, aktori i njohur italian Roberto Benigni, luan rolin e një babai. Ngjarja zhvillohet në LLIB dhe ai së bashku me të birin fëmijë, ndodhen në një kamp përqendrimi. E gjithë historia që trajton filmi është aftësia e jashtëzakonshme që shfaq Roberto me qëllim që të bindë të birin se janë brenda një loje të madhe lufte, të cilën e realizojnë të rriturit dhe që shoqërohet me fitore ose humbje pikësh. Lumturia që ai arrin t'i sjellë të birit duke i fshehur të vërtetën, është edhe qëllimi i jetës së tij, i vuajtjes së tij. Ky qëllim është lumturia edhe për atë vetë. Mesazhi i filmit është i jashtëzakonshëm, pasi tregon se si lumturia, gëzimi, humanizimi e solidariteti gjenden edhe në rrethanat më absurde e më të vështira të jetës. Mesazhi i filmit jepet saktë me emrin e tij: jeta është e bukur! Po. Jeta është e bukur, pavarësisht rrethanave në të cilat ajo merr frymë. Gjurma e jetës ndryshon në kohë të ndryshme, por përsëri ajo ngjan nga koha në kohë sepse përbëhet nga e njëjta cohë, përbëhet nga ndjenjat e njeriut. Gjurmët e lëna në kohë, shkrimet e një jete në gazetari, janë lënda që ka mbushur vëllimin e parë të librit "Bubrrime", me autor gazetarin Halil Buçpapaj. Në këtë pjesë të parë bëjnë pjesë shkrimet e dhjetëvjeçarit '68-'79. Halili thërret nëpërmjet ku-

itesës së ngrirë në artikuj, njerëz të shumtë, nga më të thjeshtët e deri te ata më të veçantit. Ndërsa sjell këtë galeri personazhesh, ai sjell edhe pamjen e tij. Sjell mendimet e tija dhe mënyrën se si e paraqiste realitetin. "Duke hyrë në librin "Bubrrime", kam thirrur nga kujtesa njerëz, të prapë, të mbarë, dembelë e punëtorë, të shkathët e të ngathët, të zakonshëm, të dalluar, heronj, studiues, shkrimtarë, shkencëtarë, gazetarë, bujq e blegtorë, minatorë e gjeologë..." - thotë Halili në hyrje të librit. Tashmë është kohë tjetër, por shkrimeve të cilët janë botuar kryesisht në gazetën "Zëri i popullit", por jo vetëm, nuk u është lëvizur as edhe një presje. Ka reportazhe, skica, përshkrime e portrete në këtë pjesë të parë të publikuar. Në këto faqe jepet një realitet i panjohur për një pjesë të konsiderueshme të popullsisë, sidomos për atë më të renë. Është pikërisht pasqyrimi i këtyre gjurmëve ajo ç'ka ky libër synon. Kemi të bëjmë me gjurmë që nuk do të përsëriten më. Takon në këtë libër njerëz të ndryshëm: takon Mhill Prekën, 103 vjeçarin nga Curraj i Epërm që pa për herë në jetë të tij dritën elektrike; Mark Grimcin që u bë minator pas rënies së të birit në detyrë; vincçjeren Shukrie Shllaku që punon me krom; 115 vjeçaren Mane në Dobrol që të rrëfen për bjeshkët e bukuritë e tyre si rrallëkush; mjeshtrin e furrnaltave Kimet Gjylin; Azemin e Shoten, dy nga dhjetë fëmijët e Islam Shabanit të cilët mbanë emrin e heronjve popullorë të Kosovës; këngëtarët e Hasis; bashkëluftëtarin e bacë Bajram Currit, Ali Niman

Doçin etj, etj. Janë me qindra personazhe që shfaqen e që tregojnë jetët e tyre. Janë momente të shkurtra jete, profesione, brenga, dhimbje, gëzime e hidhërime të cilat mbushin jetët e njerëzve që ka takuar Halili. Këto jetë dikur kanë mbushin faqe të tëra gazetash e sot gjenden pikërisht në këtë libër. Në dallim me herët e tjera, kur ai shkruante për punën e të tjerëve, sot, në faqe të këtij libri, nëpërmjet pasqyrimin të punës së të tjerëve, pasqyrohet puna e vetë Halilit, ose bubërrimet siç e quan ai vetë. Megjithatë në këtë libër nuk të prezantohen veç njerëz e jetë, por edhe bukuri natyrore si p.sh Çeremi mes shkëmbinjsh, rudinat e mrekullueshme, rudina ku ndodhen varret e të parëve, Kungji i Armëve, Pisha e Barjam Currit, grykat e Fierzës, bukuritë e Valbonës etj. A janë reale përshkrimet e bëra? Kjo mund të jetë pyetja që mund t'i lindë kujtdo, pasi bëhet fjalë për Shqipërinë e periudhës së monizmit. Dyshimi është i vërtetë dhe i justifikuar. Ka një pjesë vuajtje e dhimbje që kalonte në heshtje në atë kohë, e që nuk mund të pasqyrohej plotësisht siç ishte. Kjo mund të shtyjë në një vlerësim të errët të jetëve të njerëzve që e jetuan atë kohë, ashtu siç bëhet sot rëndom. Megjithatë, përshkrimet e Halilit, edhe pse pa këtë pjesë që përmendëm, mbajnë në vetvete të qeshurën e të rinjve, këngën, shakatë, djersën, ndershmërinë e brezave, respektin ndaj moshave, mbajnë jetën e Shqipërisë. Jo më kot përmenda fillimisht Beninjën, i cili arriti të japë një shfaqje dashurie që të mrekullon edhe pse ndodhej brenda një kampi përqendrimi. Ky paralelizëm, shërben për të kuptuar se edhe atë periudhë nëse e zhvesh nga shumë shtresa, mund ta shikosh si një gërshetim vuajtje e gëzimesh, si një pleksje e të hidhurës me të ëmblën, si një frymëmarrje jete. Kjo jetë hera herës mbetet aty, nëpër faqe librash e gazetash, ashtu siç është edhe rasti që flasim.

Shkrimi i parë i Halilit, i botuar në gazetën "Zëri i Rinisë" (suplement Vullnetari) në 29 maj 1968, bën fjalë për brigadën aksioniste të Tropojës, "Shote Galica", e cila kryente punë vullnetare në Gradishtë të Lushnjës. Ky shkrim ka një histori të veçantë e madje është i vetmi në të cilin Halili ka bërë një passhkrim aktual, ku shpjegon ndodhinë e asaj kohe. Pasi kishte marrë kontakt me ata që përmenden në shkrim, në Gradishtë, atij i duhej të largohej, por kishte rënë nata ndërkohë. Në sektorin e hekurudhës nuk lejohej të flihej. As në fjetinat e vullnetarëve nuk lejohej të flihej. Gradishta ishte fushë dhe era e ftohtë të fshinte. Pasi gjen disa batanije, ai drejtohet në një kodrinë të vogël pranë sektorit, ku kishte veç një vend ku mund të strukej për tu ruajtur nga era. Ishte një varr i rrethuar me çimento të ngritur nga toka. Sh-troi batanijet dhe fjeti aty, i ruajtur nga era. Çimentoja e varrit e mbrojti nga lagështia dhe era e fushës. Në moment të parë ngjan si makthi më i madh që mund të përjetojë një njeri, por Halili me tipin e qetë e të qeshur e kujton edhe sot me shaka këtë ndodhi. Të nesërmen lindi një ditë e ngrohtë me diell. Ajo që mund ta trembte më shumë, ajo edhe e ruajti – një përzierje e asaj që përmendëm më sipër, gërshetimit të momenteve të jetës, ku elementët janë një e të pandashëm dhe nuk mund t'i shohësh bardh apo zi. Në pikëshikimin tim, vlera e librit qëndron pikërisht të sjellja e një pjesëze të jetës, e cila normalisht kërkon passhkrimet e veta. Por sido që të jenë passhkrimet, Beninji kishte të drejtë: pavarësisht se e vuajtur apo edhe me dhimbje të mëdha, jeta është e bukur...

Pension të mbarë miku dhe kolegu ynë Halil!



HALIL BUÇPAPAJ

Halil Buçpapaj u lind në Tplë të Krasniqes (Rrethi i Tropojës) më 15 tetor 1948. Shkollën 7-vjeçare e kreu në vendlindje. Në Durrës mbaroi shkollën e mesme të përgjithshme. U diplomua për Matematikë e Fizikë më 1968, në Shkodër dhe për Filozofi më 1982 në Tiranë. Prej janarit 1979 ka punuar si gazetar profesionist në organet e shtypit qëndror të Tiranës. Është dekoruar me Medaljen "Naim Frashëri" dhe urdhërin "Naim Frashëri". Aktualisht, ka veç pak ditë që ka dalë në pension pasi punoi së fundi në administratën e Qendrës së Shtypit, Botimeve dhe Përkthimeve të Ushtrisë, Tiranë.

Ka botuar këto libra:

- | | |
|--|---------------|
| - Gurrat e Rudinave (poezi) | - 1974 |
| - Krah për krah (poezi) | - 1978 |
| - Haxhi Zekë Byberi (monografi) | - 2002 |
| - Eter (poezi) | - 2003 |
| - Kreshta Historie në Kelmend | - 2003 |
| - Vocërr Bala (monografi) | - 2012 |



Declaration

The Republic of Albania became a formal member of the North Atlantic Treaty Organization (NATO) on 1 April 2009 resulting in an increased level of stability and security in the Euro-Atlantic area.

Upon joining the Alliance, Albania entered the Integration Phase. Its main goals were the integration of the Albanian Armed Forces into the NATO Command and Force structures and to ensure that Albania contributes to the Alliance mission in accordance with NATO standard procedures.

To achieve these objectives, the Albanian Armed Forces developed an Integration Plan that was supported by NATO's Integrated Work Programme, led initially by Allied Joint Force Command Naples and, in its final phase, by Headquarters, Supreme Allied Commander Transformation.

The Integration Phase has been successfully completed and Albania will now maintain their declared capabilities.

As an affirmation of fulfilment of the Integration Phase objectives, today, the 25th day of October in the year 2013, we hereby declare the formal end of the NATO Integration Phase for the Republic of Albania.

Jean-Paul Paloméros
General, French Air Force
Supreme Allied Commander Transformation
North Atlantic Treaty Organization



Xhemal Gjakshii
Major General, Albanian Army
Chief of General Staff
Albanian Armed Forces

Deklaratë

Republika e Shqipërisë u bë anëtare zyrtare e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), më 1 Prill 2009, duke sjellë rritjen e nivelit të stabilitetit dhe të sigurisë në rajonin Euro-Atlantik.

Me anëtarësimin në Aleancë, Shqipëria hyri në Fazën e Integritimit. Objektivat e saj kryesore ishin integrimi i Forcave të Armatosura Shqiptare në Strukturën Komanduese dhe Strukturën e Forcës të NATO-s, si dhe për të siguruar që Shqipëria kontribuon në misionin e Aleancës në përputhje me procedurat standarde të NATO-s.

Për të arritur këto objektiva Forcat e Armatosura të Shqipërisë zhvilluan një Plan Integritimi që u mbështet me një Program Pune të Integruar të NATO-s, i cili u drejtua fillimisht nga Komanda e Forcës së Bashkuar e Aleancës në Napoli, ndërsa në fazën finale nga Shtabi i Komandës Supreme të Aleancës për Transformim.

Faza e Integritimit është përbushur me sukses dhe Shqipëria do të ruajë në vijimësi kapacitetet e saj të deklaruara.

Në konfirmim të përbushjes së objektivave të Fazës së Integritimit, sot më 25 Tetor 2013, deklarojmë përfundimin zyrtar të Fazës së Integritimit në NATO për Republikën e Shqipërisë.

Xhemal Gjakshii
Gjeneral Major
Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë



Jean-Paul Paloméros
Gjeneral, Forcat Ajrore Franceze
Komandant Suprem i Aleancës për Transformim
Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut

DEKLARATA E PËRBASHKËT E INTEGRIMIT TË PLOTË TË FARSHI NË NATO